

1 E hënë, 11 dhjetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.02

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Sot do të vazhdojmë me e dëshminë e dëshmitares të
15 Prokurorisë Sandra Mitchell. Të akuzuarit janë të pranishëm në
16 sallën e gjyqit sot. Jo, vetëm tre nga të akuzuarit janë të
17 pranishëm, ndërkohë që z. Krasniqi na ndjek përmes
18 videolidhjes.

19 Përpara sesa të ftojme dëshmitaren ka disa çështje që
20 duhet të trajtohen.

21 Së pari, gjatë seancës së fundit, Mbrojtja e z. Thaçi,
22 ofroi një pjesë, një video që u shënuar për identifikim që
23 është dokument 1D00069. ZPS-ja kundërshtoi mbi bazën që
24 videoja nuk ishte e plotë dhe Mbrojtja u zotua që do të merrte
25 të gjithë versionin.

1 E kuptoj që ka pasur korrespondencë ndërmjet palëve për
2 sa i takon kësaj pike. Mbrojtja që prej kësaj kohe ka bërë të
3 disponueshme për ZPS-në versionin e plotë të videos, kështu që
4 ZPS-ja nuk më kundërshtim lidhur me pranimin e këtij
5 dokumenti.

6 A është e saktë kjo, znj. Mayer?

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Atëherë Trupi Gjykses do të japë një urdhër me gojë
10 lidhur me këtë pikë.

11 Videoja e shënuar për identifikim si 1D00096 do të
12 pranohet si provë materiale.

13 Ky është fundi i urdhrit të parë me gojë të Trupit
14 Gjykses.

15 Së dyti, Trupi Gjykses do të trajtojë kërkesën e ZPS-së
16 për pezullimin e afateve për redaktimet e transkriptove pas
17 pushimit të dimrit të gjykatës.

18 ZPS-ja kërkon që afati të zgjatet deri më datë 12 janar
19 2024. Ky është parashtrimi i protokolluar F01987. ZPS-ja
20 parashtron që shtyrja e afatit do t'i lejojë të gjithë palët
21 dhe pjesëmarrësit që të bëjnë një rishikim të kuptimtë të
22 transkriptove zyrtare të njoftuara dhe vetëm afatet graduale
23 për ZPS-në për të propozuar redaktimet dhe pjesë të tjera të
24 pjesëmarrësve do t'i përgjigjen në mënyrë efektive kërkesës
25 përkatëse.

1 A ka ndonjë kundërshtim nga Mbrojtjet?

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

6 Atëherë vazhdojmë mbi këtë bazë.

7 Trupi Gjykses e pranon kërkesën e ZPS-së që dokumenti
8 019987 në përputhje me rregullën 9(5), sa i takon afateve për
9 transkriptit për rishikimin e redaktimit do të shtyhet deri më
10 datë 12 janar 2024.

11 Ky është fundi i urdhrorit të dytë gojor të Trupit Gjykses.

12 Znj. Sekretare e Seancës, ju lutem silleni dëshmitaren në
13 sallë.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Nëse më lejoni, i nderuar Gjykatës,
15 dua që të ngre një çështje organizative.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
17 vazhdoni.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] E kuptoj që lista e dëshmitarëve për
19 janarin planifikohet që të nxirret të enjten. Duke marrë
20 parasysh që nuk do kemi seancë dhe shumë prej nesh do të jenë
21 në lëvizje të enjten, do kërkoja, në qoftë se është e mundur,
22 që lista e dëshmitarëve të bëhet e ditur të mërkurën.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuroria
24 është e mundur të bëhet një gjë e tillë.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do të konsultohem me zyrën time,

1 do koordinohem me dëshmitarët dhe do të mundohem që t'ju
2 jap një përgjigje pas pushimit të parë të ditës së sotme.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

4 Sekretare, silleni dëshmitaren në sallë.

5 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
7 Dëshmitare.

8 DËSHMITARJA: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të
10 vazhdojmë me dëshminë tuaj dhe shpresojmë që dëshminë tuaj ta
11 përfundojmë sot, sikurse e kërkuat dhe ju ditën e enjte.

12 Do të vazhdojmë së pari me Prokurorinë.

13 Prokurorja, a ka ndonjë pyetje plotësuese?

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shumë shkurtimisht kemi disa
15 pyetje.

16 DËSHMITARJA: SANDRA MITCHELL [Vijon]

17 Pyetje vijuese nga znj. Mayer:

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

19 PY. Mirëmëngjes, z. Dëshmitare. Javën e shkuar ju bënë pyetje
20 nga z. Kehoe dhe nga znj. O'Reilly lidhur me Dr. Kouchner dhe
21 konkretisht sa i takon z. Thaçi atij takimi me z. Kouchner.
22 Gjithashtu ju treguat disa video që kishin të bënë me artikuj
23 ose deklarata të z. Thaçi në gjysmën e dytë të 1999,
24 domethënë, në periudhën pasi ju u kthyet në Kosovë nga 14
25 qershori dhe në vijim.

1 A ju kujtohet kjo linjë pyetjesh që ju bënë, Dëshmitare.

2 PË. Po.

3 PY. Dua të përqendrohem tek kjo pikë.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares së seancës
5 që të paraqesë në ekran dokumentin SITF00172746 deri në
6 SITF00172747 RED.

7 PY. Të shohim faqen e parë të këtij dokumenti. A e shihni që
8 ky është një dokument nga Kouchner, UNMIK-u, Prishtinë dhe
9 dokumenti mban datën 29 korrik 1999. Dhe i drejtohet MIYE,
10 UNCTION, New York.

11 A e dini se kush është ky, domethënë, kush është marsi?

12 PË. Është sekretari i Kombeve të Bashkuara besoj se shikoj
13 kodet e kablllove këtu.

14 PY. Këtu thuhet, pra, sa i takon temës thuhet:

15 "Bashkëngjitur ju lutem gjeti një raport të takimit më
16 datë 27 korrik të SRSG-së dhe KFOR-it me Thaçin dhe Çekun sa i
17 takon transformimit të UÇK-së".

18 A e dini se çfarë do të thotë ky akronimi COMKFOR?

19 PË. Komandanti i KROR-it.

20 PY. E dini se në atë kohë kush ka qenë? Gjenerali Jackson?

21 PË. Në fillim të korrikut ka shumë të ngjarë që të ketë qenë
22 gjenerali Jackson komandanti i KFOR-it.

23 PY. Në rregull.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja tjetër, që
25 është SITF000172747 RED. Në fillim të kësaj faqeje thuhet

1 përsëri që bëhet fjalë për "Një takim të SRSG-së dhe të
2 COMKFOR-it ... më datë 27 korrik".

3 Keni dëshmuar si pjesë e dëshmisë tuaj që keni qenë të
4 pranishëm në disa takime me z. Thaçi dhe/ose me z. Çeku. A ju
5 kujtohet që në qoftë se keni pasur ndonjë takim me të dy këtë
6 persona me gjeneralin Jackson dhe me Dr. Kouchner?

7 PË. Nuk më kujtohet.

8 PY. Në rregull. Do të kalojmë disa pjesë të këtij dokumenti.
9 Tek përmbledhja - në qoftë se mund ta zmadhojmë këtë
10 paragrafin që vjen nën përmbledhje tek pika 1 - në fillim të
11 këtij paragrafi, thuhet:

12 "Një takim i vështirë për transformimin e UÇK-së, ku
13 Thaçi në mënyrë të vazhdueshme dhe insistuese parashtroi
14 synimet e UÇK-së për të formuar një ushtri në fund të
15 demilitarizimit ... dhe mohoi përgjegjësitë për aktet e kryera
16 në emër të UÇK-së që prej mbërritjes së KFOR-it."

17 Kur ka mbërritur KFOR-i, në qoftë se ju kujtohet?

18 PË. Menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës.
19 KFOR-i filloi që të futej në Kosovë. Do ketë qenë rreth datës
20 12 qershor 1999.

21 PY. Ky përshkrimi i mohimit të reagimeve ose të akteve, pra,
22 reagimi i z. Thaçi a ishte i njëjtë kur juve ngritët
23 pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut nga UÇK-ja?

24 PË. Po.

25 PY. A është kjo në përputhje po ashtu edhe me reagimin e

1 udhëheqësve të tjerë të UÇK-së që ju thatë që jeni takuar në
2 atë kohë kur ju keni ngritur pretendime të shkeljes së të të
3 drejtave të njeriut së bashku me të?

4 PË. Po.

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në qoftë se do të kalojmë tek
6 faqja tjetër e dokumentit, që është dokumenti SITF00172748

7 RED.

8 PY. Nën titullin "Forcat paramilitare". Këtu thuhet që:

9 "COMKFOR-i ishte i shqetësuar për elementët e policisë
10 ushtarake me uniforma të zeza."

11 Thuhet më tej që:

12 "Përgjigja e Thaçit ishte evazive".

13 Pra, në këtë përshkrim përmenden "elementët e PU-së". A
14 mund të na thoni, a e dini se çfarë janë këto elementët ose
15 çfarë do të thotë ky akronimi PU?

16 PË. Jo.

17 PY. E kuptoj. Përmendja e uniformave të zeza, a është në
18 përputhje me përshkrimin e individëve të UÇK-së që janë
19 raportuar që janë rrëmbyer, kur ju keni marrë këto raportet
20 nga OSBE, MVK-ja dhe nga UNMIK-u?

21 PË. Po.

22 PY. Në qoftë se do të shohim më sipër këtij paragrafi, i
23 gjithë paragrafi është në këtë faqe, megjithatë titulli që
24 është në faqen e mëparshme thotë "Okupacioni ose zënia e
25 vendeve tregtare".

1 E shikoni këtë paragrafin? Këtu thotë që:

2 "SRSG-ja" dhe ky është z. Kouchner, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Këtu thuhet që:

5 "SRSG-ja ngriti pretendimin e zënies së ambienteve
6 tregtare nga individë që pretendonin të ishin anëtarë të UÇK-
7 së ..."

8 Përsëri nuk do t'jua lexoj të gjithë paragrafin, mund ta
9 lexoni vetë. Të gjithë mund ta shohin në ekran. Megjithatë
10 vijohet më tej në këtë paragraf që:

11 "Pas një insistimi të vazhdueshëm Thaçi ra dakord më në
12 fund që të vizitohej një vend së bashku me SRSG-në dhe të
13 tregonte personat, t'ju thoshte personave të cilët kishin zënë
14 në mënyrë të paligjshme këtë vend që të largoheshin".

15 Përsëri, a është kjo në përputhje, domethënë, ky lloj
16 hezitimi nga ana e z. Thaçi, a është në përputhje me hezitimin
17 që ai ka treguar kur i është përgjigjur pretendimeve të
18 ngritura nga ju në takimet që keni qenë me të?

19 PË. Po.

20 PY. Të shkojmë tek faqja e fundit që është SITF00172749 RED,
21 nën titullin "Koment", në fillim fare thuhet që:

22 "Thaçi nuk është i gatshëm që të pranojë përgjegjësi për
23 asgjë që ka ndodhur në emër të UÇK-së dhe as që të marrë
24 përsipër detyrën për të treguar udhëheqësi, për të organizuar
25 një qasje të përbashkët të shqiptarëve të Kosovës për të

1 krijuar një administratë të qëndrueshme. Ai është përpjekur ta
2 bëjë të qartë që UÇK-ja ka të drejtë që ta drejtojë Kosovën
3 dhe shpejt të çohet ajo në pavarësi. Ai e di që kjo është nën
4 kundërshtim me Rezolutën e Kombeve të Bashkuara 1244, por
5 qartazi dëshiron që të testojë sesa mund, deri në çfarë pike
6 mund të shkojë për ta shtyrë UNMIK dhe KFOR-in për të pranuar
7 *'faits accompli'*" të UÇK-së.

8 Në takimet që keni pasur me të, a ka bërë deklaratë të
9 ngjashme z. Thaçi sa i takon të drejtës së UÇK-së për të
10 drejtuar Kosovën?

11 PË. Po.

12 PY. Prapë, nga takimet që keni bërë me z. Thaçi gjatë kësaj
13 periudhe që është fundi i korrikut të 1999 a ju krijua
14 përshtypja edhe juve, ashtu siç i është krijuar Dr. Kouchner,
15 që Thaçi po mundohej të ushtronte presion mbi faktorin
16 ndërkombëtar për të pranuar kontrollin e UÇK-së si punë të
17 mbaruar, si *fait accompli*?

18 PË. Po.

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera, të
20 nderuar Gjykatës. Por kërkoj që ky dokument të pranohen si
21 provë materiale, është dokumenti SITF00172749 deri në SITF0017
22 -- ju kërkoj ndjesë, e bëra gabim. Do e filloj nga fillimi.
23 Është SITF00172746 deri në SITF00172749 RED.

24 Do i kërkoja Trupit Gjykses që këtë dokument ta shtojnë
25 në listën e provave materiale, është një version më i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 10

1 lexueshëm dhe më i qartë i materialit SPOE00246103 deri në
2 SPOE00246106 që është dokumenti 11757 në listën e provave
3 materiale. Është nxjerrë më 18 gusht 2021. Ky dokument është
4 bërë i ditur dhe është renditur të premtën në paketë e
5 informacionit 1045 si një version më i kuptueshëm.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
7 çaktivizuar]

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim. E kuptoj
9 çështjen pranueshmërisë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
11 SITF00172749 pranohet si provë materiale dhe zëvendëson provën
12 materiale në provën e listës materiale me numër 11757.

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
14 nuk kam pyetje të tjera.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
16 mund t'i caktohet prova materiale P755. Ju lutem, a mund të më
17 konfirmoni sa i takon klasifikimit?

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do të klasifikohen si publike.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Nëse më lejoni, të nderuar anëtarë
20 të Trupit Gjykses, dëshiroj që të bëjë disa sqarime lidhur me
21 dokumentin që u tregua nga Prokuroria më herët?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
23 Vetëm shkurt, ju lutem.

24 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe:

25 Z. KEHOE: [Përkthim]

1 PY. Mirëmëngjes, znj. Mitchell. Pra, ju nuk keni qenë në këtë
2 takimin që ka bërë z. Kouchner, z. Thaçi, gjenerali Jackson
3 apo jo?

4 PË. Besoj se jo.

5 PY. Këtu flasim për periudhën e korrikut të 1999, ndërkohë që
6 javën që shkoi ne folëm për vështirësitë që ekzistonin me
7 policinë, me administratën, vështirësinë me UNMIK-un që ishte
8 futur në vend dhe që kishte filluar të merrte kontroll apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Gjatë kësaj periudhe ajo çfarë shohim është që kanë
11 ndodhur disa negociata, në qoftë se dëshironi mund të shikoni
12 këtë dokument.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk e di nëse mund tregojmë edhe një
14 herë në ekran dokumentin që u tregoi Prokurorja pak më herët.
15 Nëse më lejoni, kalojmë tek faqja e dytë e këtij dokumenti.

16 PY. Përmbledhja që sapo iu lexoi Prokurorja, kishte të bënte
17 pjesërisht me demilitarizimin e UÇK-së. Nga përvoja juaj, ju e
18 dini që kjo ishte një çështje shumë e vështirë për UÇK-në, në
19 veçanti kur flitej për çarmatimin e UÇK-së. A ju kujtohet kjo,
20 Dëshmitare?

21 PË. Po, kështu ishte.

22 PY. Në qoftë se do të ndjekim të njëjtën logjikë që ndoqi
23 Prokurorja, situata në Mitrovicë në pikën a), ambasadori
24 Kouchner i kërkoi z. Thaçi që edhe një herë të ndërhynte në
25 çështjet në Mitrovicë rreth datës 31 korrik 1999, siç mund ta

1 shikoni nga raporti që keni përpara. Dhe në fakt, Thaçi u
2 përpoq që të ushtronte ndikimin e vet, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Në qoftë se do të kalojmë tek faqja tjetër, në fillim të
5 faqes ku Prokurorja lexoi lidhur me çështjen e zënies së
6 ambienteve tregtare dhe pas fjalisë së fundit ju referua kësaj
7 fjalie që:

8 "Pas shumë insistimesh Thaçi u pajtua me ngurrim që të
9 vizitonte një vend" së bashku me ambasadorin Kouchner "dhe i
10 tregoi personave që të largoheshin nga ambienti tregtar që
11 kishin zënë".

12 Ai e bëri këtë gjë, apo jo? Domethënë, Thaçi po u thoshte
13 njerëzve që të largoheshin nga shtëpitë e personave të tjerë,
14 ishte kështu, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Le të kalojmë pak më poshtë në këtë dokument, sa i takon
17 COMKFOR-it, gjenerali Jackson që po fliste për qëndresën e
18 ushtrisë dhe kjo pikë thotë që UÇK-ja insistonte që dëshironte
19 që të kishte një ushtri në vend, a është e saktë kjo?

20 PË. Po.

21 PY. Nëse lexojmë këtë raport Jackson thotë që:

22 "... ushtria e propozuar ishte një problem edhe më i
23 madh. Sepse nuk ishte e mundur për UÇK-në të kishte një ushtri
24 përpara sesa të arrihej një marrëveshje përfundimtare
25 politike".

1 A e shikoni këtë pjesë? Këtë paragraf?

2 PË. Besoj që e lexuat gabim. Mendoj që bëhej fjalë, që ishte
3 për Kosovën jo për KFOR-in që dëshironin që të kishin një
4 ushtri.

5 PY. Ju kërkoj ndjesë. E thashë unë gabim. Megjithatë
6 vazhdohet më tej dhe thuhet që përdoret termi "Ministri i
7 Mbrojtjes". Megjithatë nuk kishte ministri të tillë dhe nuk
8 kishte as Qeveri të Përkohshme të z. Thaçi.

9 Tani, sipas dëshmisë tuaj, Thaçi po përpigëj që të
10 ushtronte ndikim të Qeverisë së Përkohshme dhe të UÇK-së,
11 ndërkohë që administrata e kombeve të Bashkuara po i thoshte
12 atij që "Nuk kishte as qeveri dhe nuk kishte as Ministri
13 Mbrojtjeje" dhe i thoshte që, në fakt, "ne jemi njësia që jemi
14 nën kontroll dhe jemi përgjegjës". Apo s'ishte kështu,
15 Dëshmitare?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe me gjithë këtë shkëmbim nga të dyja palët, në fund u
18 arrit që të kishte një çarmatim të plotë më 21 shtator të 1999
19 dhe UÇK-ja dorëzoi armët dhe u krijua TMK-ja, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Le të shohim dokumentin SITF00173538 deri në
22 SITF00173542. Përsëri ky është një mesazh që dërgohet nga
23 ambasadori Kouchner në Nju Jork për Kombet e Bashkuara, data
24 është 21 shtator 1999. Kjo është faqja e parë e këtij
25 dokumenti. Nëse mund të kalojmë tek faqja tjetër, ku flitet

1 për krijimin e TMK-së.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe në qoftë se do të zbresim katër
3 paragrafë në të njëjtën faqe.

4 PY. Dhe thuhet që:

5 "TMK-ja do të përfshijë 3.000 anëtarë aktivë dhe 2.000
6 anëtarë rezervë ..."

7 Pra, ideja e komunitetit ndërkombëtar ishte që të rinjtë
8 që kishin qenë pjesë e UÇK-së do të kalonin në TMK dhe do t'ju
9 jepnin atyre një punë e do t'i lejonin ata që të ishin
10 produktivë në shoqëri, apo jo, z. Dëshmitare?

11 PË. Po.

12 PY. TMK-ja do të ofronte gjithashtu shërbime emergjente dhe
13 shërbime të tjera, a është kështu?

14 PË. Po.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja tjetër. Pra,
16 është dokumenti që mban titullin "Demilitarizimi dhe
17 transformimi i UÇK-së".

18 PY. Nuk do ta lexojmë të gjithë këtë faqe, megjithatë
19 dëshiroj që të shikojmë fjalinë e parë të paragrafit të parë.

20 "Koncepti i transformimit ... të ish-forcave luftarake në
21 rol civil është krijuar si një praktikë paqeruajtëse".

22 Ndërkohë që në qoftë se vazhdojmë në fjalinë përkatëse,
23 në fjalinë në paragrafin tjetër thuhet që:

24 "Demilitarizimi është problematik në çdo shoqëri. Dhe ...
25 ekziston një ndjenjë e fortë e pronësisë mbi procesin dhe një

1 faktor i fortë politik që është i zakonitë në çdo ambient pas
2 konflikti”.

3 Pra, është e zakonitë këtu siç thuhet që transformimi në
4 vetvete është një proces i vështirë, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Le të vazhdojmë me paragrafin 3:

7 “Disa ish-luftëtarë do të lëvizin në krim të organizuar
8 në qoftë se ata nuk kanë mundësi punësimi, ndërkohë që ka
9 njësite të tëra të cilat raportohen që janë rekrutuar nga
10 sindikata kriminale shqiptare. Ndërkohë luftëtarë të tjerë do
11 të kalojnë në botën e errët në qoftë se ata do të ndihen të
12 mashtruar”.

13 Dhe vazhdon më tej paragrafi. Pra, përsëri është e
14 pranuar që në qoftë se personat nuk angazhohen atëherë ata do
15 të përfshihen në krim të organizuar dhe do t’i shërbejnë
16 interesave të veta në qoftë se nuk kanë mundësi të tjera
17 punësimi, domethënë, kjo është pjesë e mesazhit, apo jo, znj.
18 Dëshmitare?

19 PË. Po.

20 PY. Le të kalojmë tek paragrafi i katërt:

21 “Nën këtë zhvillim, KFOR-i, në konsultim të fortë të
22 ngushtë me UNMIK-un ka zhvilluar një koncept për një forcë
23 civile të disiplinuar të uniformuar, multi-etnike, të modeluar
24 sipas sigurimit civil të Francës. TMK-ja do të ofrojë shërbime
25 emergjente dhe shërbime të tjera të specializuara”, apo jo?

1 Përsëri, domethënë, kjo është ajo çfarë mendohet ose
2 pikëpamja e komunitetit diplomatik sa i takon transformimit
3 dhe sa i takon krijimit të TMK-së, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe ky qëllim ose ky transformim i UÇK-së në TMK është
6 realizuar përmes realizimit ose përmes përdorimit të forcave
7 të UÇK-së dhe është drejtuar nga aspiratat e veta, ky është
8 një objektiv ose një qëllim i cili është përqafuar dhe është
9 përgëzuar nga komuniteti ndërkombëtar në atë kohë - nga
10 Presidenti Clinton, nga kryeministri Blair i Mbretërisë së
11 Bashkuar në atë kohë, nga sekretari i përgjithshëm i NATO-s,
12 pra, kjo është një përpjekje e cila është përqafuar nga figura
13 të larta, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Tani le të kalojmë tek dokumenti i fundit dhe do
16 përfundoj këtu.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Është dokumenti SITF00172765 deri në
18 SITF00172784

19 PY. Ky është një mesazh në të njëjtën ditë po nga ambasadori
20 Kouchner. Ju i drejtoheshit si Dr. Kouchner apo ambasadori
21 Kouchner? Se s'e kam kuptuar asnjëherë.

22 PË. Në OKB e thërrisnin Dr. Kouchner nuk e përdornin titullin
23 ambasador.

24 PY. Faleminderit. E vlerësoj. Pra, Dr. Kouchner ia dërgon
25 sërish këtë mesazh. Shkojmë në faqen tjetër, është një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 17

1 deklaratë nga gjeneral Çeku në përputhje me Rezolutën 1244 të
2 sigurisë së Kombeve të Bashkuara dhe thotë:

3 "... flitet për marrëveshjen për demilitarizimin dhe
4 transformimin e nënshkruar më 21 qershor 1999 e marrë nga
5 komandanti i KFOR-it, deklaroj se UÇK-ja ka respektuar të
6 gjitha dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe ka përfunduar
7 procesin e demilitarizimit".

8 Në faqen e radhës është një deklaratë nga z. Thaçi dhe
9 faqet pasardhëse -- do lutesha të shkonim tek rregullorja e
10 UNMIK-ut, 1999/8 për themelimin e Trupave të Mbrojtjes së
11 Kosovës. Nuk do ta lexoj të gjithë dokumentin. Mund ta lexoni
12 vetë nëse është e nevojshme.

13 Po, znj. Mitchell, marrëveshja është bërë më 21 dhe e
14 pamë në bazë të këtij dokumenti që ua shfaqti dhe Prokuroria
15 dhe diskutuat në lidhje me këtë dokument - më fal - ka pasë
16 diskutime mes gjeneralit Çeku, z. Thaçi, Dr. Kouchner lidhur
17 me këtë dokument dhe gjeneralit Jackson. Po, në fund të
18 fundit, në shtator përfundoi procesi i demilitarizimit të UÇK-
19 së dhe u krijua TMK-ja, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Edhe krahas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, z. Thaçi,
22 aso kohe, po ashtu promovonte krijimin dhe trajnimin e forcës
23 policore të Kosovës, apo jo?

24 PË. Po.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 18

1 pranohet si provë dokumenti SITF00173538 deri në 173542 që
2 është dokumenti i parë që përmenda. Ndërsa dokumenti i dytë
3 është dokumenti që ka lidhje me Trupat e Mbrojtjes së
4 Kosovës, TMK-në, me numër SITF17265 dhe SITF172784. Që është
5 dokumenti paraprak plus rregullorja. Doja të thoja rregullorja
6 e UNMIK-ut se e thashë gabim qëparë 1999/8.

7 Do të donim që kjo të pranohej si provë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
9 kundërshtim?

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] S'kemi as kundërshtime për këtë,
11 as për klasifikimin si dokumente publike të dy dokumenteve.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe për
13 dokumentet tuaj?

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
16 atëherë. Dokumenti SITF00173538 deri në 173542 dhe 00172765
17 deri në 00172784 pranohen si prova dhe riklasifikohen si
18 dokumente publike, gjithashtu do të riklasifikohet si dokument
19 publik material i me numër SITF00172746 deri në 172749.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Më falni. Po.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti i parë
22 SITF00173538-00173542 merr numrin e provës materiale 1D98 dhe
23 do të jetë dokument publik.

24 Dokumenti i dytë me numër SITF00172765 deri në 00172784,
25 merr numrin e provës materiale 1D99 dhe po ashtu

1 riklasifikohet si publik.

2 Në mënyrë të ngjashme, të nderuar Gjykatës, prova
3 materiale P755 do të riklasifikohet si publike.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Do të bëj një korrigjim, fola
5 gabimisht.

6 PY. Qëparë se thashë gjenerali Clinton. Desha të thoja
7 Presidenti Clinton edhe kryeministri Blair, uroj që të më keni
8 kuptuar?

9 PË. Po, po e kuptova ç'deshët të thoni.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
12 O'Reilly?

13 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts?

15 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi më pyetje.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kemi më pyetje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
19 atëherë. [Mikrofoni çaktivizuar].

20 Pyetje nga Trupi Gjykses:

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëmëngjesi, Dëshmitare.

22 PË. Mirëmëngjesi.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Edhe Trupi Gjykses ka disa
24 pyetje për ju. Uroj të mos jetë një problem kjo për ju.

25 PË. Sigurisht që jo.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e parë e imja është
2 kjo. Javën e kaluar gjatë pyetjeve që bëri Prokurorja, ju
3 thatë se keni pasur takime me anëtarë të UÇK-së, përfshirë z.
4 Thaçi, ku folët për arrestimet, rrëmbimet, zhdukjet dhe
5 ndalimet e personave nga persona që mbanin uniforma të zeza me
6 emblemën e UÇK-së.

7 Më pas thatë se "kishte pasur disa protesta të vogla
8 jashtë selisë në Prishtinë nga familjet serbe që deshën të
9 dinin ku ishin personat e zhdukur sepse kishe disa serbë që
10 nuk dihej më ku ishin".

11 Ju kujtohet që ju e thatë diçka të tillë?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbal i
14 referohesha faqes 10536 të transkriptit rreshtat 19 deri në
15 22.

16 Pyetja ime e parë është kjo: A ka pasur artikuj në media
17 për këto incidente, për këto rrëmbime, zhdukje dhe ndalim të
18 personave nga burra të veshur me të zeza dhe që mbanin emblema
19 të UÇK-së?

20 PË. Besoj se po.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur fillojë mbulimi në media
22 i këtyre rrëmbimeve dhe ndalimeve, nëse e dini?

23 PË. I nderuar Gjykatës, sa i takon serbëve që janë deklaruar
24 të zhdukur, kanë filluar në verën e vitit 1998 dhe vazhduan
25 edhe më pas në periudha të ndryshme apo në momente të ndryshme

1 në media.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A e dini ku
3 janë përcjellë këto artikuj, vetëm në shtypin ndërkombëtar apo
4 vetëm në shtypin vendas?

5 PË. Besoj se në mediat ndërkombëtare, në mediat serbe. Për
6 mediat shqiptare nuk di gjë, nuk kam dijeni.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni dijeni që të ketë pasë
8 ndonjë botim apo deklarata publike në media apo në vende të
9 tjera, ku UÇK-ja e ka pranuar apo mohuar përgjegjësinë për
10 këto vepra të pretenduara?

11 PË. Jo, nuk po them që s'ka ndodhur. Po desha të them që mua
12 nuk më kujtohet diçka e tillë.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja e
14 radhës lidhet me periudhën kohore shkurt-prill 1999, mes
15 shkurtit dhe prillit. Besoj se ju e përmendët edhe me
16 Prokurorinë javën e kaluar marrëveshjen e dështuar në Rambuje
17 dhe e përsëritët disa herë këtë gjë.

18 A e dini nëse lirimi i personave të rrëmbyer nga të dyja
19 palët në konflikt a ka qenë temë e negociatave në Rambuje,
20 diçka që është diskutuar në Rambuje?

21 PË. Jo. Do hamendësoja.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, ju
23 lutem vendosni në ekran dokumentin ET-05-87 P00474 në ekran
24 dhe shkojmë në faqen 2. Faleminderit.

25 Znj. Mitchell, a shihni në fund tek titulli "Ndalimi i

1 luftëtarëve dhe aspekte të drejtësisë”, pika 10 ku thuhet:

2 “Të gjithë personat e rrëmbyer apo persona të tjerë që
3 janë mbajtur pa akuza, do të lirohen. Palët lirojnë dhe
4 transferojnë në përputhje me këtë marrëveshje të gjithë
5 personat që janë mbajtur në lidhje me konfliktin”.

6 E shihni këtë fjali?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, a mund
9 të kthehemi në faqen 1 të dokumentit, ju lutem?

10 Znj. Mitchell, kjo është marrëveshja e ndërmjetme për
11 paqe dhe vetëqeverisje në Kosovë, e thënë ndryshe marrëveshja
12 e Rambujesë, 23 shkurt 1999, neni 2. Pajtoheni me këtë?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të martën e shkuar ju bëri
15 pyetje Prokuroria nga e mësuat ju personalisht dhe ekipi juaj
16 informacionin persona të ndaluar apo të zhdukur dhe ju u
17 përgjigjët që kjo kishte qenë një stres i madh për popullatën
18 në Kosovë në atë kohë edhe se drejtuesit, udhëheqësit lokalë
19 edhe persona të tjerë vinin në zyrat tuaja dhe raportnin
20 faktin që anëtarë të familjes ishin zhdukur. Ju kujtohet?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo është në faqen 10528,
23 rreshtat 7 deri në 13 të transkriptit.

24 Pyetja ime është kjo, këta personat që erdhën në zyrën
25 tuaj për t’ju njoftuar për zhdukjen e anëtarëve të familjes, a

1 ju thanë gjithashtu se kishin kontaktuar ndërkohë UÇK-në,
2 qoftë UÇK-në lokale apo në nivele më të larta?

3 PË. Disa prej tyre po.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Çfarë reagimi kishin pasur
5 këta persona që ata kishin kontaktuar, jua kanë thënë diçka në
6 lidhje me këtë?

7 PË. Po. Disa u kishin thënë se UÇK-ja, mund të kishin thënë
8 "Po janë të ndaluar dhe se janë mirë të ndaluarit". Herë të
9 tjera e kanë mohuar përfshirjen.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Mitchell, ju na treguat
11 për takimet që ju personalisht keni pasur me z. Thaçi gjatë
12 kohës suaj në Kosovë në 1998 dhe 1999. A mund të jepni më
13 shumë hollësi si u bënë këto takime? Besoj se keni folur
14 anglisht? Keni folur anglisht apo shqip me z. Thaçi? Ju folët
15 anglisht, z. Thaçi shqip?

16 PË. Po, unë isha me përkthyes.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Si do e përshkruanit
18 marrëdhënien mes z. Thaçi dhe anëtarëve të tjerë të UÇK-së që
19 kanë qenë të pranishëm në takim, pra, si e trajtonin anëtarët
20 e tjerë të UÇK-së z. Thaçi, mund të na thoni diçka në lidhje
21 me këtë?

22 PË. Besoj se i drejtoheshin z. Thaçi.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju vutë re që kishte
24 një farë hierarkie mes z. Thaçi dhe anëtarëve të tjerë të UÇK-
25 së?

1 PË. Po, zotëri.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Mitchell, pasi na dhatë
3 përshtypjet tuaja për z. Thaçi gjatë takimit gjatë edhe pas
4 luftës, a mund të na tregoni diçka lidhur me tre të akuzuarit
5 e tjerë që kemi këtu? A keni takuar personalisht ndonjë prej
6 tyre?

7 PË. Nuk më kujtohet diçka e tillë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini çfarë roli apo
9 funksioni kanë pasë tri të akuzuarit e tjerë gjatë luftës? Për
10 shembull, a kanë qenë anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të
11 UÇK-së, e dini këtë?

12 PË. Mesa kuptoj unë, kanë qenë anëtarë të UÇK-së, po në vija
13 të përgjithshme.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po jo të Shtabit të
15 Përgjithshëm.

16 PË. Nuk më kujtohet diçka e tillë.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni diskutuar ndonjëherë
18 për z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi në takimet që keni
19 pasur me kolegët tuaj në 1998 apo 1999, a ka dalë nevoja të
20 flisnit për ta? Ju kujtohet?

21 PË. Nuk më kujtohet gjë konkrete.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini nëse ndonjë prej
23 tyre apo të gjithë të akuzuarit janë ballafaquar me
24 organizatat ndërkombëtare apo me mediat për rrëmbime të
25 mundshme që mund të ishin kryer nga anëtarë të UÇK-së të

1 pretenduara?

2 PË. Vetëm emrat ju njoh, nuk di më shumë se kaq.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Mitchell, pyetja e
4 radhës lidhet konkretisht me periudhën prill-shtator 1999, kur
5 e ashtuquajtura Qeveri e Përkohshme e Kosovës u krijua.

6 Do të doja t'ju pyesja fillimisht a mund të na thoni
7 çfarë dini lidhur me krijimin e Qeverisë së Përkohshme,
8 Veçanërisht, çfarë marrëdhënie kishte Shtabi i Përgjithshëm i
9 UÇK-së apo anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së me
10 Qeverinë e Përkohshme të Kosovës?

11 PË. Mesa kam kuptuar unë në atë kohë, ishin e njëjta gjë.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në fakt kisha pyetjen e
13 radhës në këtë fushë. A e dini në qoftë se disa anëtarë të
14 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së u shkarkuan apo u
15 zëvendësuan pranë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së pas
16 krijimit të Qeverisë së përkohshme të Kosovës?

17 PË. Jo, nuk kam informacion për detale të tilla.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Përgjithësisht
19 çfarë roli kishte Qeveria e Përkohshme e Kosovës pas tërheqjes
20 së forcave jugosllave apo serbe në qershor të 1999?

21 PË. Pas Rezolutës së Këshillit të Sigurisë, nuk kishin asnjë
22 rol zyrtar. Po faktikisht ata u angazhuan, u përfshinë pra, në
23 mungesë të aparatit politik apo të aparatit të sigurisë jashtë
24 Kosovës apo jashtë KFOR-it, përveç KFOR-it dhe emëruan persona
25 si kryetarë komunash, u përpoqën të bënë disa emëime në

1 mënyrë që të krijonin një formë apo një lloj administrate
2 publike civile.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A dini në qoftë se z. Thaçi
4 si kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës ka lëshuar
5 vendime politike, urdhra juridikë apo deklarata gjatë kësaj
6 periudhe kohore?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni parë ndonjë prej këtyre
9 urdhrave, deklaratave, vendimeve?

10 PË. Faktikisht, persona më kanë thënë vetëm që janë emëruar,
11 për shembull, si kryebashkiak nga z. Thaçi, por ama nuk kam
12 parë ndonjë dokument konkret.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Mesa keni dijeni
14 ju, z. Thaçi a takohej me përfaqësues ndërkombëtarë për
15 aspekte të politikave vendase apo të huaja, përveçse me
16 anëtarët e zyrës suaj, në qoftë se keni dijeni?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund ta shtjelloni më
19 shumë në lidhje me këtë?

20 PË. Shpesh bëheshin takime me z. Kouchner, me përfaqësues të
21 Komunitetit Evropian për çështjen e rindërtimit, besoj se
22 mbaheshin konferenca me donatorët ku ai fliste. Me KFOR-in
23 patjetër, COMKFOR-in. Takohej me OSBE-në. Nuk më kujtohej sesa
24 herë takohej me UNCHR-në për shembull.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja e

1 radhës është, në vija të përgjithshme, si do ta përshkruanit
2 ju situatën e sigurisë pas tërheqjes së forcave serbe më 20
3 qershor 1999? A kishte veprime armiqësore apo provokuese nga
4 forcat serbe dhe/ose nga UÇK-ja?

5 PË. Unë kam qenë në Prishtinë pjesë e ekipit të avancuar dhe
6 forcat serbe ishin ende të pranishme në Prishtinë, bënë
7 plaçkitje, vepra të kësaj natyre. Askush nuk mund t'i ndalonte
8 në atë kohë. Besoj se u bënë përpjekje. Po siguria ishte shumë
9 e dobët, situata e sigurisë ishte shumë e dobët. Dhe shumë pak
10 persona. Sepse kur u kthyen personat, mund të shihje që
11 filluan që të krijoheshin disa autoritete policore që unë i
12 quaj *de facto*.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kishte ende luftime në disa
14 pjesë të vendit me sa keni ju dijeni?

15 PË. Shumë pak. Mund të them që kishte luftime po jo
16 domosdoshmërisht mes serbëve dhe forcave ndërkombëtare. Mund të
17 ketë pasur vende-vende qëndresa, po kjo ishte një periudhë që
18 pati një farë situatë të pasigurt civile apo rebelimi civil,
19 trazirash civile e thënë ndryshe.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më konkretisht, po për UÇK-
21 në kishte luftime mes UÇK-së apo elementëve të UÇK-së dhe
22 forcave serbe apo jugosllave?

23 PË. Kishte mosmarrëveshje mes UÇK-së dhe serbëve, qofshin
24 këta MUP-i apo armata jugosllave, nuk më kujtohet konkretisht
25 se kush ka qenë prej tyre. Sepse pjesa më e madhe u tërhoqën.

1 Në pjesën veriore të Mitrovicës ka pasur dhunë të vazhdueshme
2 por sërish besoj se kjo ishte më shumë mes civilëve serbë.
3 Mund të kenë qenë pjesë edhe e aparatit serb me veshje civile
4 në pjesën veriore të Kosovës. Se besoj që është ende situata
5 edhe sot e kësaj dite e tillë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kam disa
7 pyetje tjera sa i takon takimeve që keni pasur me z. Thaçi.

8 Në intervistën me Task Forcën Hetimore Speciale më
9 qershor 2014, që është prova materiale 013312 deri në 013334,
10 faqja 18, pika 5, ju thoni që:

11 "Kur ndërkombëtarëve u duhej diçka i drejtoheshin UÇK-së
12 dhe, veçanërisht, z. Thaçi, u bë pika e kontaktit ose personi
13 që ne i drejtoheshim për të marrë informacione qoftë në nivel
14 lokal apo në nivel ndërkombëtar".

15 A ju kujtohet kjo?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na shpjegoni çfarë
18 keni dash të thoni konkretisht ju me këtë? Çfarë ofronte z.
19 Thaçi në nivel lokal apo në nivel kombëtar? Besoj se përmendët
20 një shembull gjatë seancës përgatitore me ZPS-në që ishte në
21 lidhje me Mitrovicën.

22 PË. Më kujtohet rasti i Mitrovicës më shumë. Pjesërisht,
23 sepse kisha qenë dhe vetë në Mitrovicë ku kishte pasë
24 përplasje, pati gaz lotsjellës, u hodh gaz lotsjellës. Dhe më
25 kujtohet një rast konkret -- po përpiqem të kujtoj kush ka

1 qenë drejtori rajonal. Mbase Jacques Klein. Patëm, bëmë
2 telefonata në mënyrë që të shpërndahej një turmë me shqiptarë
3 edhe u përpoqëm që të kontaktonim udhëheqjen serbe në pjesën
4 veriore të Mitrovicës, pra, të dyja palët përpiqeshin ta
5 qetësonin turmën shqiptare, po njëkohësisht ta qetësonin dhe
6 turmën serbe. Dhe kjo qe e suksesshme. Të dyja turmat u
7 shpërndanë me kërkesë të z. Thaçi.

8 Ky është shembulli më i mirë që më kujtohet, se më
9 kujtohet gazi lotsjellës më konkretisht.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që ta kuptoj unë tamam, z.
11 Thaçi bëri telefonatat?

12 PË. Jo, jo. Telefonatat u bënë nga drejtori rajonal ose Daan
13 Everts. Nuk më kujtohet konkretisht kush e ka kontaktuar z.
14 Thaçi por dikush nga OSBE-ja e kontaktoi dhe nga zyra rajonale
15 e UNMIK-ut.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Me sa ju kujtohet, çfarë
17 bëri z. Thaçi?

18 PË. Kontaktoi udhëheqësit shqiptarë që ishin atje në terren
19 dhe u kërkoi të tërhiqeshin dhe të shpërndanin turmën,
20 grumbullimet dhe kjo funksionojë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nga e dini ju këtë?

22 PË. Sepse turmat u shpërndanë, u tërhoqën, u larguan nga ura.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo. Ku e dini ju që ka qenë
24 z. Thaçi ai që e bëri këtë?

25 PË. Ma kanë thënë.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kush?

2 PË. Mbase drejtori rajonal i OSBE-së ose shefi i misionit në
3 atë zyrë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Znj. Mitchell,
5 në paragrafin 52 të deklaratës suaj, ju thatë që:

6 "Dy anëtarët e UÇK-së që ishin më të pranishëm pas luftës
7 ishin Agim Çeku dhe Hashim Thaçi. Çeku konsiderohej si një
8 person, një ushtar profesionist dhe si një person përgjegjës
9 për NATO-n".

10 "Ndërsa Thaçi" apo z. Thaçi "vërtetë shihej si personi që
11 kishte pushtet dhe që kontrollonte punimet e organizatës. Ai
12 shihej si personi që mund të mbulonte si aspektet ushtarake
13 dhe politike dhe ne e kuptuam që ai kontrollonte elementet
14 diku më të fshehta të UÇK-së, si, për shembull, shërbimet e
15 zbulimit, Ministrinë e Rendit Publik, policinë".

16 Dhe do të doja të më thonit më konkretisht çfarë keni
17 dashur të thoni me këtë, ku dolët, si dolët ju në përfundimin
18 që ishte z. Thaçi drejtuesi i UÇK-së që vërtetë kishte
19 pushtetin dhe që kontrollonte punimet e brendshme të
20 organizatës?

21 PË. Mënyra sesi grumbullonim ne informacion, sikurse dhe ua
22 kam përmendur, fillimisht ishte përmes bisedimeve me zyrtarët
23 vendorë, lokalë, duke folur me këta zyrtarë, ata na kujtonin
24 se ishin emëruar nga z. Thaçi apo përfaqësonin Qeverinë e
25 Përkohshme të Kosovës edhe bënin deklaratatë të natyrës që "Ne

1 duhet të kontaktonim zyrën e tij për informacione shtesë" apo
2 për informacione të kësaj natyre.

3 Pra, këtë informacion ne e merrnim nga persona që kishin
4 poste lokale qofshin këta kryetarë komunash, kompanitë e
5 shërbimeve publike. Sidomos për energjinë elektrike, më
6 kujtohet sepse në vende të caktuara të qytetit ku jetonin
7 pakica, kishte ndërprerje të vazhdueshme të energjisë
8 elektrike edhe dilte shpesh emri i tij edhe në këto kontekste.

9 Edhe nga përfaqësuesit e KFOR-it kur përpigeshin të
10 kuptonin a ishin këto vepra penale, a ishin cenime të të
11 drejtave të njeriut. Në këtë kontekst na jepnin përshtypjen e
12 tyre lidhur me situatën, kështu që një nga burimet e tjera të
13 informacionit ishte pikërisht kjo.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Konkretisht pse mendonit ju
15 se ishte ai personi që kontrollonte elementet disi më të
16 fshehta të UÇK-së? Ju thatë shërbimet e zbulimit, thatë
17 Ministrinë e Rendit Publik, policinë, agjencitë e zbatimit të
18 ligjit apo personat që bënin zbatimin e ligjit?

19 PË. Më kujtohet një herë dhe kjo është në një raport,
20 oficerët e policisë, oficeri i policisë i UÇK-së kishte një
21 kartë biznesi dhe aty ishte dhe një lloj autoriteti,
22 domethënë, aty ishte vënë dhe një titull - më falni - ishte
23 një titull, kishte një dokument që nuk mund të jepet pa ia
24 dhënë miratimin udhëheqja për të mbajtur një dokument të
25 tillë, kartëvizitë, domethënë, një lloj kartëvizite.

1 A mund të ma bëni edhe njëherë pyetjen? Se unë nuk e
2 kuptova mirë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në fakt po kërkoja bazën. Ku
4 e bazoni ju hamendësimin tuaj që z. Thaçi ishte ai që
5 kontrollonte elementet e fshehta si shërbimi i zbulimit, a
6 Ministrinë e Mbrojtjes?

7 PË. A këtë e kemi marrë nga KFOR-i si informacion fillimisht.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në faqen 19,
9 paragrafi 15 ju keni thënë.

10 "Merrja pjesë në takime me Thaçin apo me Çekun,
11 ndonjëherë të dy bashkë edhe në pesë-gjashtë raste jemi takuar
12 për aspekte të të drejtave të njeriut ... Thaçi dhe çeku i
13 mohonin menjëherë pretendimet dhe përpiqeshin ta kthenin, ta
14 përmbysnin situatën dhe thonin që në fakt viktimat janë
15 shqiptarët dhe ne duhet të hetojmë serbët nuk duhet hetuar
16 UÇK-ja".

17 Pyetja e para është: Është e saktë kjo që thashë?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Mitchell, a mund të na
20 thoni çfarë ka thënë z. Thaçi dhe z. Çeku konkretisht, si i
21 rrëzonin këto pretendime, me sa ju kujtohet?

22 PË. Nuk u përgjigjeshin, nuk reagonin. Heshtnin.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju gjithashtu thatë gjatë
24 pyetjeve që ju bëri ZPS-ja të martën e shkuar dhe bëhet fjalë
25 për periudhën kohore qershor deri në shtator apo tetor të

1 1999, ju thatë:

2 "... se kishte raporte që UÇK-ja rrëmbente persona,
3 arrestonte persona, i merrte për bisedime informuese edhe
4 ish-in të përfshirë në një sërë aktivitetesh që nga djegiet e
5 shtëpive, kërcënonin personat, serbët, romët të largoheshin
6 nga regjioni. Dhe këto informacione vinin nga të gjitha
7 provincat, pra, nga të gjitha pjesët e Kosovës me kalimin e
8 kohës".

9 Dhe kjo është në faqen 10591 në transkriptit, rreshtat 12
10 deri në 17.

11 Më pas ju tregoi videon Mbrojtja e Thaçit ku z. Thaçi
12 bënte thirrje për paqe, për pajtim dhe për një Kosovë shumë
13 etnike. Po ashtu dëgjua për persona që vishnin uniformat e
14 UÇK-së dhe pretendonin se ishin të UÇK-së dhe kryenin vepra
15 penale në emër të UÇK-së.

16 Në këtë kontekst, Trupi Gjykses ka nevojë të dijë si në
17 vijim: Z. Thaçi apo ndonjë përfaqësues tjetër i UÇK-së që keni
18 takuar ju në këtë periudhë kohore, pra, qershor-tetor 1999, a
19 ju ka thënë ndonjë prej tyre se i kishin kërkuar UNMIK-ut,
20 KFOR-it apo ndonjë organizate tjetër ndërkombëtare të
21 pranishme në Kosovë aso kohe që të interesoheshin për këto
22 krime apo për krime ku pretendohet se persona të veshur me
23 uniformat të UÇK-së kryheshin, pra, këto krime që ishin kryer,
24 apo se kanë qenë në kontakt me autoritetet e sipërpërmendura,
25 pra, UNMIK-un apo KFOR-in për t'i ndaluar këto krime?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, z. Thaçi ju tha që
3 ishte në kontakt me UNMIK-un dhe KFOR-in për t'i ndaluar këto?

4 PË. Ndoshta nuk më ka thënë vetë, por më kujtohet dhe kjo
5 është në raport që ka patur raste kur ata ishin në fakt të
6 frustuar dhe thonin që përgjegjësinë e kishte KFOR-i apo
7 UNMIK-u për këtë çështje dhe duhet të flisnin me ta.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Po pyetja ime
9 ishte paksa e ndryshme. Unë doja të dija nëse z. Thaçi të ka
10 thënë ty që ka qenë në kontakt me KFOR-in dhe që e ka ngritur
11 çështjen e krimeve të kryera nga persona të cilët pretendonin
12 se ishin anëtarë të UÇK-së të veshur me uniformë të UÇK-së?

13 PË. Nuk më kujtohet në mënyrë të saktë, por mund të ma ketë
14 thënë në një takim.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në një
16 intervistë me ZPS-në në 2018, 2019, që është prova materiale
17 076286-07640, faqja 11, paragrafi 42, përmendet që "udhëheqja
18 e UÇK-së nguronte që të fliste publikisht për të dënuar dhunën
19 dhe nuk ka bashkëpunuar për të identifikuar kryesit e
20 pretenduar".

21 Dhe ju thatë më pas që udhëheqja e UÇK-së nuk ishte e
22 gatshme që ta ndalonte dhunën apo që t'i thoshte popullatës që
23 dhuna nuk ishte e jona. Pavarësisht se janë bërë disa
24 deklarata për median ndërkombëtare nga udhëheqja e UÇK-së pas
25 trysnisë nga KFOR-i apo UNMIK-u, këto deklarata nuk janë

1 botuar në median vendore”.

2 Znj. Mitchell, a mund të shpjegoni si është bërë kjo
3 trusni mbi udhëheqjen e UÇK-së? Unë besoj që ju apo zyra juaaj,
4 në fakt, jeni përpjekur për ta bindur UÇK-në për të bërë
5 deklarata të kësaj natyre apo jo?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëhere çfarë keni bërë për
8 ta arritur një gjë të tillë?

9 PË. Unë kam shkuar tek eprori im, tek ambasadori Everts apo
10 zëvendësi i tij, me të marrë informacionin dhe e diskutonim
11 këtë dhe i kemi kërkuar atij për këto takime. I kam paraqitur
12 edhe disa pika për bisedime. Dhe po kështu kam koordinuar dhe
13 Bill O’Neill nga zyra e përfaqësuesit të sekretarit të
14 përgjithshëm për të kërkuar që z. Kouchner të ndërmernte
15 veprime të ngjashme dhe po kështu edhe Dennis McNamara i
16 UNHCR-së. Në atë pikë, unë nuk kam qenë e angazhuar me
17 shtyllën e rindërtimit të BE-së.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po cili është reagimi i UÇK-
19 së apo i z. Thaçi apo i z. Çeku nga këto çështje?

20 PË. Unë kam dëgjuar ose më kanë thënë që këto çështje janë
21 ngritur dhe ajo që më kujtohet është që këta nuk ishin
22 pjesëtarë të UÇK-së po persona që kishin veshur uniformat e
23 tyre, ishin kriminelë apo persona të cilët pretendonin se
24 ishin ushtarë të UÇK-së.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe, në fund,

1 në paragrafin pasues të deklaratës suaj për ZPS-në, paragrafi
2 43, ju arritët në përfundimin dhe citoj që:

3 "Ideja që UÇK-ja nuk ushtronte kontroll apo nuk ishte në
4 gjendje që ta kontrollonte këtë dhunë nuk është e besueshme".

5 Ju thatë më tutje:

6 "Që po t'i mendonit këto raste kur z. Thaçi dhe z. Çeku
7 kanë kërkuar vetëpërbajtje, kjo ka ndodhur. Për shembull,
8 janë dhënë udhëzime për të mos sulmuar romët në urë e Pejës
9 dhe fëmijëve u thanë që të mos i sulmonin këto fëmijë në
10 shkollë. Në Mitrovicë, ka patur shembuj kur është shfaqur
11 dhunë dhe udhëheqja e UÇK-së i ka ushtruar trysni ndaj
12 popullatës shqiptare dhe i ka detyruar që të tërhiqen".

13 Znj. Mitchell, a mund të na tregoni në këto tre raste,
14 për shembull, rasti i sulmeve ndaj romëve nën urën e Pejës apo
15 fëmijëve apo ngjarjes së Mitrovicës? Kjo ka ndodhur kjo
16 përpara apo pas largimit të forcave serbe në qershor të vitit
17 1999?

18 PË. Këto tre incidente kanë qenë pas tërheqjes së forcave
19 serbe. Rasti i fëmijëve të shkollës do ketë qenë në fillimin e
20 vitit shkollor, në shtator ndoshta. Ka qenë pak më vonë për
21 shkak të dëmtimit të shkollave në ato zona.

22 Ngjarja me romët nën urë, unë mendoj që ka ndodhur nga
23 fundi i verës në kohë që ngriheshin tensionet. Dhe kjo ka
24 ndodhur brenda një periudhe disa javore, ka patur disa
25 probleme kur romët donin të largoheshin.

1 Ndërkohë që Mitrovica ka qenë një incident në vazhdimësi
2 e sipër. Z. Thaçi ka ndërhyrë disa herë për t'i shpërndarë
3 turmat.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të jeni pak më
5 specifike për sa i përket incidentit me romët nën këtë urë dhe
6 për fëmijët e shkollës?

7 PË. Këto të dyja janë të dokumentuara në raport dhe datat
8 duhet të jenë atje. Dhe nuk ë kujtohen tani, kërkoj ndjesë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Por në përgjithësi çfarë ka
10 ndodhur? Cili ishte problemi?

11 PË. Problemi ishte se romët në zonën e Pejës, e cila ishte
12 kryesisht e banuar me shqiptarë të Kosovës, ata perceptoheshin
13 se kishin qenë bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe. Dhe që
14 kanë qëndruar aty gjatë gjithë konfliktit dhe ishin si të
15 thuash të njollosur lidhur me bashkëpunimin me forcat serbe.
16 Unë mendoj që ato i kanë larguar kryesisht nga shtëpitë që
17 kanë patur dhe po kërkonin sigurinë nën një urë, një urë e
18 madhe në fakt. Dhe UNHCR-ja po i jepte ndihma.

19 Unë mendoj që një numër syresh janë larguar nga Kosova të
20 shoqëruar nga KFOR-i.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po z. Thaçi a ka luajtur rol
22 për këtë incident dhe, nëse po, si, në ç'mënyrë?

23 PË. Po, janë shprehur mjaft shqetësime lidhur me sulmet
24 lidhur ndaj romëve ndërkohë që ata ishin në këtë kamp të
25 improvizuar, nën urë. Dhe më kujtohet që kjo është diskutuar

1 në njërën prej task forcave mbi çështjen e pakicave. UNHCR-ja
2 do ta ketë luajtur rolin kryesor në këtë çështje, pra,
3 çështjen e trajtimit të popullatave pakicë dhe sigurisht që
4 duhet të ishte ndërmarrë një ndërhyrje fillimisht me
5 autoritetet vendore dhe pastaj lart zinxhirit komandues për të
6 ndaluar sulmet ndaj NATO-s, ngacmimet, banditizmin që ka
7 vazhduar. Dhe gjithë kjo gjë është ngadalësuar apo është
8 ndaluar.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ju thanë që z. Thaçi ka
10 luajtur rol?

11 PË. Po, zotëri.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Si e dini një gjë të tillë?
13 Cila është baza e njohurive për këtë?

14 PË. Baza e njohurive të mia do të ketë qenë në takimet që kam
15 patur me kolegët e Pejës, me KFOR-in, me UNHCR-në.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe cili ishte problemi
17 atëherë që ka pasur në rastin e fëmijëve të shkollës? A mund
18 të na tregoni për hollësi të mëtejshme?

19 PË. Në zonat ku ka patur inklava apo popullata të përziera ku
20 fëmijët do të kalonin përmes disa lagjeve të caktuara dhe këta
21 ishte zakonisht serbë, por mund të kishin qenë edhe shqiptarë
22 që duhet të kaloni përmes zonës serbe për të shkuar në shkollë
23 dhe ka patur ngacmime të vazhdueshme.

24 Dhe ajo që ka ndodhur është që shkolla filloi të punonte
25 me ndërrime që fëmijët shqiptarë, për shembull, bënë mësime

1 në mëngjes dhe serbët pasdite apo anasjelltas. Ngacmimi i
2 këtyre fëmijëve gjatë rrugës për në shkollë apo vajtja e tyre
3 në këto shkolla është gjëja e parë që është negociuar
4 fillimisht me autoritetet vendore.

5 Dhe ka patur raste kur KFOR-i i ka shoqëruar fëmijët. Për
6 të bërë të mundur që fëmijët të lejoheshin për të hyrë në
7 objektin e shkollës, kjo ka qenë çështje mjaft e rëndësishme e
8 cila ka kërkuar ndërhyrjen e nivelit më të lartë të
9 autoriteteve të UÇK-së dhe të autoriteteve provizore për të
10 bërë të mundur që shkollimi të vazhdonte. Zakonisht një gjë e
11 tillë ka ndodhur pro organizimi i saj nuk ka qenë i letë nga
12 pikëpamja logjistike. Dhe sigurisht që kjo ka qenë një problem
13 shumë i madh dhe për fëmijët të cilët ngacmoheshin gjatë
14 rrugës për në shkollë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe kjo është realizuar nga
16 z. Thaçi?

17 PË. Ose z. Thaçi ose një nga përfaqësuesit e tij. Nuk më
18 kujtohet në ato moment nëse kishte një njeri të caktuar si
19 personi përgjegjës për sektorin e arsimit.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, z. Thaçi ka ndihmuar
21 për zgjidhjen e këtij problemi?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe, znj. Mitchell, ju thatë
24 që Mitrovica ishte një referencë e përgjithshme po si në
25 Mitrovicë ka patur dhunë gjatë gjithë kohës?

1 PË. Po, Mitrovica ka qenë problem në vazhdimësi e sipër, një
2 sfidë e vazhdueshme. Kishte momente kur --

3 [Nuk ka përkthim]

4 PË. Po, ai ndërhynte.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ndërhynte personalisht?

6 PË. Po, ka patur raste.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe pyetja ime e fundit,
8 znj. Mitchell, është a keni patur raste të tjera kur z. Thaçi
9 në mënyrë të suksesshme apo të pasuksesshme të ketë kërkuar
10 vetëpërmbytje, pra, në mënyrë të suksesshme apo të
11 pasuksesshme pavarësisht po me përjashtim të këtyre tre
12 incidenteve që keni përmendur?

13 PË. Ndoshta ka patur dhe të tjera të dokumentuara por pas një
14 kohe kaq të gjatë ato janë ato që unë mbaj mend.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po tre të akuzuarit e tjerë
16 a të kujtohet nëse ata kanë bërë thirrje për vetëpërmbytje?

17 PË. Ju kërkoj ndjesë, por nuk më kujtohet. Siç e pohova, unë
18 i njoh emrat por nuk më kujtohen hollësi të mëtejshme.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje
20 të tjera.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
22 Mettraux, ju keni fjalën.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

24 Mirëmëngjes, zonjë. Javën e shkuar z. Kehoe në emër të z.
25 Thaçi ju pyeti lidhur me incidentin i cili ndodhi në barin

1 Panda dhe ju ka treguar disa artikuj të shtypit. A të
2 kujtohet?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A të kujtohet identiteti i
5 kryerësve dhe në mënyrë të veçantë nëse ishin shqiptar, serbë,
6 a të kujtohet nëse është vërtetuar identiteti i tyre, nëse
7 është hetuar dhe është vërtetuar identiteti i tyre nga ana e
8 autoriteteve?

9 PË. Jo, nuk më kujtohet.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a të kujtohet në fakt
11 që ka rrëfime të ndryshme lidhur me kryerësit e këtij krimi?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të sugjerohet në
14 mënyrë të drejtë që ky është një incident i cili duhet të
15 zgjidhet, mbi të cilin duhet hedhur dritë?

16 PË. Po, zotëri.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A do të ishte e drejtë
18 atëherë të sugjerohej që kjo në fakt është e vërtetë dhe për
19 një numër të tërë incidentesh të cilët janë raportuar në
20 volumin e dytë të dokumentit "Siç është parë apo treguar", a
21 do të ishte kjo e vërtetë që një gjë e tillë do të duhej t'u
22 dërgohej autoriteteve për hetim?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe një gjë të tillë ju e
25 keni bërë duke shpresuar që autoritetet do të ndërmerrenin

1 hetime për këto çështje. Kështu është?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju pyeti edhe një gjë
4 tjetër, ju kanë bërë një pyetje palët javën e shkuar dhe duhet
5 të na ndihmoni pak më tutje. Vizita juaj në objektin e
6 ndalimit në Llapashticë. A të kujtohet një gjë e tillë?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem të vendosim,
9 Sekretaria, në ekran dokumentin 1D7.

10 A ju kujtohet që e keni diskutuar këtë dokument javën e
11 shkuar, znj. Mitchell?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e kuptoj drejt faktin që
14 ju vetë keni marrë pjesë në këtë vizitë, në këtë takim me
15 individët e përmendur këtu?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua që fillimisht të
18 përqendrohemi tek numri 1. Aktualisht, po ju kërkoj nëse ju
19 kujtohen emrat që janë në numrin 1 dhe në numrin 2.

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të kalojmë në faqen
22 tjetër, ju lutem.

23 Po a të kujtohet emri që është numrin 7. A e shikoni?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'i kthehem këtij

1 dokumenti edhe një herë, por për momentin dua të kaloj tek
2 prova materiale P140 për një çast.

3 Po ju jap ca çaste që t'i hidhni një sy këtij materiali,
4 znj. Mitchell, është ky një raport i UNMIK-ut. Titulli flet
5 për krime lufte, ku viktimat janë një numër shqiptarësh. Ka
6 numër të dosjes. Paragrafi i parë në fakt shpjegon se ç'është
7 ky dokument. Thotë që:

8 "Midis materialeve të sekuestruara nga shtabi i SHIK-ut u
9 gjet dhe dokumenti i bashkëngjitur. Dokumenti rendit emrat e
10 23 burrave shqiptarë që mesa duket dyshoheshin se
11 bashkëpunonin me autoritetet serbe. Hetimet e mëvonshme lidhur
12 me gjendjen aktuale të emrave kanë treguar se disa prej këtyre
13 janë të renditur si persona të zhdukur dhe sipas të dhënave të
14 pakonfirmuara të zbulimit disa janë vrarë nga UÇK-ja".

15 Dhe thotë.

16 "Nga lista, personat e mëposhtëm njihet se janë të
17 vdekur".

18 Numri 3, Alush Kastrati dhe numri 7, Hetem Jashari.

19 Personi me numrin 7, Hetem Jashari, është i njëjti person
20 të cilin e keni takuar më datën 18 shkurt 1999 në Llapashticë?
21 PË. Jo, nuk e di.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.
23 Dhe në tjetrën.

24 Sa për dijeni ky është dokumenti së cilës i referohet
25 faqja e parë, znj. Mitchell.

1 Përkthimi i kësaj faqeje është në faqen pasuese. Edhe në
2 më tutje.

3 Ky është përkthimi i këtij dokumenti. Këtu siç mund të
4 shihni është një numër i bashkëpunëtorësh në anglisht thotë që
5 janë persona që vijnë nga zona e Podujevës. Shikoni numrin 7.

6 Do t'ju thoja është një persona me emrin Hetem Jashari
7 nga Podujeva, deri në vitin 1990. Thuhet që "ishte
8 bashkëpunëtorë i Lorencit, nga viti 1990 dhe ka bashkëpunuar
9 me qendrën sekrete të zbulimit në Prishtinë, në Podujevë dhe
10 në Serbi".

11 E shikoni një gjë të tillë?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a të kujtohet se kur e
14 keni takuar z. Hetem Jashari kur ishte i ndaluar në 18 shkurt
15 1999, nëse të kujtohet nëse të ka thënë që ishte akuzuar se
16 ishte bashkëpunëtor i Serbisë? A të kujtohet një gjë e tillë?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe një gjë të tillë ju e
19 keni mbajtur shënim në raportin tuaj, kështu është?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë konfliktit të
22 Kosovës në vitin 1998 dhe 1999, a keni patur dijeni që UÇK-ja
23 ka hartuar lista të ashtuquajturve bashkëpunëtorë? A keni
24 patur dijeni në atë kohë?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A të kujtohet se cila
2 është baza e kësaj njohurie? Si e keni mësuar një gjë të
3 tillë?

4 PË. Këtë ma ka thënë një pjesëtar i UÇK-së në një fshat ku më
5 ka thënë që ishin duke kërkuar bashkëpunëtorë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sipas përvojës suaj, a
7 ishte kjo diçka që ishte krejt e lokalizuar apo e keni hasur
8 në një numër prej zonave ku keni shërbyer?

9 PË. Neve gjithmonë na e kanë thënë nëpër vende të ndryshme,
10 por kjo ka ndodhur në të gjitha zonat e Kosovës ku kishim
11 veprime apo marrëdhënie me UÇK-në.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të kalojmë përsëri
13 tek prova 1D7. Në faqen e parë të saj. Të zbresim pak poshtë.
14 Ju lutem, znj. Mitchell, të përqendrohemi tek numri 2, Hetem
15 Jashari. S fillimisht thuhet që:

16 "Është mbajtur i ndaluar prej 19 ditësh".

17 Një matematikë e thjeshtë, sugjeron që ai ishte ndaluar
18 ose nga fundi i janarit të 1999 ose në fillim të shkurtit të
19 1999, kështu është?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ky është informacion
22 që ta ka dhënë ai vetë apo e keni marrë nga persona të cilët e
23 kanë ndaluar atë?

24 PË. Çdo gjë që është nën një emër të caktuar vjen nga vetë i
25 ndaluari.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë në fjalinë tjetër
2 thotë që:

3 "Ai erdhi vetë në Llapashticë pasi kishte marrë një "S"
4 nga UÇK-ja".

5 Dhe na thatë që "S" është fletëthirrje, kështu është?
6 PË. Kështu besoj.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ky është informacion
8 që ta ka dhënë ty Hetem Jashari, kështu është?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe më pas thotë që:

11 "Akuzohet për bashkëpunim me armikun".

12 E shikoni një gjë të tillë?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të shohim tani
15 TFHS0069014. Sekretaria nuk ka nevojë që të t'i transmetohet
16 publikut.

17 Po ju lë një çast që t'i hidhni një sy dokumentit.

18 Ta shikojmë të gjithë faqen që ta lexoj dëshmitarja, ju
19 lutem.

20 Po ju lë një çast, ju lutem më tregoni kur ta keni
21 përfunduar leximin e saj.

22 PË. Përfundova, zotëri.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kalojmë në faqen pasuese,
24 ju lutem.

25 Dy gjëra. E para që aty ka një datë dhe vendndodhja

1 "Llapashticë, data është 18.02.1999". Kjo është data ku shkove
2 dhe i takove të ndaluarit?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe nënshkruesi i këtij
5 dokumenti, kemi një problem këtu më duket me përkthimin, por
6 është komandanti i policisë ushtarake të zonës operative të
7 Llapit, nofka e tij është Dini. A të kujtohet se kush është ky
8 persona?

9 PË. Drini më kujtohet më mirë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mua më kanë thënë që kjo
11 nofkë Dini i referohet një personi të quajtur Nasif Mehmeti.
12 Po ky emër a të kujtohet? Anëtar i policisë ushtarake.

13 PË. Jo.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] T'i kthehem dhe një herë
15 faqes së parë të këtij dokumenti.

16 Pyetja e parë që kam është se këtu bëhet fjalë për një
17 listë personash të ndaluar nga UÇK-ja. Në krye të faqes në
18 anglisht thuhet Ushtria Çlirimtare e Kosovës, zona operative e
19 Llapit. Thotë "Policia Ushtarake" që i referohet, pra,
20 policisë ushtarake dhe është e shkurtit 1999. Dhe ka tetë të
21 ndaluar aty.

22 Në qoftë se i hidhni sytë këtyre emrave, zonjë, a mund të
23 konfirmoni nëse këta janë tetë të ndaluarit të cilët i keni
24 vizituar gjatë asaj dite?

25 PË. Jo.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk e dini apo çfarë?

2 PË. Jo. Më duhet t'i hedh sytë dokumentit tjetër, nuk e them
3 ashtu dot.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'i kthehem atij
5 dokumenti pas pak. Po a të kujtohet nëse të të jetë dhënë
6 lista e personave të cilët do të takonit në zonën e Llapit,
7 nga komandanti Dini apo nga dikush tjetër?

8 PË. Nuk më kujtohet të më jetë dhënë një listë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A të kujtohet dhe, ju e
10 keni në njërin prej raporteve tuaj, do t'jua tregoj nëse keni
11 nevojë - është prova materiale P116 - a të kujtohet nëse
12 komandanti Dini të ka thënë që do të lejoheshit që të atakoni
13 tetë të ndaluar? A ju kujtohet një gjë e tillë pra?

14 PË. Nuk më kujtohet, po nuk e kundërshtoj një gjë të tillë.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Me gjithë respekt, besoj se kishit
16 ndërmend Remin.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni shumë të drejtë z.
18 Kehoe. Bëhet fjalë për komandantin Remi, pra, për Mustafën.

19 PË. Jo. Nuk më kujtohet por edhe nuk e kundërshtoj.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A të kujtohet nëse më
21 datën 18 shkurt kur ke shkuar ti atje ka qenë i pranishëm dhe
22 komandanti i policisë ushtarake, apo keni takuar vetëm
23 komandant Remin?

24 PË. Më kujtohet që i kam takuar dy individë, njëri ishte
25 komandanti dhe tjetri ishte përgjegjësi i policisë ushtarake.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ky do të ishte personi
2 që dëshironte të merrte pjesë në takimet tuaja?

3 PË. Po, ashtu besoj.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju pyes lidhur me
5 procesin e miratimit të këtij takimi, nëse të kujtohet një gjë
6 e tillë dhe ndoshta për t'ju ndihmuar për këtë prova materiale
7 P3 mund të jetë me vlerë.

8 Edhe këtu bëhet fjalë për një raportet e tjera nga ana
9 juaj, nga OSBE-ja, raport të cilin jua kam treguar javën e
10 shkuar. Këtu përmendet një takim tjetër shihet nga titulli. Që
11 thotë është protokolli i takimit me komandantin e zonës në
12 Petrovë më datën 23 shkurt 1999 lidhur me vizitat të të
13 burgosurve, ajo që më intereson mua është paragrafi i dytë.

14 "E informova komandantin e zonës se KVM-ja tashmë kishte
15 arritur të kontaktonte komandantin e zonës së Llapashticës, i
16 cili na ka lejuar të takoheshim privatisht me tetë të burgosur
17 shqiptarë etnik".

18 Po ju ndaloj këtu për një çast. A të kujtohet, a ta
19 freskon kjo paksa kujtesën lidhur me të ndaluarit që keni
20 takuar atë ditë?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe më pas thua ti:

23 "Unë sugjerova që ky mund të jetë një rast për të filluar
24 praktikën e vizitave të rregullta në të gjithë objektet e
25 burgimit të UÇK-së dhe se KVM-ja e vlerësonte gjestin pozitiv

1 të komandantit të zonës Remit".

2 Nga kjo, a kam kuptuar drejt që takimi që keni mbajtur më
3 datën 18 shkurt 1999 me tetë të ndaluarit të jetë e miratuar
4 nga komandant Remi?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet në qoftë se
7 është miratuar atë ditë apo përpara sesa të shkonit
8 Llapashticë? A ju kujtohet procesi si ka ndodhur?

9 PË. Në përgjithësi ne merrnim miratimin përpara sesa të
10 largoheshim nga zyra, përpara se të niseshim. Mund të ishte,
11 për shembull, më herët atë mëngjes ose një ditë më përpara.
12 Megjithatë nuk më kujtohet konkretisht.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet që kur u
14 takuat me komandant Remin atë datë, më 18 shkurt, ai ju tha që
15 komandanti i policisë ushtarake është përgjegjës për aspektet
16 praktike të vizitës? A ju kujtohet kjo?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndërkohë që po kryenit
19 këtë vizitë, a kishte të pranishme polici ushtarake,
20 domethënë, a ishte policia ushtarake pranë jush ose a patë
21 prezent, prani të policisë ushtarake ndërkohë që kryenit këto
22 vizita?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju pyes lidhur me
25 diçka që ju keni shënuar. Është prova materiale 116.

1 Përsëri ky është një dokument që ju tregua javën e
2 shkuar. Ky raport do jetë përgatitur, besoj, brenda një jave
3 pak a shumë nga momenti i vizitës tuaj apo jo?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ju kërkoja që të
6 shikonit paragrafin e katër në këtë dokument. Fillon me "SM
7 ..." besoj që "SM-ja", domethënë, kur përdoret "SM-ja" është
8 fjala për juve.

9 "Sara Mitchell pyeti se çfarë synonte UÇK-ja të bënte me
10 të ndaluarit kur të arrihej marrëveshja politike që do të
11 përfshijnë dhe dispozitë amnistie. ZC-ja" dhe besoj që ZC-ja
12 përdoret këtu për komandantin e zonës, "nuk dukej se të kishte
13 menduar këtë pyetje, kështu që sugjerohej që UÇK-ja do
14 mendonte për këtë pyetje dhe do e diskutonte atë me LO-n".

15 A ju kujtohet ky shkëmbim me z. Remi, pra, që të keni
16 pasur një bisedë të tillë me komandant Remin?

17 PË. Është e dokumentuar këtu, vetëm kjo më kujtohet.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ishte ideja juaj që ata
19 të përdornin amnisti sa i takon personave të ndaluar,
20 personave të mbajtur prej tyre?

21 PË. Jo, mendoj që pjesa e përmendjes prej meje e amnistisë,
22 është pjesë e marrëveshjes politike, domethënë, marrëveshja
23 politike në vetvete mund të përmbante dispozita për amnistinë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Le të shkojmë përsëri në
25 raportin tuaj, nëse s'gabohem, bëhet fjalë për provën

1 materiale 1D7 edhe njëherë.

2 Dua t'ju pyes në më tepër hollësi lidhur me procesin e
3 intervistimit të personave të ndaluar. Mendoj se e keni thënë
4 dhe më herët, po dua që ta dëgjoj dhe njëherë, a mund të na
5 thoni se çfarë qëllimi kishin përpjekjet tuaja për t'u takuar
6 me të ndaluar nga UÇK-ja të tillë si persona të ciklën jepen
7 në këtë dokument?

8 PË. Qëllimi ishte që të verifikoheshin që këta persona ishin
9 të ndaluar dhe që të përcaktohej se në çfarë kushtesh
10 mbaheshin këta persona, që të identifikonim se kush ishte
11 ndaluar për çfarë arsyesh ishin të ndaluar.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ishte kjo pjesë e
13 qëllimit tuaj që të mundoheshit që të shmangnim dëmtimet mbi
14 ta, domethënë, përmes vizitave të vendeve të tilla përpiqeshit
15 ju që të parandalonit ushtrimin e dhunës ndaj tyre?

16 PË. Po, kjo është pjesë më e madhe, më e përgjithshme e
17 ambienteve ku mbahen të ndaluarit. Pra, ti dëshiron që të
18 hedhësh dritë mbi atë dhe duke e bërë këtë gjë që të krijosh
19 një lloj baze për vizita të tjera në mënyrë të tillë që të
20 bësh krahasime dhe të arrish në përfundimin në qoftë se
21 kushtet janë përmirësuar apo jo dhe qëllimi mund të ketë qenë,
22 nuk më kujtohet, por ndoshta në qoftë se për shembull, kishim
23 marrë atëherë informata konkrete nga familjes e tyre, ne pas
24 vizitave raportonim, i tregonim anëtarëve të familjes se si
25 ishte situata.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Si e bënit këtë
2 regjistrimin e të dhënave? A përdornit incizues ose aparate
3 incizuese apo thjesht merrnit shënime?

4 PË. Jo, nuk ishe aparate incizuese. Thjesht unë dhe Suzana
5 merrnim shënime.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj që raportet i
7 hartonit menjëherë pas vizitës së kryenit apo jo. ?

8 PË. Po, i hartonim bashkë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky dokument që kemi
10 përpara, a pasqyron llojin e informacioneve që ju merrnit nga
11 të ndaluarit apo të ndaluarit jepnin më shumë informacion sesa
12 ky që keni raportuar këtu?

13 PË. Nuk mendoj që do kemi marrë më shumë informacioni sesa
14 lloji i informacionit që jepen në këto dy dokumente.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kujtoj që keni thënë që
16 këta individë i keni takuar individualisht, domethënë, jo me
17 praninë e të tjerëve apo jo?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa ju kujtohet juve, sa
20 kanë zgjatur këto biseda me të ndaluarit apo këto intervista
21 në qoftë se mund quaj këtu?

22 PË. Nga 15 deri në 25 minuta mesatarisht.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Çfarë procesi ndiqte
24 personi tjetër i intervistuar, domethënë, cili ishe procesi që
25 kalonte personi tjetër që vinte përpara jush për intervistim?

1 PË. Roja vinte e merrte personin e intervistuar që ishte aty
2 në dhomë dhe dilnin nga dhoma, ndërkohë që ne prisnim që të
3 vinte personi tjetër për t'u intervistuar.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet në qoftë se
5 rojet ishin anëtarë të policisë ushtarake?

6 PË. Jo, nuk më kujtohet.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se do shikojmë
8 personin 1, Idriz Svarqa, këtu thuhet që ky person ka qenë i
9 ndaluar për rreth katër muaj. E shikoni këtë informacion?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky informacion, na e
12 shpjeguat, që ky është informacioni që jua ka dhënë juve i
13 ndaluar. A është e saktë kjo?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ja u tregova dhe përpara
16 një minuti, por nga lista e tetë personave hartuar nga policia
17 ushtarake, pra, thuhet që ata janë ndaluar që prej 2 shkurtit
18 1998, i takon që janë mbajtur pak a shumë për katër muaj apo
19 jo?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me sa ju kujtohet tani, z.
22 Svarqa si ju dukej? Ju dukej i frikësuar, me vetëbesim? Ndonjë
23 karakteristikë e tij që ju kujtohet që mund të na e thoni sot?

24 PË. Përshtypja që kam sot, kur mendoj sot për në atë kohë,
25 është përshtypja e kolektives.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ça domethënë kjo
2 përshtypja e përbashkët, domethënë, kolektive?
3 PË. Ishin të frikësuar. Ishin të tërhequr. Goxha të qetë. Dhe
4 sikurse e thashë, unë kisha përshtypjen që iu ishte treguar
5 sesi të silleshin sepse sjellja e tyre ishte shumë e ngjashme.
6 Nuk është se kishte persona që bërtisnin apo qanin apo bënin
7 gjeste të tilla gjatë këtyre takimeve.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përsëri me z. Svarqa, në
9 raport thuhet që:

10 "Ai nuk kishte pasë qasje në ndonjë avokat, nuk e dinte
11 se kur ishte planifikuar procesi gjyqësor ndaj tij dhe nuk e
12 dinte se për sa kohë do të vazhdonte të mbahej i ndaluar".

13 A ju kujtohej se për çfarë akuzohej ai?

14 PË. Jo.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se do shikojmë
16 numrin 2, Hetem Jashari, sikurse e pamë dhe më përpara, këtu
17 thuhet që ky person akuzohet për bashkëpunim me armikun. A e
18 dini që kishte ndonjë ligj apo ndonjë dispozitë që
19 parashikonte akuzën për bashkëpunim me armikun në atë kohë?

20 PË. Jo. Konkretisht jo.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju tregua ndonjë
22 dokument që sugjeronte faktin që ai mund të ishte
23 bashkëpunëtor me armikun?

24 PË. Më kujtohet që na janë treguar një grup dosjesh, një piring
25 dosjesh. Në mos gabohem, ishin tetë dosje. Një dosje për

1 secilin prej të ndaluarve. Në secilën dosje, dosja ishte prej
2 kartoni dhe në qoftë se e hapje kishte nëndarje të tjera, për
3 shembull, shikoje stacionin e policisë e të tjerë, po
4 dokumentacioni i gjithi ishte në shqip. Dhe ne nuk kemi marrë
5 kopje të këtyre dokumenteve. Kam përshtypjen që ato
6 përmendeshin si dosje, domethënë, termi që përdorej për të
7 ishin dosje dhe unë kam përshtypjen që ato ishin dosje me
8 informacione për secilin prej individëve.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por ju vetë nuk patët
10 mundësi që të vlerësoni përmbajtjen e tyre për secilin prej
11 këtyre të ndaluarve, apo jo?

12 PË. E saktë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Si përfunduan këto takime
14 apo ky takim?

15 PË. Takimet përfunduan me ardhjen e të ndaluarit të fundit.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fund të takimit a
17 arritët në përfundimin që individët ishin të sigurtë?

18 PË. Po hezitohj të jap një përgjigje se nuk e di si t'i
19 përgjigjem kësaj pyetjeje. Po ata ishin të sigurtë në atë
20 moment po nuk e di se sa të sigurtë ishin pasi u larguam ne.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e ndjetë ju të
22 rëndësishme për të ndjekur më tej situatën me ta dhe, në qoftë
23 se po, çfarë bëtë?

24 PË. Po, ne këtë informacion e ndamë me KNKK-në, me Kryqin e
25 Kuq Ndërkombëtar që kishin mandatin ekzakt sa i takon mandatin

1 të përgjithshëm për këtë çështje, për persona të cilëve u
2 mohohet liria.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju vetë, në qoftë se do
4 përdorja fjalën në frëngjisht, ju a bëtë ndonjë përpjekje për
5 të pasur *demarshim* ose, le të themi, për të pasur qasje në
6 këto individë?

7 PË. Ka mundësi. Në qoftë se do shikoj datën. Megjithatë unë u
8 mundova që të kishim dhe takime të tjera pasuese në mënyrë të
9 tillë që të mund të ndiqnim ngjarjet më tej.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A i keni informuar
11 familjet e këtyre tetë individëve?

12 PË. Nuk e di, besoj që i kemi ndarë këtë informacion me zyrat
13 rajonale.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju nuk ju kujtohet në
15 qoftë se keni ndarë këtë informacion me familjarët apo jo?

16 PË. Nuk më kujtohet.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju u larguat nga vendi më
18 20 mars dhe u kthyet përsëri në mes të qershorit 1999.

19 Dëshiroj që ta eksplorojmë pak më tepër këtë temë për të
20 kuptuar se çfarë ka ndodhur më saktë.

21 Kërkoj që të paraqitet prova materiale P10. I lutem
22 Sekretares të paraqesë dhe versionin në anglisht. Dokumenti
23 është SITF0069026. Faleminderit.

24 Nëse do shihni këtë dokument, Dëshmitare. Titulli i
25 dokumentit është "amnisti". Është nga Ushtria Çlirimtare e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 58

1 Kosovës nga zona operative e Llapit. Ka edhe një numër. Datë
2 është 5 prill 1999. Dhe thotë:

3 "Në bazë të komunikatave politike të Shtabit të
4 Përgjithshëm të UÇK-së, rregullores së brendshme të UÇK-së,
5 ... rregullores mbi administrimin civil ..."

6 Komandanti i zonës operative të Llapit me vendim shpall
7 këtë amnisti. Dhe pastaj do shikojmë emrat e personave që kanë
8 fituar amnisti. Megjithatë le të kalojmë tek faqja e dytë në
9 mënyrë të tillë që ju të më shikoni të gjithë dokumentin.
10 Është dokument i cili është nënshkruar nga komandanti i zonës
11 operative të Llapit dhe data është 5 prill 1999 dhe arsyetimi
12 dhe do e lexojmë arsyetimin pak më vonë.

13 Dhe do të doja që përpara kësaj të kalojmë përsëri tek
14 faqja e parë.

15 A mund të shihni numrin 2 së pari që është Idriz Svarqa,
16 emri i babit, Bajram, nga fshati Bellopojë, Podujevë, në
17 mbajtje prej datës 2 nëntor 1998 në orën 16.00. Dhe pastaj në
18 numër 7 kemi Hetem Jashari, emri i babait Milaim, i lindur në
19 1947 në fshatin Breçë, jepet adresa e tij dhe thuhet që në
20 mbajtje prej datës 1 shkurt 1999, në orën 14.00.

21 A ju duket që këta janë dy prej individëve me të cilët ju
22 jeni takuar më 18 shkurt dhe për të cilët keni raportuar në
23 dokumentin që pamë pak më herët?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e keni parë ndonjëherë

1 këtë dokument, këtë të ashtuquajtur amnisti?

2 PË. Jo.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pasi u takuat me Remin, ku
4 i sugjeruat amnistinë që do të ishte një ide e mirë pasi të
5 arrihej një marrëveshje politike, a ju tha ndonjëherë që UÇK-
6 ja kishte filluar "amnisti" për këta persona?

7 PË. Jo.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të kalojmë tek
9 faqja tjetër, ju lutem. Nën titullin "Arsyetim" jepet
10 shpjegimi që:

11 "Vendimi se në një dispozitiv nxirret në bazë të vendimit
12 mbi amnistinë e shpallur nga komandanti i zonës operative të
13 Llapit, jepet numri ... duke pasur parasysh se pas masave të
14 ndërmarra nga organet ushtarake të ndjekjes është arritur
15 risocializimi i këtyre personave".

16 Dhe vazhdon më tej duke thënë se:

17 "Duke marrë parasysh ofensivën e madhe të ndërmarrë nga
18 okupatori serb, në pamundësi për krijimin e kushteve të
19 sigurisë për të lartpërmendurit dhe ndaj tyre do të zhvillohen
20 hetime, këtyre u lëshohen edhe vendimet e veçanta".

21 Së pari, a ishit në dijeni që tetë personat që ishit
22 takuar ose ndonjë prej këtyre tetë personave me të cilët jeni
23 takuar më 18 shkurt 1999 kanë qenë pjesë hetimesh në atë kohë?

24 PË. Hetime nga UÇK-ja? Mund të na kenë thënë që nuk e dinin
25 sepse ishin të ndaluar, por unë vetë nuk kam qenë e informuar

1 për ndonjë hetim konkret.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju ka thënë njeri apo a
3 keni marrë ndonjëherë ndonjë informacion në qoftë se ndonjë
4 prej këtyre individëve është liruar nga ambientet e ndalimit
5 të UÇK-së? E kam fjalën konkretisht për këta dy persona që
6 përmenda pak më herët?

7 PË. Jo, nuk më kujtohet një gjë e tillë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të paraqesë në
9 ekran Sekretarja dokumentin SITF00243091 deri në 00243150. Më
10 konkretisht do kërkoja që të paraqitet në ekran faqja
11 SITF00243130.

12 Për t'ju dhënë ca kontekst, më lejoni t'ju them, znj.
13 Mitchell që bëhet fjalë për një dokument i cili është pjesë e
14 një blloku shënimesh më të gjatë që me ç'kuptojmë është marrë
15 nga forcat serbe në Kosovë.

16 Nëse mund ta shikoni përpara ekranit që keni këtë
17 dokument, na e thoni, do shikoni aty që ka pesë kolona,
18 domethënë, jepet emri, emri i babait, mbiemri, ditëlindja,
19 vendi i lindjes, fillimi i ndalimit, përfundimi i ndalimit dhe
20 kush e ka urdhëruar ndalimin. A e shikoni këtë faqe,
21 Dëshmitare?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se do shikojmë
24 pikën 3, shohim që emri që shkruhet këtu është Idriz Svarqa,
25 emri i babait është Bajram, nga Bellopoja. Ndërkohë fillimi i

1 ndalimit është data 2 nëntor 1998. Këtu thuhet në orën 15.00.

2 Po besoj se në dokumentin e mëparshëm ishe ora 16.00. Dhe

3 thotë që ndalimi ka përfunduar më datë 5 prill 1998. A e

4 shikoni këtë informacion, Dëshmitare?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj që duhet të ketë

7 qenë viti 1999, për çështje logjike besoj. Megjithatë,

8 pavarësisht kësaj a duket kjo që përkon me atë çfarë lexuam në

9 dokumentin që kishte titullin "Amnisti" që e pamë përpara pak

10 kohësh?

11 PË. Po.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini në qoftë se z.

13 Svarqa është liruar ndonjëherë nga ambientet e ndalimit të

14 UÇK-së?

15 PË. Jo.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë në

17 dokumentin SITF00243136. Në numrin 31, shikoni emrin Hetem

18 Jashari, emri i babit Milaim, i lindur në Breçë, jeton në

19 Podujevë. Dhe thotë që ndalimi ka filluar më datë 1 shkurt

20 1999 në orën 14.00, në orën 2.00 pasdite dhe ndalimi ka

21 përfunduar më datë 5 prill 1999, në orën 10.00. Ça do të thotë

22 që është 30 minuta përpara personit tjetër, z. Svarqa.

23 E njëjta pyetje. A ju ka thënë ndokush që z. Jashari në

24 fakt është liruar nga vendi ku mbahej i ndaluar nga UÇK-ja?

25 PË. Jo.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në përgjithësi, a e dini
2 se çfarë u ka ndodhur secilit prej këtyre individëve?
3 Domethënë, a keni pyetur ndokënd, a keni marrë informacion nga
4 Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, a keni pyetur familjarët apo ndonjë
5 palë të tretë?

6 PË. Jo.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Mund të
8 hiqet nga ekrani dokumenti.

9 Javën që shkoi ju i thatë palëve që ju dhe disa prej
10 kolegëve tuaj kanë qenë të përfshirë për të siguruar ndalimin
11 e disa personave që mbaheshin nga UÇK-ja. A është e saktë kjo?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë të
14 sugjerohet që në varësi se kush ishte i ndaluar ose se kush
15 ishin të ndaluarit, niveli i autoritetit rritej apo ulej?
16 Domethënë, me fjalë të tjera, domethënë, në qoftë se një
17 persona që mbahej i ndaluar ishte një person i rëndësishëm,
18 një person mbi ju mund ta merrte përgjigjen për lirimin e tij?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Duke përfshirë këtu edhe
21 ambasadorin Walker, apo jo?

22 PË. Besoj se po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sot, kanë kaluar ca kohë
24 pa diskutim, por a ju kujtohen raste të tilla konkrete të
25 kësaj natyre sot e kësaj dite?

1 PË. Po, më kujtohet. Më kujtohet KVM-ja, që mbante nën
2 ruajtje trupat e disa policëve serbë të ushtrisë jugosllave në
3 një pikë. Më kujtohet gjithashtu edhe KVM-ja që intervenonte
4 ose ndërhynte me policinë serbe që mund të kishin qenë
5 kryesisht policë që ishin kapur, që ishin zënë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe niveli i
7 bashkëbiseduesve në anën e UÇK-së a rritej apo zvogëlohej në
8 varësi të personave të cilët ishin të ndaluar?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A kishe raste ku ju
11 kujtohet që edhe anëtarët e Shtabi të Përgjithshëm kanë qenë
12 të përfshirë në lirimin e të ndaluarve?

13 PË. Nuk më kujtohen detaje të tilla. Por me siguri sa i takon
14 lirimit të policëve serbë të ndaluar, përshtypja ime ishte që
15 kjo nuk ishte pjesë e kompetencës së një individi të caktuar,
16 por duhej që të kontaktoja më lart ë zinxhir.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kemi parë në disa raste që
18 kur liroheshin persona të nivelit të lartë ose të ndaluar të
19 nivelit të lartë, përgjithësisht, kishte prani të medias. A
20 jeni në dijeni të rasteve të tilla?

21 PË. Jo në vendin e ndalimit. Më kujtohet që lirimet bëheshin
22 në situata goxha të tensionuara, zakonisht ndodhnin gjatë
23 natës, këtu përfshihej shumë planifikim nga KVM-ja. Kishim të
24 bënim me operacione thuajse ushtarake. Domethënë, me fjalë të
25 tjera, që aspekti ose pjesa ushtarake e KVM-së e menaxhonte

1 atë.

2 Mund të ketë pasur ca media dhe mbulim mediatik, po në
3 pikën e lirimit nuk jam shumë e sigurtë për këtë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua që të pyes lidhur me
5 diçka që keni dhënë në deklaratën tuaj të vitit 2014. Do i
6 kërkoja Sekretares paraqitjen e dokumentit se mbase do ishte
7 më e thjeshtë që të vepronim në këtë mënyrë.

8 Dokument është ERN 013312. Të shohim faqen 6, është numri
9 ERN 013317. Të kalojmë ë fund të faqes në paragrafin 14.

10 Ju lutem lexojeni këtë paragraf, znj. Mitchell.

11 PË. Po, e lexova.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ajo çfarë kuptoj unë që të
13 thoni, në veçanti në fjalitë e para të këtij paragrafi, është
14 dhe, në qoftë se nuk e kam kuptuar siç duhet, ju lutem më
15 korrigjoni, ajo çfarë kuptoj unë është që qasja juaj për të
16 ndaluarit ose të burgosurit shqiptarë ishte shumë herë më e
17 vështirë sesa qasja për të burgosurit serb. A është e drejtë
18 kjo?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Si ishte më e komplikuar
21 ose më e vështirë për ju që të kishit qasje tek të burgosurit
22 shqiptarë, të ndaluarit shqiptarë?

23 PË. Të ndaluarit shqiptarë zakonisht ishin në zonat që
24 kontrolloheshin nga UÇK-ja, domethënë, në zonat UÇK-ja kishte
25 kontroll mbi territoret. Dhe autoritet serbe nuk kishin qasje,

1 nuk bënë asnjë lloj administrimi, asnjë lloj shërbimi aty,
2 përfshirë këtu edhe shërbimet e policisë. UÇK-ja e ndiente që
3 ishte përgjegjësi e tyre që t'i ushtronte këto detyra.

4 Dhe situata ishte më e vështirë për shqiptarët e Kosovës
5 sepse ata besonin, sikurse e thashë dhe më përpara, që
6 funksionet policore i takonin atyre. Sa i takon serbëve për të
7 burgosurit serbë, ne kishim shumë herë më tepër informacion
8 lidhur me ta sepse këto informacione i merrnim nga autoritetet
9 serbe.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E meritoni një pushim,
11 znj. Mitchell. Dhe më lejoni të them që nuk do marrë shumë
12 kohë pasi të kthehem pas pushimit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
14 pushim për gjysmë ore. Ju lutem nxirreni dëshmitaren nga
15 salla. Ju lutem mos flisni me askënd lidhur me dëshminë
16 përpara Trupit Gjykues. Kemi 30 minuta pushim tani.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pushim deri
19 në orën 11.30.

20 --- Pauza fillon në orën 11.00

21 --- Seanca rifillon në orën 11.30

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi një
23 aspekt paraprak që duhet diskutuar.

24 Trupi Gjykues vëren që dëshmitari i Prokurorisë me numër
25 W00490 është parashikuar që të japë dëshmi në fund të kësaj

1 jave. Të premtën, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e
2 Dëshmitarëve e njoftoi Trupin Gjykses dhe palët në
3 parashtrimin e protokolluar 01192 se --

4 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja këshillohen]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem të
6 kalojmë në seancë private. Ju kërkoj ndjesë, ishte gabim im.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kërkoj falje, se thashë "nesër dhe
16 të mërkurën". Desha të thoja që do t'jua japim listën të
17 mërkurën.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
19 por ne e kuptuam.

20 Z. KEHOE: [Mikrofoni çaktivizuar]

21 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
23 dëshmitare. Jemi gati tani të vazhdojmë me pyetjet e
24 Gjykatësit Mettraux.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëmëngjes sërish,

1 dëshmitare.

2 Javën e kaluar na thatë që disa herë kur jeni takuar me
3 komandantët e UÇK-së ata ju tregonin, ju flisnin për
4 rregulloret, për procedurat që kishin për të trajtuar aspektet
5 disiplinore. A ju kujtohet që folëm për këtë?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni informacion nëse
8 këto rregulla, këto procedura u zbatuan ndonjëherë konkretisht
9 për të trajtuar pretendimet për vrasje apo zhdukje që ju ia
10 kishit vetë raportuar udhëheqjes së UÇK-së?

11 PË. Jo.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A u vu ndonjëherë në
13 zbatim për të trajtuar pretendimet e ndalimit të paligjshëm
14 dhe arbitrar apo keqtrajttimeve në ndalim?

15 PË. Jo. Më kanë thënë vetëm që ekzistonin.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur jeni takuar me
17 udhëheqësit e UÇK-sëm përfshirë dhe z. Thaçi, edhe i treguat
18 për këto pretendime, a shfaqën ndonjëherë ndonjë interes ata
19 që të merrnin më shumë informacion prej jush ku i bazonit ju
20 këto pretendime?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ua dhatë juve këtë
23 informacion?

24 PË. Ndonjëherë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini në qoftë se morën

1 ndonjë masë në mbështetje të asaj që ju thatë?

2 PË. Nuk më kujtohet të na ketë kontaktuar më njeri lidhur me
3 këtë çështje për të më thënë që është zgjidhur kjo çështja,
4 apo t'u përgjigjej pyetjeve të mia.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt, iu përgjigjët
6 pyetjes së radhës, por a keni ndonjë rast kur ju vetë apo
7 organizata u keni raportuar që diçka është zgjidhur? Çka do të
8 thotë që diçka është hetuar dhe është zgjidhur.

9 PË. Vetëm lirimi i disa luftëtarëve serbë. Vetëm për lirim
10 e disa luftëtarëve serbë, por jo më shumë se kaq.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Javën e kaluar ju na thatë
12 diçka që ia përsëritët dhe kolegut tim Gjykatësi Barthe sot.
13 Thatë që ju kanë dhënë disa përgjigje, nëse më lejoni ta
14 formuloj në këtë formë. Kur keni trajtuar këtë çështjen e
15 shkeljes së të drejtave të njeriut me udhëheqësit e UÇK-së.
16 Një nga përgjigjet ishte që nuk janë anëtarë të UÇK-së, një
17 përgjigje tjetër është që janë persona që përdorin uniforma të
18 UÇK-së, i shfrytëzojnë. Javën e kaluar ju thatë, për të
19 njëjtin kontekst, ju thatë ai e kishit fjalën për z. Thaçi:

20 "Ai, UÇK-ja në këtë pikë, do të thoshte që nuk është më
21 përgjegjësi e UÇK-së policia, por është përgjegjësi e KFOR-it
22 që është forcë ndërkombëtare apo UNMIK-ut që është në Kosovë.
23 Dhe se nuk kishte shumë policë në terren në ato momente në
24 kohë."

25 A ju kujtohet që folëm për këtë dhe na e thatë dhe e

1 përsëritët sërish sot paradite?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e pranuat ndonjëherë ju
4 këtë shpjegim që, domethënë, udhëheqja e UÇK-së nuk është më
5 përgjegjëse për këto aspekte, të cilat ju ua sollët në
6 vëmendje?

7 PË. Jo.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po organizata juaj,
9 organizata juaj e pranoi këtë propozim?

10 PË. Nuk e besoj.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mendonit ju se këta
12 personat që takonit ju vazhdonin të kishin ende përgjegjësinë
13 për t'i trajtuar këto çështje?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj se ju na thatë se
16 ata, UÇK-ja, vazhdonin të kryenin funksione policore. A e kam
17 kuptuar unë siç duhet se këtu përfshihet edhe periudha pasi
18 kishte hyrë OKB-ja në Kosovë?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A përfshinte kjo
21 arrestimin e personave edhe pasi kishte hyrë OKB-ja në Kosovë?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me sa dini ju, këta
24 persona që ishin arrestuar nga UÇK, ishin persona që dyshohej
25 se kishin kryer krimet që ju, për të cilat ju i kishit

1 raportuar. Jeni në gjendje të na thoni diçka në lidhje me
2 këtë?

3 PË. Nuk jam e sigurt.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju na thatë se jeni takuar
5 disa herë me z. Thaçi, përfshirë edhe periudhën pasi kishte
6 hyrë UNMIK-u në Kosovë. Dhe se ju dhe organizata juaj i kishit
7 kërkuar të ndërhynte me UÇK-në apo me anëtarët e UÇK-së.

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju tha ndonjëherë ai që
10 unë s'kam lidhje fare me këto punë më, dhe se ishte anëtar i
11 qeverisë së përkohshme të Kosovës apo ju dha ndonjë përgjigje
12 tjetër?

13 PË. Nuk më kujtohet të ketë thënë ndonjëherë që, "Unë nuk kam
14 lidhje me UÇK-në".

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
17 Gaynor.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
19 Smith.

20 Mirërngjesi, znj. Mitchell. Kam disa pyetje për
21 strukturën komanduese të UÇK-së.

22 Më 7 dhjetor, në faqen 12 të transkriptit të përkohshëm
23 ju bëri, ju bënë një pyetje:

24 "Struktura serbe ishte shumë vertikale dhe është e drejtë
25 të themi që struktura e UÇK-së ishte horizontale, nga zona në

1 zonë?"

2 Dhe ju u përgjigjët:

3 "Po."

4 Më vonë ju bënë një pyetje të ngjashme në faqen 16 të të
5 njëjtit transkript. Pyetja ishte kjo:

6 "Struktura serbe ishte shumë vertikale, a është e drejtë
7 të themi që struktura e UÇK-së ishte horizontale nga zona në
8 zonë, kështu?"

9 Dhe ju jeni përgjigjur:

10 "PË. Po."

11 Më vonë ju pyetën:

12 "... sa i takon strukturës komanduese vertikale dhe
13 horizontale, a pajtoheni me mua se ajo serbe ishte vertikale
14 dhe ajo e UÇK-së ishte horizontale?"

15 Dhe ju u përgjigjët:

16 "PË. Nuk është kaq e thjeshtë..."

17 Më pas ju pyetën:

18 "... siç e dini nuk ka pasur komandë qendrore në UÇK."

19 Ju u përgjigjët:

20 "Ka pasur një Shtab të Përgjithshëm."

21 Ju u përgjigjët:

22 "Po, kishin një Shtab të Përgjithshëm. Nuk e di a po
23 përdorim të njëjtën gjuhë apo jo."

24 "PY. Po ju flas për atë që keni dhënë dëshmi, në rastin
25 e Milutinovic, se nuk ka qenë e unifikuar në një formë

1 qendrore të koordinuar. Pra nuk ka qenë njësoj si serbët. Se
2 duhet të shkonit dhe te komandantët e zonave...”

3 Ju u përgjigjët:

4 “Po.”

5 A ju kujtohet kjo dëshmi?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mos i merrni, ju lutem, nuk
8 po ju, nuk janë kritika, por a do ta përshkruanit ju analizën
9 e strukturave komanduese të UÇK-së si një nga funksionet
10 kryesore apo përgjegjësiive tuaja kryesore gjatë kohës që keni
11 qenë në Kosovë?

12 PË. Jo.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni pasur mundësi të
14 shihnit ndonjë komunikim të brendshëm të UÇK-së nga niveli i
15 brigadës në nivelin e komandës së zonës, apo në zonat
16 operative?

17 PË. Jo.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni pasë mundësi të
19 shihnit komunikimin mes komandantëve të zonave të Shtabit të
20 Përgjithshëm? Apo nga Shtabi i Përgjithshëm drejtuar
21 komandantëve të zonave?

22 PË. Jo.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni parë komunikata apo
24 deklarata politike të lëshuara prej UÇK-së?

25 PË. Nuk më kujtohet.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Brenda policisë ushtarake të
2 UÇK-së, më konkretisht, a keni pasur mundësi të rishikonit
3 komunikata, për shembull, drejtuar nga komandantët e policisë
4 ushtarake në nivel brigade, apo në nivel zone, apo Shtabi të
5 Përgjithshëm?

6 PË. Nuk më kujtohet.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, kaq pyetje
8 kisha.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
10 Gjykatësi Gaynor.

11 Ka më pyetje nga Prokuroria lidhur me pyetjet e
12 Gjykatësve?

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se
15 O'Reilly ishte e para. Atëherë vazhdoni.

16 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe:

17 Z. KEHOE: [Përkthim]

18 PY. Znj. Mitchell, nuk do të kem shumë pyetje ju premtoj,
19 sepse jam i sigurt që u shqetësuat kur më patë që u çova në
20 këmbë. Por nuk do ju mbaj shumë gjatë. Vetëm disa pyetje që
21 burojnë nga pyetjet e Gjykatësve.

22 Ju na thatë -- dhe kjo ishte në përgjigje të pyetjes që
23 ju bëri Gjykatësi Barthe, si personat, se personat në takimet
24 nga ana e UÇK-së i drejtoheshin z. Thaçi, shihnin nga z.
25 Thaçi.

1 PË. Po.

2 PY. Këto ishin takime politike, mbledhje politike mes jush,
3 Dr. Kouchner dhe përfaqësuesve të tjerë ndërkombëtarë?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe ju flisnit për një larmi çështjesh politike apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Pra, pajtoheni me mua që në frymën politike të këtyre
8 takimeve është krejt e natyrshme që të tjerët që janë të
9 pranishëm në takim t'i drejtohen personit që në thelb ishte
10 zëdhënësi politik, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe ky ishte z. Thaçi në këto rrethana?

13 PË. Po.

14 PY. Ju jeni në dijeni të Komisionit për Zbatimin e Përbashkët
15 që drejtohej nga gjenerali Jackson dhe kabineti i tij, dhe se
16 kishte komandantë të UÇK-së dhe gjeneralin Çeku atje. Kur them
17 komandantët, këtu përfshiheshin komandantët e zonave, a ju
18 kujtohet kjo?

19 PË. Po, jam në dijeni të strukturës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E tha ndonjë
21 nga Gjykatësit këtë?

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Por po fliste për faktin që i
23 drejtoheshin Presidentit Thaçi. Dhe kjo është një situatë
24 paralele. Kam një situatë paralele kur nuk i drejtoheshin z.
25 Thaçi. Kur udhëheqësit e UÇK-së --

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, duhet t'u
2 përmbaheni pyetjeve që bënë Gjykatësit.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, dua të tregoj një situatë
4 paralele.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
6 Vazhdoni me këtë pyetje.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Pra, Komisioni për Zbatimin e
8 Përbashkët ishte një çështje ushtarake, trajtonte çështjet
9 ushtarake, apo jo?

10 PY. Po. Unë nuk merrja pjesë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ajo tha unë
12 nuk kam marrë pjesë.

13 DËSHMITARJA: [Përkthim] Nuk kam marrë pjesë në takime
14 ushtarake.

15 Z. KEHOE: [Përkthim]

16 PY. Por bazuar në punën tuaj, a e dini ju që në këto mbledhje
17 ushtarake komandantët e zonave nga ana e UÇK-së nuk i
18 drejtoheshin Thaçit dhe madje-madje, nuk e, tërësisht e
19 shpërfillnin. A e dini këtë?

20 PË. Jo.

21 PY. Informacioni që ju kërkoi Gjykatësi Barthe për elementët
22 e fshehtë, sa u takon shërbimit të zbulimit, është e drejtë të
23 themi që ju nuk keni ndonjë informacion, ta keni marrë vetë
24 drejtpërdrejt por e keni informacion të marrë nga
25 përfaqësuesit e KFOR-it këtë, apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Në përgjigje të pyetjeve nga Gjykatësi Barthe, ju folët
3 edhe për hetimin e krimeve nga UÇK-ja. Dhe besoj se ju thatë
4 se z. Thaçi ju ka thënë që është KFOR-i dhe UNMIK-u përgjegjës
5 për këtë gjë, a është kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe kjo ishte e vërtetë, apo jo? Në të vërtetë ata ishin
8 përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen penale të personave të
9 përfshirë në krime pasi hyri në fuqi Rezoluta 1244, kështu?

10 PË. Po.

11 PY. Sa i takon, për shembull, arrestimeve, e thamë, ua bëri
12 këtë pyetje Gjykatësi Mettraux tani, sa i takon UÇK-së dhe
13 nëse -- e pranoni ju shpjegimit e tyre kur ju thoni që s'jemi
14 në gjendje të bëjmë asgjë.

15 Në fakt, besoj se e thamë tashmë, s'ka pasur ligje, s'ka
16 pasë gjyqtarë, s'ka pasë gjykata. Dhe në të vërtetë, UÇK-ja
17 nuk kishte kurrfarë autoriteti për të arrestuar personat dhe
18 për t'i ndjekur penalisht, kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Ju bëri disa pyetje Gjykatësi Barthe për faktin që z.
21 Thaçi ka dhënë deklaratë publikisht dhe është fakt bazuar në
22 dëshminë tuaj, por dhe bazuar në atë që është pranuar tashmë
23 si provë, që z. Thaçi e dënonte dhunën, kërkonte që serbët të
24 ktheheshin, dhe kërkonte që të kishte një Kosovë shumetnike.
25 Këtë e ka bërë në mediat ndërkombëtare dhe mediat vendase.

1 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj. Këto pyetje janë
2 trajtuar një herë te kundërpyetjet, s'është nevoja për ta
3 trajtuar më.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
5 Vazhdoni.

6 Z. KEHOE: [Përkthim]

7 PY. Pra, kjo ishte si në mediat ndërkombëtare dhe në mediat
8 vendase, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Gjykatësi Mettraux ju pyeti për kafenenë Panda dhe
11 pranimin nga ana e autoriteteve serbe që serbët kishin qenë
12 përgjegjës për vrasjen në Pejë te kafeneja Panda. Bazuar në
13 përvojën tuaj kjo është e vetmja herë që ju keni dëgjuar që
14 serbët e pranuan përgjegjësinë, morën përsipër përgjegjësinë
15 për vrasjet që kishin kryer më parë dhe për këtë ua kishin
16 vënë fajin shqiptarëve të Kosovës, kështu? Është e vetmja herë
17 që e keni dëgjuar, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Ne po flisnim për bashkëpunëtorët dhe ju i dhatë
20 informacion Gjykatësit Mettraux për bashkëpunëtorët. A e dini
21 ju se disa prej këtyre listave të bashkëpunëtorëve ishin
22 përgatitur nga persona nëpër fshatra që mund të kishin, mund
23 të ishin në hakmarrje me disa nga personat në listë, apo
24 kishin ndonjë, kishin për të shpague gjëra personale,
25 domethënë të lanin hesapet, më falni, me disa nga

1 bashkëfshatarët? A keni dijeni për këtë?

2 PË. Po.

3 PY. Më falni, se po kaloj nga njëra degë te tjetra se nuk kam
4 nevojë t'i mbuloj të gjitha. Dua të sqaroj tani një takim që
5 keni pasur më 18 shkurt në Llapashticë. Nuk e di, nuk jam
6 shumë i sigurt për një nga pyetjet që bëri Gjykatësi Mettraux.
7 Ai ju pyeti për faktin që hynin, dilnin, të burgosurit. Fakt
8 është që ju keni qenë vetëm në atë dhomë bashkë me znj.
9 Ringgaard, bashkë me të ndaluarit.

10 PË. Në të shumtën e kohës, po.

11 PY. Do i lutesha tani që në ekran të vendosnim dokumentin
12 1D7, në vijim të pyetjeve që bëri Gjykatësi Mettraux. Ai ju
13 pyeti për qëllimet e këtyre takimeve.

14 Mund ta shihni që të njiheni me informacionin përpara.
15 Disa nga të ndaluarit, për shembull numri 2, z. Hetem Jashari.
16 Në të vërtetë ai ju ka thënë që kishte probleme shëndetësore
17 me shpinën se nuk ishte mirë nga ana shëndetësore, dhe se i
18 kishin dërguar, i kishin dhënë një mjek atje, kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, mbështetur në bisedën që keni bërë me këtë të
21 ndaluar, që ju tregoi për faktin që kishte një lëndim të
22 mëhershëm, edhe ai ju tha që, po, m'u ofrua trajtimi mjekësor
23 që më nevojitej. Kështu? Kujdesi mjekësor.

24 PË. Po.

25 PY. Shohim personin e parë për të cilin foli dhe Gjykatësi

1 Mettraux, Idriz Svarqa. Mund ta lexojmë këtë shpejt, këtë

2 person e ka vizituar Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, KNK-ja.

3 PË. Po.

4 PY. Për t'ju ndihmuar me kujtesën, problemi me KNK-në dhe

5 refuzimin e tyre për të takuar disa nga të ndaluarit, ishte

6 sepse ata donin që intervistat të bëheshin pa asnjë person të

7 pranishëm atje, dhe kjo nuk ishte pranuar, kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Por kur shkuat ju, juve jua lejuan këtë gjë. Ju ju lejuan

10 t'i shihnit të ndaluarit duke qenë vetëm ju dhe znj. Ringgaard

11 e pranishme.

12 PË. Po.

13 PY. Në përgjigje të disa pyetjeve të, më duket se të

14 Gjykatësit Mettraux, ai foli për këta persona që ishin të

15 frikësuar, të nënshtruar, u ishte treguar çfarë të thonin. Por

16 ama asnjë nga këto informacionet nuk shfaqet në raportin që

17 kemi përballë, apo jo?

18 PË. Jo.

19 PY. Ju folët shkurtimisht dhe për faktin që Thaçi nuk kishte

20 thënë që nuk kam lidhje me UÇK-në e kështu me radhë. Ju bëri

21 disa pyetje Gjykatësi Barthe për një sërë situatash, për

22 shembull, Mitrovica, për të cilën dhatë dëshmi se Presidenti

23 Thaçi ka ndërhyrë disa herë që të qetësonte situatën, a është

24 kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Mitrovica ka qenë një zonë shumë, shumë, shumë e acaruar
2 në, situata pra ka qenë shumë e acaruar.

3 PË. [Nuk ka përkthim]

4 PY. Besoj se javën e kaluar ju patë edhe videon ku ai fliste,
5 më duket se ka qenë qershori i 1999, dhe përpiqet të qetësonte
6 turmat, do të thoshte personat që edhe serbët kanë të drejtën
7 të jetojnë këtu si edhe shqiptarët e Kosovës, apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Pastaj, ju folët për situatën me romët nën urë në Pejë
10 dhe që t'u jepej mundësia fëmijëve të shkonin në shkollë, të
11 ishin të sigurt. Të paktën për rastet që më duket se i
12 trajtuat me Gjykatësin Barthe, i përmendi Gjykatësi Barthe,
13 kështu?

14 PË. Po.

15 PY. Tani, të gjitha këto situatat dhe situata të tjera që
16 kanë ndodhur, fakt është që Presidenti Thaçi përpiqej ta
17 qetësonte situatën, të qetësonte gjakrat, dhe që këta njerëz
18 të jetonin në paqe. A nuk është kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Në të njëjtën kohë ai po e bënte këtë duke u bërë dhe
21 thirrje serbëve që të ktheheshin dhe të gjenin një zgjidhje
22 ndëretnike për konfliktin në mënyrë që të kishin një shoqëri
23 shumëkulturore, apo jo?

24 PË. Po.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Më jepni një çast të nderuar

1 Gjykatës.

2 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

3 Z. KEHOE: [Përkthim]

4 PY. Një pyetje e ngritur nga kolegu im. Ju u përgjigjët disa
5 pyetjeve për zinxhirin komandues kur ju pyeti Gjykatësi Gaynor
6 dhe se përshtypja juaj ishte se zinxhiri komandues ishte
7 horizontal, dhe me sa kuptoj unë, ju nuk keni parë ndonjëherë
8 dokumente të MUP-it apo të armatës jugosllave për të dalë në
9 përfundimin që komanda e tyre ishte vertikale, a është e
10 saktë?

11 PË. Po.

12 PY. Por, përshtypja juaj ishte që UÇK-ja ishte horizontale
13 dhe armata jugosllave dhe MUP-i ishin vertikale, është thjesht
14 e mbështetur në bisedat që keni pasur në terren me kolegët
15 tuaj, që ishin pjesë e MVK-së?

16 PË. Po.

17 PY. Faleminderit.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

20 O'Reilly, a keni pyetje?

21 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Jo.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 84

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Dëshmitare, ju përfunduat. Ju faleminderit që ishit e
3 pranishme dhe që iu përgjigjët të gjitha pyetjeve me aq sa
4 kishit mundësi.

5 Mund të dilni tani me Asistenten e sallës së gjyqit dhe
6 kalofshi një ditë të këndshme.

7 DËSHMITARJA: [Përkthim] Faleminderit.

8 [Dëshmitarja largohet]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
10 Mettraux kërkon fjalën për një moment.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I bëj kërkesë ZPS-së, znj.
12 Mayer, i tregova dëshmitarit një dokument që është me numër
13 SITF0069014, dhe duket se ka një problem aty me përkthimin e
14 këtij dokumenti, përkthimin drejt anglishtes. Sidomos
15 referenca për ushtrinë militare.

16 Ju lutem, a mund ta shihni, ju lutem rishikojeni këtë dhe
17 na thoni se si qëndron përkthimi, trajtojeni këtë me personat
18 që flasin gjuhën.

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Patjetër.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
21 përfundojmë me këtë dëshmitare, që në fakt përfundoi dëshminë
22 e saj, do të doja të flisja shkurtimisht për temën e
23 procedurave të ZPS-së me këtë dëshmitare të fundit.

24 ZPS-ja parashtroi një kërkesë para shumë muajsh kur
25 kërkoi që të pranohej shtatë deklarata të mëparshme dhe

1 transkripte të znj. Mitchell, edhe, dhe provave materiale,
2 sipas rregullës 154. Ekipet e Mbrojtjes iu përgjigjën në
3 mënyrë të përbashkët. Trupi Gjykues nxori vendimin e vet më 16
4 mars 2023 që mbante titullin "Vendim për pranimin e provave".

5 11 faqe të këtij vendimi trajtonin ekskluzivisht znj.
6 Mitchell edhe Trupi Gjykues vendosi ta lejonte përdorimin e
7 rregullës 154 për këtë dëshmitare. Pra, përkatësisht për
8 shtatë deklaratat e mëparshme, dhe provat materiale shoqëruese
9 pasi u diskutuan në detaje, në vendim, shumica e tyre u
10 konsideruan të përshtatshme për pranim.

11 Sidoqoftë, ZPS-ja bëri shumë pyetje në pjesën e vet ku e
12 kishte tejkalluar parashikimin që kishte dhënë paraprakisht
13 edhe e tejkalloi tërësisht rregullën 154.

14 ZPS-ja nuk ka shfrytëzuar siç duhet kohën në sallën e
15 gjyqit. ZPS-ja, për shkak të sjelljes së ZPS-së u detyruam të
16 përdornim shumë burime sepse trajtuan kërkesën sipas kërkesës
17 154.

18 Trupi Gjykues ndihet i detyruar të lexojë të gjitha
19 deklaratat e mëparshme dhe të shqyrtojë të gjitha provat
20 materiale shoqëruese përpara vendimit 154, dhe nuk është
21 nevoja të them tani se sa orë u deshën për këtë dëshmitar.

22 Sidoqoftë se e kishim, ndonëse e kishim miratuar
23 kërkesën, ZPS-ja nuk e respektoi vendimin tonë dhe e tejkalloi
24 orarin që ishte caktuar në sallën e gjyqit për të trajtuar
25 deklaratat, dhe trajtoi me detaje të gjitha deklaratat e

1 mëparshme të dëshmitares, ç'ka rezultoi në një keqpërdorim të
2 kohës.

3 Ju lutemi që të mos ndodhi më një gjë e tillë.

4 Inkurajojmë përdorimin e rregullës 154 dhe ju inkurajojmë të
5 keni dëshmitarë *live*, por kur bëjmë ne një vendim, dhe
6 angazhoheni që ta respektoni atë, nuk ka kuptim të mos e
7 respektoni më këtë vendim.

8 Pas kësaj do të bëjmë dhjetë minuta pushim, të
9 organizohemi për dëshmitarin e radhës, që është dëshmitari
10 01763. Bëjmë dhjetë minuta pushim.

11 --- Pauza përfundon në orën 12.03

12 --- Seanca rifillon në orën 12.13

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
14 seancë private, ju lutem, për të lëshuar një urdhër gojor.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të nderuar

14 Gjykatës, kemi kaluar në seancë publike.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes.

18 Dëshmitar më dëgjoni?

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani

21 Sekretaria do të japë tekstin e betimit solemn të cilin ju

22 duhet ta merrni në bazë të nenit 151(2) i rregullores sonë. Ju

23 lutem, lexojeni dokumentin dhe ta bëni këtë me zë të lartë.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e

25 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj

1 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
2 vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të
3 cilën kam dijeni.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 DËSHMITARI: DEJAN JEFTIC

6 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthyesit]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
8 sot do të fillojmë me dëshminë tuaj, e cila pritet që të
9 zgjasë rreth pesë orë.

10 Siç e dini, Prokuroria do t'ju bëjë pyetjet së pari dhe
11 më pas pala Mbrojtëse. Anëtarët e Trupi Gjykses mund të të
12 bëjnë pyetje po kështu.

13 Prokuroria ka vlerësuar se pyetjet e saj do të zgjasin
14 një orë. Ndërkohë që Mbrojtja mendon se do t'i duhen katër
15 orë. Për sa i takon këtij vlerësimi, shpresojmë që Avokatët ta
16 shfrytëzojnë në mënyrën e duhur kohën që kanë në dispozicion.
17 Trupi Gjykses mund të lejojë bërjen e pyetjeve shtesë në qoftë
18 se përmbushen kushtet e duhura.

19 Dëshmitar, përgjigjuni qartë dhe me fjali të shkurtra
20 pyetjeve që ju bëhen. Në qoftë se nuk e kuptoni një pyetje,
21 kërkoni Avokatit që ta përsërisë atë ose thuaj që nuk e
22 kuptoni dhe do ta bëjnë atë me, sqarimin.

23 Po kështu, mundohuni të tregoni se mbi ç'bazë i jepni
24 përgjigjet ndaj pyetjeve që ju bëhen lidhur me faktet dhe
25 rrethanat.

1 Në qoftë se ZPS-ja ju kërkon që të tregoni se çfarë
2 korrigjimesh u keni bërë deklaratave tuaja, duhet të
3 konfirmoni që deklarata e shkruar dhe e korrigjuar me listën e
4 korrigjimeve e reflekton në mënyrën e duhur deklaratën tuaj.

5 Po kështu flisni afër mikrofonit, prisni pesë sekonda
6 përpara se të jepni përgjigje pyetjeve. Flisni po kështu
7 ngadalë me qëllim që përkthyesit të mund të ndjekin.

8 Gjatë ditëve në vazhdim, ndërkohë që jepni dëshmi para
9 këtij Trupi Gjykses, nuk jeni të lejuar që të diskutoni me
10 askënd përmbajtjen e deklaratës suaj jashtë kësaj salle të
11 gjyqit. Në qoftë se ndonjë person ju bën pyetje lidhur me këtë
12 Gjykatë apo me dëshminë tuaj, ju lutem të na njoftoni.

13 Gjithashtu, mbani parasysh se në qoftë se unë ju kërkoj
14 që të ndaloni së foluri apo të ngre dorën, që nënkupton që të
15 ndaloni së foluri, atëherë do të duhet të ndaloni pasi unë do
16 t'ju jap udhëzime të mëtejshme.

17 Në qoftë se keni nevojë për të marrë ndonjë pushim, ju
18 lutem na tregoni dhe do t'ju respektojmë dëshirën.

19 Do ta fillojmë me pyetjet e Prokurorisë që janë në të
20 majtë.

21 Z. Prokuror, ju e keni fjalën.

22 Pyetje nga z. Michalczuk:

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

24 PY. Mirëdita, dëshmitar.

25 PË. Mirëdita.

1 PËRKTHYESI: Shënon se nuk e dëgjon dëshmitarin, duhet t'i
2 afrohet mikrofonit.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

4 PY. Unë jam Cezary Michalczuk, nga Prokuroria. Do t'ju bëj
5 disa pyetje në orën në vazhdim. A jeni gati?

6 PË. Po.

7 PY. A mund të na tregoni se si e keni emrin dhe mbiemrin e
8 plotë?

9 PË. Dejan Jeftic.

10 PY. A mund të na tregoni datëlindjen?

11 PË. 7 korrik 1979.

12 PY. Dëshmitar, në të shkuarën i keni dhënë një deklaratë ZPS-
13 së të cilën tani do ta vendos në ekran.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do t'i kërkoj Sekretarisë të
15 vendosë në ekran këtë dokument, variantin në anglisht dhe në
16 serbisht. Në anglisht është 078045-TR-ET, Pjesa 1 RED 2, dhe
17 dokumenti në serbisht ka të njëjtin numër rendor me -ST, Pjesa
18 1 RED.

19 PY. Dëshmitar, a e shihni në ekran?

20 PË. Po, e shoh.

21 PY. Kjo është intervista e 4 shtatorit 2020 që i keni dhënë
22 ZPS-së. A e keni dhënë ju këtë deklaratë?

23 PË. Po, më kujtohet kjo deklaratë.

24 PY. Gjatë takimit përgatitor të fundit që kemi mbajtur më
25 datë 5 dhe 6 dhjetor të javës së shkuar, a kanë, a ju është

1 dhënë mundësia që ta rishikoni këtë deklaratë të mëparshme
2 tuajën?

3 PË. Po.

4 PY. A të kujtohet t'i kesh bërë disa sqarime gjatë këtij
5 takimi për këtë deklaratë?

6 PË. Po.

7 PY. Këto sqarime, a janë pasqyruar në një shënim të cilin jua
8 kemi lexuar në fund të këtij takimi përgatitor?

9 PË. Po.

10 PY. A mund të konfirmoni se ajo që ju është lexuar me zë të
11 lartë në atë shënim i ka pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të
12 saktë korrigjimet që keni bërë, sqarimet që keni bërë?

13 PË. Po, ashtu është.

14 PY. Dhe me përjashtim të sqarimeve të këtij shënimi,
15 deklarata juaj e ZPS-së a reflekton në mënyrë të saktë
16 dëshminë tuaj dhe atë që do të pohoni sot në qoftë se do të
17 bëheshin të njëjtat pyetje në këtë sallë të gjyqit?

18 PË. Po, unë do të jepja të njëjtat përgjigje.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani që
20 është përmbushur kriteret e rregullës 154 dhe në përputhje me
21 vendimin F01976, deklarata e dëshmitarit në anglisht, në shqip
22 dhe në serbisht si dhe Shënimi Përgatitor 1 i 7 dhjetorit
23 2023, ERN 7552 deri në 7553 [Sipas përkthimit] të paraqiten si
24 prova materiale.

25 A dëshironi që t'i lexoj këto, shifrat e këtyre

1 deklaratave për secilën gjuhë?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni ndonjë
3 kundërshtim?

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, përveç atyre që kemi ngritur
5 përpara.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
7 O'Reilly.

8 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

9 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

10 Z. BAIESU: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 07085-TR-ET
12 [Sipas përkthimit] RED 2 dhe i njëjti numër ST-ET [Sipas
13 përkthimit], Pjesa 1 RED, plus përkthimi në shqip si dhe
14 Shënimi përgatitor 1, që ka shifrën rendore 117752?

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kemi tre
16 pjesë në anglisht që mbase duhet t'i lexoj, pasi janë tre
17 pjesë në anglisht, tre në shqip dhe tre në serbisht. Në
18 serbisht e ka shifrën 078045-TR-ST, Pjesa 1 RED 2 [Sipas
19 përkthimit].

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë thashë.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dakord.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, keni dhe
23 variantin në shqip?

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, e ka shifrën 078045-TR-AT,
25 Pjesa 1 deri në 3.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe deklarata
2 e mëparshme?

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo është
4 deklarata e përparshme, e mëparshme.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord, të
6 gjitha këto pranohen si prova materiale dhe do të marrin numër
7 prove.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 për procesverbal, Pjesa 1 e deklaratës së mëparshme e ka
10 shifrën 078045. Dhe ka variantet në serbisht dhe në shqip, dhe
11 do të ketë numrin e provës P756.1.

12 Pjesa 2 për transkriptin që ka numrin 078045-TR-ET, Pjesa
13 2 RED2, së bashku me variantet në shqip dhe në serbisht, do
14 t'i ketë provën P756.2.

15 Dhe Pjesa 3 e deklaratës së mëparshme me shifrën 078045-
16 TR-AT, Pjesa 3 RED, me variantet në shqip dhe në serbisht do
17 të ketë shifrën P756.3.

18 Ndërsa Shënimi Përgatitor me shifrën 117752 deri në
19 117753, do të ketë provë materiale P757.

20 Të nderuar Gjykatës, vërej që të gjitha këto janë
21 dorëzuar si konfidenciale, ndoshta mund të sqarohet një gjë e
22 tillë.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Duhet të mbeten të tilla, të
24 nderuar Gjykatës, për momentin.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërktoj

1 ndjesë, çfarë thatë?

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Duam që të mbesin konfidenciale
3 për momentin, mund ta ndryshojmë këtë klasifikim pak më vonë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, propozoj
6 që të lexoj një përmbledhje të shkurtër të rregullës, të
7 deklaratës së rregullës 154 të dëshmitari.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Më ose rreth 4 korrik 1998,
10 W01763, një person me etnicitet serb nga fshati Movlan të
11 Suharekës, u arrestua së bashku me dy të afërm të tij, afër
12 Movlanës nga dy shqiptarë të armatosur me uniforma të zeza.

13 Të tre serbët janë dërguar në një shtëpi në Budakovë ku u
14 janë lidhur sytë dhe i kanë pasur duart të lidhura. Më pas ata
15 janë rrahur me pushkë dhe me zinxhirë dhe janë dërguar, janë
16 hedhur në një bunker pas një shtëpie ku janë marrë në pyetje.

17 W01763 është marrë në pyetje nga policia dhe prania në
18 Movlane dhe nga Movlan, nga i është thënë që ia kanë vrarë
19 babain. Të dy serbët e tjerë po kështu janë marrë në pyetje.

20 Të tre këta serbë janë dërguar në një shtëpi rreth dy tre
21 kilometra më larg dhe janë futur në bodrumin e një shtëpie ku
22 janë rrahur. Në atë bodrum janë ndaluar edhe dy shqiptarë. Ata
23 i kanë thënë W01763 se konsideroheshin tradhtarë, që
24 bashkëpunonin me policinë serbe. W01763 dhe bashkë-të-
25 ndaluarit e tjerë serbë janë lëshuar apo liruar më 5 korrik

1 1998.

2 W01763 nuk është kthyer më në fshatin e tij dhe mësoi që
3 shtëpia e tij ishte shkatërruar pasi ishin larguar nga Kosova
4 të afërmit e tij në qershor të vitit 1999.

5 W01763 ka patur nevojë për trajtim mjekësor për lëndimet
6 e marra.

7 Dhe këtu përfundon edhe përmbledhja e dëshmisë së këtij
8 dëshmitari.

9 Të nderuar Gjykatës, tani kam disa pyetje sqaruese që
10 duhet t'i bëj këtij dëshmitari, me lejen tuaj, ju lutem.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, nga dëshmia juaj ne kemi vërejtur që në korrik
14 të vitit 1998 [Sipas përkthimit] keni jetuar në fshatin e
15 Movlanës në bashkinë e Suharekës. A e dini si e ka emrin në
16 shqip ky fshatin që ne e quajmë Movlane?

17 PË. Po, e di. *It's Muhlan*. Është Muhlan.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare, të vendosim në
19 ekran dokumentin SPOE00301693 deri në 00301693. Dhe është një
20 dokument që mund t'i tregohet edhe publikut. Ju lutem ta
21 zmadhojmë dhe të përqendrohemi në zonën e Suharekës. Ndoshta
22 200 për qind të zmadhohet. Pak më shumë, ndoshta pak më shumë.
23 dakord.

24 PY. Dëshmitar, a e shihni këtë hartë që është në ekran?

25 PË. Po.

- 1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dua që dëshmitari të shënojë në
2 këtë hartë disa vende.
- 3 PY. Dëshmitar, rrethoni së pari vendin ku keni banuar në atë
4 kohë.
- 5 PË. Po, po e bëj.
- 6 PY. A mund t'i vendosni numrin 1 aty me qëllim që të kuptojmë
7 se ku ndodhemi ne me këtë?
- 8 PË. Dakord.
- 9 PY. A mund të na tregoni se ku ka banuar në atë kohë Krsta
10 Jeftic?
- 11 PË. Në të njëjtin fshat, në Muhlan.
- 12 PY. A mund të vendosni numrin 2 aty afër?
- 13 PË. Dakord.
- 14 PY. Stanko Stankovic, ku ka banuar në atë kohë?
- 15 PË. Ka banuar në Reçan.
- 16 PY. Atëherë, rrethoni fshatin Reçan në këtë hartë dhe
17 shënojeni me numrin 3.
- 18 PË. Nuk e shoh. Nuk e shoh fshatin Reçan.
- 19 PY. Në qoftë se nuk e shikon, vazhdo më tutje. Nuk është
20 problem, nuk është problem.
- 21 PË. Ah, po. E pashë, tani e pashë.
- 22 PY. Vendosni numrin 3.
- 23 PË. [Shënon]
- 24 PY. Faleminderit. Shënoni vendndodhjen, apo vendndodhjen e
25 afërt, ku nga ku ju kanë rrëmbyer në vitin 1998?

- 1 PË. Dakord, po.
- 2 PY. Vendosni numrin 4 aty në afërsi të tij.
- 3 PË. [Shënon]
- 4 PY. A mund të rrethoni edhe vendin ku ju kanë mbajtur të
5 ndaluar në vitin 1998?
- 6 PË. Po, sigurisht.
- 7 PY. Ju lutem, shënojeni me numër 5 aty afër.
- 8 PË. Dakord.
- 9 PY. Dëshmitar, sa larg është Muhllani nga Budakova?
- 10 PË. Jo më shumë se 5 kilometra.
- 11 PY. 5 kilometra në vijë ajrore apo në vijë tokësore?
- 12 PË. Tokësore.
- 13 PY. Dëshmitar, ç'moshë keni patur në qershor të vitit 1998?
- 14 PË. Katër ditë më vonë unë mbusha 19 vjeç.
- 15 PY. Çfarë pune bënit në atë kohë?
- 16 PË. Nuk punoja në atë kohë, nuk isha i punësuar.
- 17 PY. Çfarë pune bënte në atë kohë Krsta Jeftic?
- 18 PË. Po, ai punonte, ai punonte në Balkan Belt në Suharekë.
- 19 PY. Çfarë, me se merrej kjo firmë?
- 20 PË. Ishte një fabrikë që prodhonte gomë dhe disa produkte të
21 tjera kimike.
- 22 PY. Çfarë pune bënte Stanko Stankovic në atë kohë?
- 23 PË. Stanko Stankovic nuk ishte në punë.
- 24 PY. Në kohën e rrëmbimit, a ishte ndonjëri prej jush i
25 punësuar nga policia serbe?

1 PË. Jo, asnjëri prej nesh nuk kishte asnjë lidhje me policinë
2 apo me ushtrinë, apo të kemi pasur ndonjë detyrë për të kryer
3 nën urdhrat e tyre.

4 PY. E kuptoj.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ta mbajmë hartën në ekran për
6 momentin, pasi mund t'i kërkoj dëshmitarit që të shënojë edhe
7 disa vende të tjera.

8 PY. Dëshmitar, në deklaratën tuaj të ZPS-së që është 078045-
9 TR-AT [Sipas përkthimit], Pjesa 1, RED2, faqja 15, ju
10 përmendët dy shqiptarë që ju kanë arrestuar në korrik të 1997.
11 Thatë që ata ishin Shukri Gashi dhe Kabashi? Ku jetonte Shukri
12 Gashi në atë kohë?

13 PË. Në atë kohë Shukri Gashi jetonte në Muhlan si edhe unë,
14 ndërkohë që Sokol Kabashi jetonte në Krushicën e Poshtme
15 [Sipas përkthimit].

16 PY. Movlanin e kemi në hartë, por a mund të rrethoni vendin
17 ku banonte Kabashi dhe ta shënoni me numrin 6?

18 PË. Dakord.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mbase bëra
20 gabim kur thashë 1997, duhet të ishte viti 1998.

21 PY. Ju lutem rrethojeni këtë vend, pra Krushicën e Poshtme
22 [Sipas përkthimit].

23 PË. Dakord, Gornja Krushica, Krushica e Poshtme [Sipas
24 përkthimit]. A mund t'i bëj një pyetje Prokurorit? Pasi
25 Krushica e Poshtme dhe e Epërme nuk duken të dyja, nuk i shoh

1 të dyja në këtë hartë. Z. Prokuror, unë bëra gabim pasi e
2 vendosa numrin 6 jo te Krushica e Poshtme, por e Epërme.
3 PY. A janë shumë larg njëri-tjetrit këto dy vende, Krushica e
4 Epërme dhe e Poshtme?

5 PË. Jo, është vetëm rruga nga Reçani në Muhlan që i ndan të
6 dyja, dhe prandaj e kam paksa të paqartë këtë hartë. Harta e
7 cila tregon zonën dhe rrugën.

8 PY. Po më duket se numrin 6 e keni vendosur pak a shumë në
9 vendin që quhet Krushica e Poshtme, është kështu apo jo?

10 PË. Kjo është zona në drejtim të Budakovës, që është nga
11 rruga nga Muhlani.

12 PY. Dakord. Më lejoni t'ju bëj disa pyetje për Shukri Gashin.
13 A e dinte Shukri Gashi që ju, Krsta Jeftic dhe Stanko
14 Stankovic nuk ishit anëtarë të policisë apo të ushtrisë serbe
15 në atë kohë?

16 PË. Po, Shukri Gashi dhe të gjithë fshatarët e tjerë të
17 fshatit e kanë ditur një gjë të tillë.

18 PY. Si e din ti këtë gjë?

19 PË. Për arsyen e thjeshtë që ne bashkëpunonim gjithë kohën,
20 të gjithë e kanë ditur në çdo çast se ku ishin të tjerët,
21 çfarë po bënin, ku punonin, e kështu me radhë.

22 PY. Shukri Gashi, a punonte afër shtëpisë tënde në Muhlan apo
23 larg shtëpisë tënde?

24 PË. Ai nuk ishte fqinji im i drejtpërdrejtë apo i afërt, por
25 unë kaloja para shtëpisë së tij për çdo dite, një shtëpi ishte

1 150 metra larg tjetrës.

2 PY. Për sa kohë e kishit njohur?

3 PË. Që ditën e parë kur fillova të ec nëpër fshat.

4 PY. A i keni bërë vizita në shtëpi njëri-tjetrit?

5 PË. Po. vëllai i tij i madh ishte gjuetar i cili shkonte me

6 babain tim për të gjuajtur. Ai vinte pinte kafe, ne shkonim te

7 shtëpitë e njëri-tjetrit. Ne shkonim te shtëpitë e njëri-

8 tjetrit sa herë që kishim festat tona fetare.

9 PY. E njëjta pyetje edhe për Sokol Kabashin. A e dinte Sokol

10 Kabashi që ti, Krsta Jeftic dhe Stanko Stankovic nuk ishit

11 anëtarë të ushtrisë apo të policisë serbe në atë kohë në

12 korrik të 1998?

13 PË. Sigurisht që e dinte. Njësoj si edhe Shukri Gashi.

14 PY. Ai banonte në fshatin e Krushicës së Poshtme. Sa larg

15 është ai nga Muhlani, nga Muhlani?

16 PË. Është përgjatë rrugës Muhlan-Budakovë. Ndoshta 1700 metra

17 larg, jo më shumë.

18 PY. Për sa kohë e kishit njohur Sokol Kabashin?

19 PË. Për shumë kohë. Që kur kemi qenë fëmijë. Arat tona ishin

20 afër njëra-tjetrës kështu që sa herë që ne punonim në fushë e

21 shihnim njëri-tjetrin.

22 PY. A vinte ai në fshatin tënd në Muhlan?

23 PË. Po, po. Vinte për shkak se në fshatin e tyre nuk kishin

24 dyqan dhe vinte te dyqani ynë për të blerë ushqime. Ishte i

25 njëjti dyqan ku blinim ne ushqimet tona.

1 PY. A e ke takuar Shukri Gashin apo Sokol Kabashin afër, diku
2 afër periudhës kur ju kanë rrëmbyer, në korrik 1998?

3 PË. Unë e takova Shukri Gashin në 1998 tre ditë përpara se të
4 na rrëmbente.

5 PY. Në deklaratën tuaj për ZPS-në, dhe numrin e referencës e
6 dhashë më herët, Pjesa 1 RED2, faqja 17, përmendët edhe një
7 shqiptar tjetër me emrin Agim Kabashi. Ku banonte në atë kohë
8 Agim Kabashi?

9 PË. Ky është Agim Kabashi që përmendet në deklaratën time dhe
10 kjo ka të bëjë me makinën Golf. Ai jetonte në Krushicën e
11 Poshtme.

12 PY. Besoj se e kemi të shënuar me numrin 6 në hartë Krushicën
13 e Poshtme, kështu që s'ka nevojë.

14 Kam të njëjtën pyetje dhe për Agim Kabashin. E dinte ai
15 që ti, Krsta Jeftic dhe Stanko Stankovic nuk ishit anëtarë të
16 policisë apo të ushtrisë serbe në atë kohë?

17 PË. Po, sigurisht. Të gjithë e dinin. S'kishim sekrete. Të
18 gjithë e dinin gjithkund se ku punonte tjetri, në çfarë
19 organizate apo për policinë, për organizatë tjetër e kështu me
20 radhë.

21 PY. Nga ajo që thoni a mund ta përmbledh në mënyrën e duhur
22 kur të them që komunitetet serbe dhe shqiptare ishin shumë të
23 afërt njëri me tjetrin?

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo është një pyetje sugjestionuese.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Hidhet

1 poshtë, mund t'i jepni përgjigje kësaj pyetjeje.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, kështu është. Kështu ka qenë.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

4 PY. Emri i fundit që do t'ju bëj pyetje, emri i fundit është
5 Bajram Morina, dhe e kemi përmendur atë lidhur me ndalimin
6 tuaj në Budakovë.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në të njëjtën deklaratë të ZPS-
8 së, Pjesa 1, faqet 37 deri në 38. Po kështu edhe në Pjesën 2,
9 në faqen 14.

10 PY. Ku jetonte në atë kohë, ku banonte në atë kohë z. Bajram
11 Morina?

12 PË. Në atë kohë Bajram Morina banonte në Stravuqinë.

13 PY. A mund ta rrethoni edhe këtë vend në hartë?

14 PË. Po.

15 PY. Ju lutem vendosini numrin 7.

16 PË. [Shënon]

17 PY. Po Bajram Morina, a e dinte se ju të tre, tre serbët e
18 rrëmbyer nuk ishit anëtarë të policisë apo të ushtrisë serbe
19 në atë kohë?

20 PË. Sigurisht që e dinte, sepse ai i njihte babain e Krsta
21 Jeftic i cili e kishte emrin Vojislav.

22 PY. Si e njihte babain e tij?

23 PË. Në vitet 1990, dhe ndoshta dhe më parë, ai punonte në
24 kooperativën bujqësore dhe aty bashkëpunonin, shisnin produkte
25 bujqësore.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 103

1 PY. Kam një pyetje specifike për Stanko Stankovic. Këta
2 shqiptarë që i kam përmendur, si e dinin ata, si e njihnin ata
3 Stanko Stankovic përveç arsyeve që ke përmendur ti deri tani?

4 PË. E njihnin për një arsye Stanko Stankovic për shkak se
5 djali i tij Ranko Stankovic punonte si postier.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që
7 këtë hartë me të gjitha shënimet e bëra ta paraqes si provë
8 materiale.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
10 kundërshtime?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kemi, nuk
13 ka kundërshtime.

14 A keni numër reference për këtë?

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Numri i hartës është
16 SPOE00301693 deri në 0031693.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky material
18 pranohet si provë dhe do t'i japim numër prove.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Harta e, me të gjitha
20 shënimet e bëra do të ketë numrin e provës P758.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, Krsta Jeftic apo Stanko Stankovic, a keni bërë
23 rezistencë në momentin kur ju kanë arrestuar?

24 PË. Jo, asnjë çast, nuk kemi rezistuar. Unë thjesht e pyeta
25 fqinjin tim Shukri Gashin, thashë, "Ç'po ndodh? Ç'është kjo

1 gjë?" Në atë moment ai më tha se nuk ishte në gjendje të
2 përgjigjej këtyre pyetjeve pasi ishte komandanti ai që do të
3 vendoste se ç'do të bëhej me ne. Nëse do të na mbanin të
4 ndaluar apo do të na lironin.

5 PY. Përmendët komandantin. Shukri Gashi, a përmendi që ai po
6 realizonte apo zbatonte urdhra, apo nuk tha gjë të kësaj
7 natyre?

8 PË. Kuptoj se ai zbatonte urdhrat e një komandanti, emrin e
9 të cilit unë nuk e dija.

10 PY. Nga deklarata juaj e ZPS-së, kemi parë që ju kanë mbajtur
11 të ndaluar në dy vende të ndryshme, dhe së pari dua t'ju pyes
12 për vendin e parë. Ky ishte vendi, apo shtëpia e z. Palushi. A
13 mendoni që mund të largoheshit nga kjo shtëpi në çdo moment që
14 do të dëshironit, a mund të largoheshit nga ai vend?

15 PË. Jo, nuk ishim në gjendje të largoheshim për shkak se
16 kishim duart e lidhura dhe sytë e lidhur po kështu. Përveç
17 kësaj, rreth nesh kishte një numër të madh ushtarësh.

18 PY. E njëjta pyetje edhe për vendndodhjen e dytë, për vendin
19 e dytë. Shtëpinë e Kokollarit. A mendoni që ishit në gjendje
20 që të largoheshit nga ai vend po të dëshironit dhe kur të
21 dëshironit?

22 PË. Jo, nuk ishim në gjendje të largoheshim as nga atje. Në
23 deklaratën time e kam thënë që në anën tjetër të këtij bodrumi
24 ndodheshin snajperët, të cilët ishin të pozicionuar në
25 shtëpinë përballë.

1 PY. Përveç snajperëve a mendoni që kishte ndonjë arsye tjetër
2 pse besonit që ishin në gjendje të largoheshit nga ai vend?

3 PË. Kam deklaruar po kështu, dhe kjo është në deklaratën
4 time, se pas keqtrajtimit dhe rrahjeve, ne po përpiqeshim të
5 kuptonim nëse do të mund të arratiseshim përmes, përmes
6 oxhakut, por [REDAKTUAR], që ishte i ndalur bashkë me ne,
7 na tha që ishte e pamundur që të arratiseshim për shkak se
8 snajperët ishin të vendosur në shtëpinë përballë.

9 PY. Në shtëpinë e dytë, në shtëpinë, në vendin e Kokollarit,
10 a ishit nën roje?

11 PË. Po, kishte dy roje. Njëri ishte pozicionuar në rrugë
12 përballë shtëpisë dhe i dyti ishte mu përballë derës ku na
13 mbanin të ndaluar.

14 PY. Po dera në atë vend a ishte e kyçur, apo jo? E a e di
15 këtë gjë?

16 PË. Ishte një derë druri, me dërrasa druri, dhe kishte një
17 zinxhir dhe një kyç, në atë moment ne ishim të kyçur brenda.

18 PY. Dëshmitar, në kohën që ju kanë mbajtur të ndaluar në
19 Budakovë, a ju kanë dhënë bukë dhe ujë?

20 PË. Jo. Jo, asnjëherë. Në deklaratën time unë thashë që kur
21 erdhi televizioni shqiptar për të njoftuar mbi këtë ngjarje,
22 përmenda që na dhanë një shishe me lëng frutash, por ajo në
23 fakt ishte me kapak të vënë dhe nuk ishim në gjendje të pinim.

24 PY. A të kujtohet në këtë vendin e dytë ku ju mbajtën të
25 ndaluar, a ju kanë mbajtur, a mban mend nëse ke pirë ujë në

1 atë vend? A të kujtohet ndonjë gjë e tillë?

2 PË. Në vendin e dytë në këtë bodrum [REDAKTUAR] i cili
3 ishte në këtë të ashtuquajtur burg, [REDAKTUAR] kishte gjetur një
4 shishe me ujë që e kishte gjetur aty në bodrum, na e dha dhe
5 e kemi pirë një gllënjë apo dy gllënjka e kështu me radhë.

6 PY. Dëshmitar, çfarë -- si ishte, sa ishte temperatura në atë
7 vend?

8 PË. Duke patur parasysh që ishim në mal, një zonë malore,
9 700, 800 metra mbi nivelin e detit, nata është e ftohtë. Dhe
10 ka qenë ftohtë, pavarësisht se ishte korrik.

11 PY. Ka arsye tjetër përse ndienit ftohtë në atë vend?

12 PË. Një përrua kalonte aty afër. Dhe ndoshta edhe ky ka
13 ndikuar në uljen e temperaturës.

14 PY. Pra, ti po flet për një mendimin tënd që ka qenë, që
15 ishte ftohtë. Po të ndaluarit e tjerë, a kanë thënë që ishte
16 ftohtë?

17 PË. Sigurisht që po, për shkak se bluzat, majicat, të cilat
18 ne i kishim veshur na i kishin hequr për të na lidhur sytë.
19 Kështu që pjesa e sipërme e trupit tonë ishte e zhveshur.

20 PY. Ti apo të ndaluarit e tjerë në Budakovë a ishit në
21 gjendje që të laheshit apo të shkonit në tualet gjatë asaj
22 kohe?

23 PË. Jo, fatkeqësisht jo. Ishte thjesht që dysHEMEJA ishte me
24 dhe, dhe ishte gjithandej mbushur me pluhur e kështu me radhë.

25 PY. Ti apo të ndaluarit e tjerë në Budakovë a ju kanë dhënë

1 ndonjë ndihmë mjekësore?

2 PË. Jo. Asnjë nuk kemi, nuk na është dhënë me përjashtim të
3 rrahjeve.

4 PY. Po familjen e keni parë ndërkohë që ju kanë mbajtur të
5 ndaluar? A keni patur kontakt me familjen?

6 PË. Jo, fare. Me përjashtim të ushtarit i cili më tha që
7 ishte vrarë babai im dhe që do të më lejonte të shkoja të
8 merrja pjesë në funeral, asgjë tjetër.

9 PY. Kur ishit i ndaluar, a ju ka vizituar ndokush nga jashtë?

10 PË. Jo, askush me përjashtim të ushtarëve të cilët bënë
11 roje, rojet pra.

12 PY. Në deklaratën tuaj për ZPS-në, 078045-TR-ET, Pjesa 2,
13 faqja 5, rreshtat 9 deri 13, ju thatë si më poshtë:

14 "Në atë moment ishim vetëm ne të tre, por pak më vonë
15 sipas mendimit tim... ndoshta mund të ketë qenë ora 21.00 apo
16 21.30 në darkë, arritën një grup njerëzish dhe këta ishin
17 fqinjët nga fshati im të cilët po u kërkonin atyre që të na
18 lironin."

19 A të kujtohet kjo gjë?

20 PË. Po, po. Më kujtohet shumë mirë. Më kujtohet kjo vizitë.
21 Dhe ishte vëllai i Shukri Gashit, Fadil Gashi dhe Jetish
22 Kabashi. Unë nuk i kam parë pasi ishte i kyçur brenda, por i
23 dëgjova dhe i njoha nga zëri për shkak se ata ishin mësues në
24 shkollën fillore ku kisha shkuar edhe unë.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutem të nderuar Gjykatës, por

1 duhet, por ndoshta duhet të përdorim numrin e referencës P756
2 me numrin 1, apo 2, apo kështu, për ta sqaruar këtë çështje.
3 Për procesverbalin që kemi këtu.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dakord, të nderuar Gjykatës,
5 ashtu do të vazhdoj. E korrigjoj dhe një herë, pra bëhet fjalë
6 për P756.2.

7 PY. Pra, nuk i keni parë. Por dëgjuat, dëgjohej nga zëri. A u
8 lejuat ju që të flisnit me ta, ndoshta dhe nga ana tjetër e
9 derës?

10 PË. Jo, fare. Unë thjesht i dëgjova që ata kërkonin që ne të
11 na lironin ndërkohë që rojet u thanë që të ktheheshin nga ku
12 kishin ardhur sa më shpejt që të ishte e mundur, me qëllim që
13 të mos i ndalonin edhe ata së bashku me ne në atë bodrum.

14 PY. Psikologjikisht si ndiheshit ju gjatë gjithë atyre kohëve
15 që ju kanë mbajtur të ndaluar në Budakovë?

16 PË. Torturë. Mendimi i vetëm që kishim ishte nëse do të
17 mbijetonim dot apo jo.

18 Z. KEHOE: [Përkthim], ju kërkoj ndjesë Avokat.

19 Unë po shoh sa është ora, i nderuar Gjykatës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A është ky
21 një moment i përshtatshëm për ta përfunduar këtë pyetje?

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, është momenti i duhur,
23 desha të filloja një tematikë të shkurtër.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,
25 dëshmitar, do të marrim pushim, do të kthehemi në orën 14.30.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 109

1 mos flisni me askënd jashtë sallës së gjyqit. Nëse dikush
2 dëshiron të flasë me ju lidhur me dëshminë, ju do të na
3 njoftoni menjëherë.

4 Tani mund të largoheni së bashku me Sekretarinë.

5 DËSHMITARI: [Përkthim] Dakord.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
8 mblidhemi sërish në orën 14.30.

9 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

10 --- Seanca rifillon në orën 14.30

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

12 Sekretare, ju lutemi silleni përsëri dëshmitarin në sallë.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
15 të vazhdojmë më tej me dëshminë tuaj.

16 Prokuroria do të vazhdojë me pyetjet e mbetura.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
18 Gjykatës.

19 Të nderuar Gjykatës, kam disa pyetje të tjera, por për
20 t'i bërë këtë pyetje do preferoj që të kalojmë në seancë
21 private.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
23 kalojmë në seancë private.

24 [Seancë private]

25 [Seancë private teksti i fshirë]

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 110

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 111

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 112

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 113

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 114

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
2 jemi në seancë të hapur.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

5 PY. Dëshmitar, ju apo personat e tjerë që kanë qenë aty të
6 ndaluar me ju, a ju dha ndonjë arsye nga UÇK-ja se pse ishin
7 të ndaluar?

8 PË. Jo. Askush prej nesh nuk e dinte se për çfarë arsye ishim
9 ndaluar. Nuk na u dha asnjë shpjegim; nuk e dinim se pse ishim
10 ndaluar atje. Askush s'na tha se cila ishte baza ligjore, mbi
11 bazën e -- cilit ligji, cilit neni, asgjë nuk dinim.

12 PY. A ju dha ndonjë kopje e vendimit mbështetur në të cilin
13 ishte bërë arrestimi dhe burgosja juaj?

14 PË. Jo, asnjëherë. Asnjëherë nuk kemi marrë asnjë dokument.

15 PY. A ju dha ndonjëherë ndonjë dokument lirimi, mbase?

16 PË. Jo. Nuk kemi marrë asnjëherë asnjë dokument, asnjë gjë të
17 kësaj natyre. Thjesht na thanë, ikni dhe mos u ktheni kokën
18 pas, sepse po ta kthenim kokën pas do të qëllonin në drejtimin
19 tonë.

20 PY. A ju dha ndonjë mundësi për të kundërshtuar ndalimin,
21 arrestimin tuaj?

22 PË. Jo, aspak.

23 PY. Ju apo të ndaluar të tjerë a keni dalë përpara ndonjë
24 gjykatësi apo trupi gjykues gjatë kohës kur keni qenë të
25 ndaluar në Budakovë; kur keni qëndruar në Budakovë?

1 PË. Jo, përpara askujt. Përveç komandantit i cili u vu re që
2 të kishte vënë një beretë të kuqe gjatë pjesës së parë të
3 kohës kur ne kemi qenë në bunker, në kopsht. Ai kishte një
4 shënim ku mbante shënimet dhe e dija këtë gjë.

5 PY. Ju ose ndonjë i ndaluar tjetër, jeni akuzuar për ndonjë
6 krim?

7 PË. Jo. Askush nuk na akuzoi ne për asgjë; askush nuk na
8 tregoi asgjë; askush nuk provoi asgjë, absolutisht asgjë fare.

9 PY. Kjo ishte pyetja ime e radhës. Në qoftë se ndonjë person
10 ju dha ndonjë provë apo ju dha ndonjë dokument ju apo ndonjë
11 personi tjetër që mbahej aty bashkë me ju?

12 PË. Jo, jo, sepse nuk kishte fare asnjë lloj baze. Nuk kishte
13 asnjë lloj shkak dhe nuk kishte asgjë për të provuar me
14 ndonjë dëshmi.

15 PY. Dëshmitar, a e dini në qoftë se UÇK-ja ka ndëshkuar apo
16 ka marrë masa disiplinore ndaj personave që u arrestuan,
17 ndaluan ose keqtrajtuar juve?

18 PË. Nuk e kam këtë informacion. S'kam mësuar asnjëherë një
19 gjë të tillë; nuk kam marrë vesh asnjëherë diçka të tillë që
20 ka pasur ndonjë proces apo ndonjë masë disiplinore që është
21 marrë kundër tyre apo që të jenë konsideruar e vlerësuar si
22 përgjegjës në ndonjë formë. Asnjë të kësaj natyre.

23 PY. Dëshmitar, a jeni vizituar nga një mjek menjëherë pas
24 lirimit tuaj nga Budakova?

25 PË. Kur jemi liruar nga Budakova, së pari kemi mbërritur në

1 Reçan. Atje mbërriti policia serbe; na mori policia, na dërgoi
2 në stacionin e policisë dhe aty pritëm që të jepnim një
3 deklaratë. Gjykatësi-hetues nga Prizreni mendoj që të vinte
4 aty. Ai quhej Skënder apo Skënderi, nuk më kujtohet se si e
5 kishte mbiemrin.

6 Kur mbërritëm në stacionin e policisë, na pyetën "Për
7 çfarë po prisni?". Dhe ne i thamë që po presim për gjykatësin.
8 Më pas pasi dhamë deklaratën erdhi doktori Boban Boksanović që
9 bëri një kontroll tonin në një apartament privat dhe ai vuri
10 re që ne kishim disa lëndime për të cilat ishim ankuar.

11 PY. Kjo vizitë e juaj ku ndodhej, ku në çfarë vendi
12 ekzaktësisht u bë kjo vizitë e juaja prej mjekut?

13 PË. Vizita u zhvillua në një apartament privat në Suharekë.

14 PY. Si u krye kjo vizitë? A mund t'i tregoni Trupit Gjykues?

15 PË. Po, patjetër. Nuk kishte kushte të mirëfillta; nuk kishte
16 një skaner, por mbërriti me një çantë. Aty kishte aparatën për
17 matjen e -- tensionit të gjakut, stetoskopin dhe ai vërejti që
18 si në rastin e Krstas unë isha i lënduar në kokë se u ankova
19 që kisha lëndim në të majtë dhe në të djathtë. E pa këtë gjë
20 dhe pa gjithashtu që brinja e pesë ose e gjashtë ishin të
21 thyera. Megjithatë, kjo nuk është e rëndësishme. E rëndësishme
22 është që ishim ende gjallë. Kishim hematoma, lëndime e të
23 tjerë.

24 PY. E kuptoj. Ju thatë që kishte pajisje që përdori ai.

25 Përmendët një aparat për matjen e tensionit dhe thatë që

1 kishte dhe stetoskop, kështu apo jo?

2 PË. Po. Stetoskop me atë të të cilit mendohej që të dëgjonte.

3 Nuk e di se si ta quaj tamam, por siç i përdorin mjekët këto

4 aparaturat që i vënë në vesh mjekët dhe që i përdorin për

5 vizita mjekësore që të matin rrahjet e zemrës, kur mjeku të

6 thotë që merr frymë thellë, mbaje frymën, nxirre frymën e

7 kështu më radhë.

8 PY. A bëri mjeku një ekzaminim të jashtëm të trupit tuaj? A e

9 pa trupin tuaj mjeku?

10 PË. Po, pra, bëri një ekzaminim, vizitë mjekësore më të

11 thjeshtën të mundshme, asgjë më tepër sesa kaq.

12 PY. Dëshmitar, do t'ju tregoj një dokument.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Është një dokument që nuk i

14 duhet treguar publikut dhe do i kërkoja Sekretares ta paraqesë

15 këtë dokument në ekran. Është dokument që mban datën 5 korrik

16 1998, me numër identifikimi ERN 0188-3935-0188-3937-ET,

17 Revised. Ju lutem, paraqisni për dëshmitarin vetëm një faqe të

18 vetme që përfundon me 3936. Kjo është në versionin në

19 anglisht.

20 Ndërkohë që i njëjti numër është edhe në dokumentin

21 serbisht, por numri ERN është paksa ndryshe. ERN-ja në

22 serbisht është 0188-3198 [sipas përkthimit]-0188-3944. E njëjta

23 faqe që përfundon me 3936.

24 Po, ky është dokumenti.

25 PY. Dëshmitar, a shihni dy dokumente përpara në ekran? Në të

1 majtë është dokumenti në serbisht. E shikoni këtë? A e keni
2 parë më herët, më përpara këtë dokument?

3 PË. Jo, nuk e kam parë asnjëherë. Asnjëherë nuk më është
4 paraqitur një dokument i tillë përpara dhe emri i babait është
5 shkruar gabim. Babai im quhet Zlatibor.

6 PY. Kemi organizuar një seancë përgatitore, Dëshmitar, kur ju
7 kemi treguar këtë dokument. A ju kujtohet ta keni parë këtë
8 dokument kur jua kemi treguar ne?

9 PË. Po, po. Por përveç asaj date kur ma keni treguar ju nuk e
10 kisha parë asnjëherë më përpara këtë dokument.

11 PY. E kuptoj. Ky dokument a lidhet me vizitën mjekësore që ne
12 përshkruam pak më përpara bashkë?

13 PË. Mbase. Ndoshta ishte i njëjti mjek, Boban Vuksanoviq. Sa
14 i takon dokumentit nuk pretendoj dot asgjë lidhur me të, sepse
15 më duket shumë i paqartë.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja
17 që ky dokument të pranohet si provë materiale.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtoj -- nuk kam kundërshtim.

19 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
21 Dokumenti që mban numrin e identifikimit ERN 0188-3934 [sipas
22 përkthimit]-0188-3937 dhe ERN-ja në serbisht 0188-3938-0188
23 [sipas përkthimit] pranohen si prova materiale.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sa
25 për sqarim, kërkohet si provë -- të regjistrohet si provë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 120

1 materiale vetëm një faqe apo i gjithë dokumenti?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
3 çaktivizuar]

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Vetëm kjo faqe që kemi këtu
5 përpara në ekran.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 kjo faqe do të marrë numrin e Provës Materiale P759.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

9 PY. Dëshmitar, Krsta Jeftiq a iu nënshtrua një vizite
10 mjekësore atë ditë, të njëjtën ditë si dhe juve?

11 PË. Po, sigurisht. Ne ishim bashkë. Ishim të dy në të njëjtin
12 apartament. Dhe ai ishte vendi ku na vizitoi mjeku. Ndërsa
13 Stanko Stankoviq qëndroi në shtëpi dhe asnjëherë nuk doli
14 përpara një mjeku.

15 PY. A e keni parë Krsta Jeftiq që të vizitohet nga mjeku?

16 PË. Po, sigurisht. Mjeku shënoi që Krsta Jeftiq kishte një
17 lëndim në të djathtë të kokës së tij, me sa më kujtohet. Këtë
18 gjë mbajti shënim mjeku.

19 PY. Në deklaratën që i keni dhënë ZPS-së, Dëshmitar - për
20 procesverbal është Prova Materiale P756.2, faqja 20, rreshtat
21 nga 18 deri në 22 - ju thoni si më poshtë, sa i takon Stanko
22 Stankoviq. Ju lutem dëgjojeni. Ju thoni, dhe citoj:

23 "Ai kishte disa të prera me thikë në kurriz. Këto të
24 prera me thikë mendoj që nuk ishin kërcënuese për jetën, por
25 psikologjikisht ai ishte shumë keq. Ishte në një gjendje shumë

1 të keqe psikologjike dhe ai gjithashtu pinte shumë alkool dhe
2 ai nuk ka ndaluar së piri alkool derisa ka vdekur që prej asaj
3 kohe".

4 Të flasim pak për këto të prera me thikë. A e keni parë
5 ju me sytë tuaja këto prerje me thikë në trupin e tij?

6 PY. Po, i kam parë. Kishte dy ose tri të prera me thikë në
7 pjesën e sipërme të trupit. Kur ata na liruan, atë mëngjes,

8 Stanko pati një spazmë në të dyja këmbët edhe përreth 1
9 kilometri e kemi tërhequr zvarrë dhe më pas kam pasur

10 mundësinë që ta shikoj këtë, sepse ne nuk i kishim parë

11 lëndimet se i kishim sytë e mbyllura dhe në këtë rast, në

12 fakt, pata mundësi që të shikoja këto lëndime që kishte në

13 kurriz. Por që siç e thashë nuk ishin kërcënuese për jetën.

14 PY. Kam një pyetje të fundit për juve. Tek kjo pjesa që sapo

15 jua lexova, ju thoni që ai ishte në kushte shumë të këqija

16 psikologjike dhe thoni gjithashtu që abuzonte me alkoolin.

17 Pyetja që kam për juve është kjo: A ju ka treguar arsye Stanko

18 Stanković se pse kushtet e tij psikologjike ishin të rënda dhe

19 pse ishte i varur nga alkooli?

20 PË. Po, më ka treguar. Stanko Stanković derisa vdiq

21 përsëriste që ndihej fajtor dhe ndiente përgjegjësi që na

22 kishte vozitur me makinë deri në Movljanë atë ditë në Movlan

23 atë ditë. Sepse ai ndihej fajtor dhe pa përvojë në luftë dhe

24 ai mund të -- për shkak të veprimeve të tij do të mund të

25 kishim humbur edhe jetën. Dhe për këtë arsye ishte në

1 depresion dhe asnjëherë nuk ka ndaluar së piri alkool.
2 PY. Ndoshta pyetja ime e fundit. Ju përmendët që Stanko
3 Stankoviq nuk ishte në gjendje që të ecte. Si e dini ju këtë
4 gjë? Dhe ju të tre pastaj e ndihmuat, kështu?
5 PË. Ai u ankua që kishte spazma në pjesën e poshtme të
6 këmbëve, ndoshta për shkak të qarkullimit të keq të gjakut, se
7 i është dashur që të qëndronte i ulur për një kohë të gjatë
8 ose për shkak të kurrizit të tij. Nuk e shpjegoj dot tamam por
9 në momentin kur ai filloi që të ngrihej në këmbë filloi që të
10 lëvizte ngadalë deri në një moment. Mundi të ecte, domethënë,
11 dikur pas një ore apo 45 minuta. Nuk e di, mendoj ndoshta i
12 ndaloi qarkullimi i gjakut ose nuk e di se çfarë, cila mund të
13 ketë qenë arsyeja, por në atë pikë ai ndaloi së foluri.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam
15 pyetje të tjera për këtë dëshmitar.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe,
17 fjala për ju.

18 Pyetje të palës tjetër nga Z. Kehoe:

19 Z. KEHOE: [Përkthim]

20 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Unë quhem Gregory Kehoe dhe
21 përfaqësoj President Thaçin dhe kam pak pyetje për ju. Sikurse
22 ju tha Gjykatësi Smith fillimisht, nëse nuk e kuptoni ndonjë
23 prej pyetjeve ju lutem më thoni, më njoftoni. Do ta përsëris
24 pyetjen. Dhe nëse ju ndërpres gjatë kohës që po përgjigjeni ju
25 kërkoj ndjesë paraprakisht. Më thoni thjesht që nuk kam

1 përfunduar ju lutem. Në rregull?

2 PË. Në rregull. Faleminderit.

3 PY. Dëshmitar, flasim sërish për ngjarjet e 3 korrikut. Ju
4 kishit dalë me xhaxhain tuaj Krsta, me sa kuptova unë, pranë
5 fshatit tuaj dhe ndërkohë po ndodhnin luftime mes forcave
6 serbe dhe UÇK-së, kështu?

7 PË. Jo, nuk po shëtisnim. Unë dhe Krsta më 3 korrik po
8 kujdeseshim, po kullosnim lopët, jo shumë larg nga fshati
9 Movljanë. Dhe pasdite pati një sulm ose më saktë një incident
10 mes një patrulle të policisë serbe dhe UÇK-së, trupave të UÇK-
11 së. Në ato momente ne ishim jashtë fshatit dhe nga ai moment e
12 në vijim ne nuk mund të ktheheshim më dot në fshat. Kështu që
13 filluam të ecnim në pyll. Shkuam te fshati fqinj Reçan.

14 PY. Dhe kur po kullosnit lopët siç thatë po -- ndodhnin
15 luftime mes forcave serbe dhe UÇK-së, apo jo?

16 PË. Po, kështu.

17 PY. Shumë pranë jush, apo jo?

18 PË. Po, po. Fshati është fshat malor. Shkuam në veri të
19 fshatit. Sulmi po ndodhte në jug të fshatit. Patrulla e
20 policisë serbe shkoi nga Suhareka drejt Movljanës për të parë
21 se si ishte popullata serbe në atë fshat.

22 PY. Pra, kur MUP-i serb shkoi nga Suhareka në fshatin tuaj
23 Movljanë, në këtë momente ndezi filluan dhe luftimet, apo jo?

24 PË. Po, në këtë momente filluan luftimet --

25 PY. Kur thoni luftime dëgjuat automatikë, dëgjuat mitraloza?

1 PË. Po. Dëgjuam disa shpërthime që ishin goxha të forta.

2 Këto, çfarë ishin këto artileri, ishin granata, çfarë ishin?

3 PË. Nuk di të ta them me saktësi tani, se nuk është se pata
4 ndonjë kontakt që të më thonin çfarë armësh kishin përdorur.

5 Por ishin goxha të fuqishme.

6 PY. Në qoftë se ishin shpërthime të forta që vinin nga
7 polica, vinin nga policia dhe nga ushtria serbe, apo jo?

8 PË. Nuk jua them dot me saktësi, sepse ishim në kodër dhe nuk
9 -- dëgjuam vetëm shpërthimet; pati të shtëna.

10 PY. Po ju lexoj ato që i keni thënë Prokurorisë në lidhje me
11 këtë. Në lidhje me këto luftimet mes UÇK-së dhe serbe.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Është materiali me numër -- është
13 Prova Materiale 756.1, faqja 8, rreshti 8 deri 15.

14 PY. "Kur arritëm pikën më të largët, pati një fluks të madh
15 personash, shumë shqiptarë, gra e fëmijë po hynin po ashtu në
16 pyll në të njëjtën kohë...".

17 Çfarë ndodhi për shkak të luftimeve, civilët, gratë edhe
18 fëmijët i larguan nga fshati dhe po shkonin drejt pyllit, apo
19 jo?

20 PY. Jo. Fshati ynë ishte i ndarë në fshatin e epërm, pjesa e
21 epërme dhe pjesa e poshtme. Në pjesën e poshtme ishin
22 kryesisht serbët, në pjesën e epërme kishte kryesisht
23 shqiptarë. Dhe kur filluan të shtënat gratë dhe fëmijët
24 filluan të largoheshin prej shtëpive dhe po ecnin në drejtim
25 të pyllit ku dhe ne, ku ishim dhe ne dhe u takuam.

1 PY. Mirë, Dëshmitar. Gratë dhe fëmijët ishin nga i njëjti
2 fshat, ishin -- vinin nga fshati Movljanë dhe u larguan për
3 shkak të përplasjes mes MUP-it dhe UÇK-së, apo jo?

4 PË. Po, po. Kjo është nja 300 metra, pylli është nja 300 larg
5 fshatit. Është në drejtim të fshatit Vrsevac.

6 PY. Unë po ju them që si rezultat i luftimeve që po ndodhnin
7 në fshatin tuaj gratë dhe fëmijët -- pra, po largoheshin për
8 shkak të faktit se forcat serbe hynë në fshat dhe filluan të
9 sulmonin.

10 PË. Sapo filluan të shtënat, për arsye sigurie personat
11 filluan të dilnin prej shtëpive të tyre dhe të largoheshin nga
12 fshati. Para se të hynte ushtria, por me sa më kujtohet mua
13 s'ka pasur fare ushtri, ka pasur vetëm polici me sa më
14 kujtohet dhe me sa di. Dhe kur ata hynë në fshat, fshati
15 ndërkohë ishte evakuuar. Nuk është se kishte më persona në të.

16 PY. Po ju lexoj një material që është SPOE00226697 deri në
17 00226716. Fatkeqësisht nuk ka përkthim në -- serbisht, kështu
18 që po ju lexoj faqet përkatëse 2 dhe 3.

19 Bëhet fjalë për luftimet që kanë ndodhur atë datë, më 3
20 korrik. Thuhet:

21 "Ditën e shtatë armiku", armiku në këtë rast është serbi,
22 "ka -- filloi një sulm me forcat ushtarake dhe policore serbe
23 të mbështetur nga tri automjete të blinduara: një furgon edhe
24 një automjet tjetër nga Suhareka në drejtim të Krushës,
25 Krushicës dhe Movljanit. Beteja e parë ka ndodhur në momentin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 126

1 -- luftimet zgjatën për tri orë. Komandanti i Kumanovës erdhi
2 të na ndihmonte me një grup nga Brigada 121 dhe beteja
3 përfundoi rreth orës 21:00".

4 Me sa dini ju, a është vërtetë ky një përshkrim i saktë i
5 asaj që ka ndodhur në fshatin tuaj sa i takon këtij sulmi nga
6 serbët?

7 PË. Nuk më kujtohet ky sulm dhe as nuk kam dijeni për një
8 sulm të tillë.

9 PY. Pra, ju thjesht e keni dëgjuar, keni dëgjuar; dëgjuat të
10 shtënat, dëgjuat artilerinë, automatikët, mitralozat, a i
11 dëgjuat këto?

12 PË. Me përjashtim të 3 korrikut, se jua përshkrova çfarë
13 ndodhi, nuk jam në dijeni për ndonjë incident tjetër, as kam
14 dëgjuar dhe as më kujtohet diçka e tillë.

15 PY. Mirë, vazhdojmë më tej me historinë tuaj. Historia juaj
16 është kështu: Kur ishit në pyll hasët disa ushtarë të UÇK-së
17 dhe dikush që ju i thatë ZPS-së se e kishte emrin Bajram
18 Morina, thanë që keni parë një person me emrin Bajram Morina,
19 kështu?

20 PË. Po. Kur filluam t'ia mbathnim, sepse nuk mund të
21 ktheheshim më në fshatin tonë Movljanë. Kur ishim në pyll
22 ishim -- u afruam në fshatin Stara Vuçina dhe në atë moment
23 pamë një grup ushtarësh të UÇK-së. Në këtë momente Bajram
24 Morina kur na pa që po ecnim në atë drejtim ai tha,
25 "Çfarë ka ndodhur?". Në atë momente unë i thashë në shqip, iu

1 përgjigja në shqip, "Duhet të shpëtojmë gratë dhe fëmijët që
2 janë atje poshtë", sepse ishte dhe koha që korreshin, korrej
3 kultura bujqësore.

4 Dhe në atë momente çfarë ndodhi kur na njohu filloi të
5 gjuante me armë dhe ata ishin -- ne ishim rreth 350-400 metra
6 larg. Ishte një përrua atje. Ne deshëm të mos kalonim në
7 magjistrale dhe të kalonim nga Reçana -- drejt Vuçinës së
8 Vjetër edhe plumbat më kalonin nga të gjitha anët ose të
9 paktën kështu më dukej mua nga frika ose mos se ka ndodhur në
10 realitet. Nuk mund ta them me siguri këtë, nuk mund ta them me
11 siguri.

12 PY. A keni ndonjë shenjë që mund të na e tregoni prej këtyre
13 plumbave?

14 PË. Jo, jo. Prandaj thashë që thjesht m'u krijua përshtypja,
15 po ju them mbase, ashtu m'u duk mua. Këtë ndjesi pata.

16 PY. Dhe ju patë këta anëtarët e UÇK-së. Ju thatë në orën --
17 thatë në, pra, në Provën Materiale 756, faqja 10, 756.1, faqja
18 10, 19 deri 24, në këtë pjesë ju përshkruani këta ushtarët që
19 ishin me Bajram Morinën si terroristë apo jo?

20 PË. Jo tamam terroristë. Nuk e di si e keni kuptuar ju
21 konceptin e terrorizimit. Disa prej tyre kishin uniforma, disa
22 të tjerë ishim me -- rroba civile, por kishin armë.

23 PY. Në Provën Materiale 756, faqja 10, rreshti 19 deri 24

24 ZPS-ja e pyet:

25 "Po çfarë kishin veshur këta anëtarët e UÇK-së?".

1 Dhe ju përgjigjen:

2 "Ose terroristët siç duhet t'i quaj".

3 Ju i keni quajtur këta terroristë; ju i keni thënë ZPS-së
4 se ishin terroristë, apo jo?

5 PË. Mbase e kam thënë pa dashje. Jo se doja t'i ofendoja.

6 Mbase e kam thënë pa dashje fjalën terrorist.

7 PY. Mirë, do ju tregoj një pjesë tjetër të dëshmisë suaj.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Po në Provën Materiale 756.1,
9 rreshtat 10 dhe 11. Më falni, doja të thoja faqja 14, rreshtat
10 10 dhe 11.

11 PY. Thua:

12 "... ne vazhduam dhe nja 300 e ca metra përpara se të
13 hynim në fshatin Movljanë dhe aty pamë një grup terroristësh
14 që mbanin uniforma të zeza".

15 Dhe ju bëjnë një pyetje në faqen 24 të Provës Materiale
16 756.1 në rreshtat 1 deri në 5.

17 Pyetje:

18 "Shtëpia ishte me roje?".

19 "Po. Kishte persona me uniformë atje. Ne mbërritëm atje.
20 Vlerësimi im është që atje kishte nja 12 a 13 [sipas
21 përkthimit] terroristë".

22 Pra, zotëri, ju në mënyrë të vazhdueshme UÇK-në e keni
23 përshkruar si terroristë, apo jo?

24 PË. Mbase dhe mund ta kem thënë, por e kam thënë në

25 subkoshiençë. E kam thënë pa dashje, nuk kam dash -- të

1 ofendoj askënd.

2 PY. Pra, -- ta quash dikë terrorist ose po e le me kaq, nuk
3 po e vazhdoj fare. Po e le dëshminë siç e keni dhënë.

4 Këta persona që ju patë në fshat me Bajram Morinën, disa
5 kishin uniforma dhe disa ishin me rroba civile apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Ju jeni afër ditëlindjes suaj kur ka ndodhur kjo. Pra,
8 mbushnit 19 vjeç pak a shumë kur ka ndodhur kjo?

9 PË. Po. Më 7 korrik 1998, unë mbusha 19 vjeç.

10 PY. Edhe kushëriri juaj Krsta ishte po ashtu 10 vjeç, apo jo?

11 PË. Në tetor, më 5 tetor do të mbushte 19 vjeç.

12 PY. Ju kur ishit 19 vjeç u bëtë pjesë e armatës jugosllave,
13 apo jo? E ushtrisë serbe.

14 PË. Jo.

15 PY. Po sa vjeç ishit ju në vitin 1999, në mars '99 kur u
16 kyçët në -- forcën jugosllave, sa vjeç ishit?

17 PË. Jo, nuk jam kyçur; nuk jam kyçur në ushtri. Ne kryem
18 shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Kur mbushëm 19 vjeç na erdhi
19 fletëthirrja për shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Ka qenë
20 mesi i marsit. Ndërsa më 24 mars filluam bombardimet në ish-
21 Republikën Federale të Jugosllavisë.

22 PY. Pra, kur ju kërkuan që të regjistroheshit në ushtri në
23 mars të '99-s ju ishit 19 vjeç apo jo?

24 PË. Po, patjetër.

25 PY. Këto ngjarje kanë ndodhur në korrik të 1999. Ju

1 personalisht dhe kushëriri juaj, Krsta, a xhaxhai më saktë,
2 ishit në moshë luftimesh, pra. Ju ishit duke mbushur prag --
3 duke mbushur 19 vjeç.

4 PË. Po. Por nuk kishim asnjë detyrë policore apo ushtarake në
5 '98.

6 PY. Do flasim edhe për atë më vonë. Pra, hyni në pyll, shihni
7 Bajram Morinën, i tregoni këtë versionin tuaj që ne jemi këtu
8 për të mbrojtur gratë dhe fëmijët që janë në pyll, kështu?

9 PË. Ju kërktoj falje, por kam idenë që më keni keqkuptuar.
10 Gratë dhe fëmijët nuk ishin në pyll. Unë ju thashë se ishin në
11 luginë, po -- mblidhnin kashtën. Pra, gratë dhe fëmijët me
12 etni shqiptare ishin larguar nga fshati në të njëjtën mbrëmje.

13 PY. Po ju i thatë Bajram Morinës se ju dhe xhaxhai juaj
14 Krsta, që jeni të njëjtës moshë, po përpiqeshit të ndihmonit
15 këta persona. A i thatë këtë atij?

16 PË. Jo. Ne i thamë, gratë dhe fëmijët, gratë dhe fëmijët tanë
17 ishin atje. Më keni keqkuptuar.

18 PY. Në rregull. Por kur Bajram Morina zbuloi pse ishit atje
19 ai ju la të kalonit apo jo? Ai tha, "Hajde, janë okej". A nuk
20 tha kështu?

21 PË. Jo. Ai tha, "Nxito, nxitoni, nxitoni, nxitoni që të
22 shkoni sa më shpjet, që të shkonit tek ata", dhe ne vazhduam.

23 PY. Po gjatë kohës që po bënit këtë, patën këtë komunikim me
24 Bajram Morinën në të njëjtën kohë kishte një betejë mes
25 forcave serbe dhe UÇK-së. Po ndodhte beteja, po zhvillohej

1 beteja.

2 PË. Në ato momente ne ishim shumë larg nga beteja. Dhe nuk
3 mund të them me siguri se dëgjoja të shtëna. Pashë një grup
4 personash që iknin nga Stara Vuçina drejt Movjlanit mbase për
5 të ndihmuar personat e tjerë që ishin pjesë e luftimeve.

6 PY. Dëshmitar, dëgjoje pyetjen time. Kur pe Bajram Morinën
7 dhe i tregoje se çfarë po bëje dhe ai ju tha që të vazhdonit,
8 në këto momente po zhvilleshin ende luftimet mes UÇK-së dhe
9 Serbisë, mes serbëve, po apo jo?

10 PË. Ka të ngjarë që po.

11 PY. Dhe pasi Bajram Morina ju la të largoheshit bashkë me
12 xhaxhain tuaj ju dhe Krsta vrapuat në pyll, apo jo?

13 PË. Po kjo është një pjesë ku kemi dhe pronat, ishte një
14 pjesë ku kishim dhe pronat. Fshatarët e Stara Vuçinës dhe të
15 Movjlanit kishin pronat atje. Edhe në atë zonë ka një përrua
16 që kalon në për 200 metra në kodër. Në atë pikë filluam të
17 vraponim ne dhe në atë pikë ata e kuptuan që ne ishim serbët.

18 PY. Po Bajram Morina ju njihte ju dhe ai e dinte që ju ishit
19 serbë që kur ju ndaloi dhe biseduat me të. A nuk e dinte ai në
20 ato momente?

21 PË. Jo, jo nuk e dinin. Në ato momente, më falni, në ato
22 momente gjërat zhvillimet ndodhën ishin shumë të shpejta dhe
23 ai nuk e kuptoi që ne ishim serbë -- sepse nuk na njohu.

24 PY. Po ju e njihnit Bajram Morinën, apo jo?

25 PË. E njihja, po, sepse punonte me babain e Krsta Jeftiq,

1 xhaxhait tim.

2 PY. Po ju i thatë ZPS-së që e njihnit Bajram Morinën qysh
3 para lufte, apo jo?

4 PË. Po, e saktë. Të gjitha fshatrat fqinj ku kishte shqiptarë
5 mund të them që njihja 99 për qind të fshatarëve. Ua dija
6 emrin e mbiemrin, ata më njihnin mua, njihnin babain tim,
7 familjen time.

8 PY. Dhe në fakt ju i keni thënë ZPS-së, kur ju bëri pyetje
9 sot paradite që njerëzit njiheshin me njëri-tjetrin, sepse
10 ishit pjesë e të njëjtit komunitet, apo jo?

11 PË. Në fakt ishin rreth 200 a 202 serbë që jetonin në atë, në
12 gjithë atë zonë, rreth e rrotull fshatit të Movljanit.
13 Ndihehim të lirë, shoqëroheshim, dilnim për gjah bashkë,
14 bënim shumë veprimtari bashkë, sportive gjithashtu. Kemi
15 shkuar në të njëjtën shkollë, vetëm se një anë kishte
16 kryesisht shqiptarë dhe ana tjetër kishte më shumë serbë.

17 Asnjëherë s'patëm probleme, asnjëherë nuk jemi zënë, as
18 nuk jemi grindur në shkollë.

19 PY. Pra, kjo lidhet pikërisht me atë që ju thashë unë më
20 herët. Kur ju pa ju Bajram Morina atë pasditen e 3 korrikut,
21 ai e dinte shumë mirë kush ishit ju, apo jo?

22 PË. Besoj se në ato momente nuk -- na njohu dhe vetëm kur na
23 pa që po vraponim e kuptoi se kush ishim.

24 PY. Pra, ju shihni Bajram Morinën, ai ju lejon të kaloni dhe
25 ju jeni dy 19-vjeçarë në moshë luftimesh. Sapo ju jepet shansi

1 filloni të vraponi, apo jo?

2 PË. Po. Sepse kuptuam që do të kishim telashe nëse do i
3 shihnim dhe një herë, sepse para se të ndodhte ky incident
4 kishte pasur shumë raste ku personat ishin rrëmbyer; tri
5 kushërinjtë tanë nga -- Reçani ishin rrëmbyer. Edhe kur na u
6 kujtuan këto incidente e kuptuam shumë mirë se si ishte
7 situata e sigurisë dhe nuk donim që të gjendeshim në një
8 situatë të ngjashme.

9 PY. Çfarë bëni ju pastaj? Ju vraponi drejt shtëpisë së
10 xhaxhait tuaj, Stanko Stankoviçit, në Reçan, apo jo?

11 PË. Po. Rreth orës 19.00 të pasdites më 3 korrik mbërritëm në
12 shtëpinë e Stanko Stankoviçit dhe kaluam mbrëmjen atje dhe të
13 nesërmen në mëngjes rreth orës 07.00 apo 06.45, Stanko
14 Stankoviçi propozoi që të na çonte, të na kthente në shtëpi me
15 një automjet. Pra, të na çonte me një autokombajnë - më falni
16 në shtëpi.

17 PY. Pra, shkoni me Stanko Stankoviçin, me xhaxhain tuaj
18 Krsta, dhe drejtoheni për fshatin tuaj. Kjo është një ditë
19 pasi ka ndodhur beteja dhe përpara se të rifillojë sërish dhe
20 ju jeni me armë, keni pushkë e pistoleta, apo jo?

21 PË. Jo. Atë paradite kur u nisëm për të shkuar për në fshatin
22 Movljanë, pistoleta edhe arma e gjahut e Stanko Stankoviçit u
23 gjendën në autokombajnë, ishin në autokombajnë. Por unë nuk
24 kisha dijeni për -- që ekzistonte kjo pistoletë. Rreth,
25 përpara Movljanës atë paradite në orën 07.30 të mëngjesit.

1 PY. Më lejoni t'ju sqarojmë dhe një herë. Këtë pyetje jua ka
2 bërë kur ju ndaloi Shukri Gashi. Është në Provën Materiale me
3 numër 756.1, faqja 16, rreshti 24, deri në faqen 17, rreshti
4 5:

5 "Shukri Gashi afrohet dhe bisedonit me të, i tregonit
6 çfarë kishte ndodhur".

7 "PË. Sokol Kabashi po ashtu u afrua. Ai kontrollloi
8 automjetin dhe na sekuestroi "pushkën tonë", pushkën tonë,
9 thoni "dhe pistoletën tonë. Sokoli e mori pistoletën dhe ia
10 dorëzoi këtë një grupi me 15 persona. Nuk më kujtohet
11 konkretisht kush u afrua dhe e mori pushkën".

12 Pra, i keni thënë ZPS-së kur ju ka intervistuar në vitin
13 2020 që na kontrolluan dhe na konfiskuan pistoletën edhe
14 pushkën tonë, kështu?

15 PË. Jo ose më saktë, kam përdorur përemrin tonë se ishte në
16 atë automjet, por unë s'kisha dijeni që këto armë ishin në
17 automjet.

18 PY. A i keni thënë ndonjëherë ZPS-së në intervistën tuaj se
19 kjo është dhe e pranuar tashmë si Provë Materiale 756, P756.
20 Pra, kur keni pasur mundësinë me Prokurorinë sërish para, pra,
21 kur diskutuar sërish me Prokurorinë para disa ditësh, a i
22 thatë -- ju Prokurorisë se ju nuk kishit dijeni se ekzistonin
23 ato armë atje? A keni mundësi ta korrigjoni sikur një herë, a
24 e keni thënë -- sikur një herë të vetme?

25 PË. Po jo s'më ka pyetur njeri. Nuk ma ka bërë njeri këtë

1 pyetje. Unë jam përgjigjur pyetjeve që më ka bërë Prokurori.

2 PY. Kur lexuat atë pjesë të deklaratës suaj ku thuhej:

3 "Na kontrolluan dhe na morën pistoletën dhe pushkën
4 tonë".

5 Ju, në fakt, keni bërë disa ndryshime të kësaj pjese të
6 deklaratës suaj. Ama nuk e keni ndryshuar këtë fjalinë ku keni
7 thënë, "Na kontrolluan dhe na morën pushkën dhe pistoletën
8 tonë", apo jo?

9 Ju asnjëherë nuk e ndryshuat këtë gjë, këtë fjali.

10 PË. S'e di, si po përkthehet. E imja, e jotja. Nuk mund të
11 thosha e imja, e jotja. Unë s'kisha armë në ato momente. Pra,
12 unë nuk e di se si mund të interpretohet kjo fjali. Ju e
13 interpretoni në mënyrën tuaj.

14 PY. Po ju them unë këtë, Dëshmitar. Ju në atë kohë ishit
15 luftëtar i armatosur; shkoni në shtëpinë e xhaxhait tuaj; keni
16 marrë armë me dijeni të plotë, se ju nuk thoni në asnjë vend
17 që armët nuk janë tuajat. Dhe më pas bashkë me xhaxhain tuaj,
18 Krsta dhe me xhaxhain tjetër, Stankoviqin, Stanko Stankoviqin,
19 ktheheni në një zonë ku po ndodhnin luftime të armatosur. Pra,
20 ishit të pajisur me armë, apo jo?

21 PË. Jo.

22 PY. Ju ishit në dijeni gjatë kësaj periudhe kohore se
23 autoritetet serbe po armatosnin civilët serbë, apo jo?

24 PË. Jo, jo nuk e dija. Ndoshta ka patur raste të tilla. Por
25 nuk kam parë askënd që të armatoste dikë tjetër.

1 PY. Kur ishit në fshatin tuaj në vitin 1998, a ke dëgjuar që
2 autoritetet serbe MUP-i, ushtria jugosllave apo
3 paraushtarakët, kushdo qoftë, a ke dëgjuar që ata po
4 armatosnin popullatën serbe, po apo jo është përgjigja?

5 PË. Jo, vërtet që jo.

6 PY. Pra, dëshmia juaj përpara të nderuarve Gjykatës këtu
7 është që asnjëherë ti nuk ke dëgjuar në asnjë vend në Kosovë,
8 në asnjë kohë që autoritetet serbe ishin duke armatosur
9 civilë? Kjo është dëshmia që po jepni sot këtu?

10 PË. Po, edhe nëse ka patur raste të tilla, njerëzit më të
11 moshuar nuk na kanë treguar. Ndoshta është bërë në mënyrë
12 sekrete, por unë nuk kam informacion.

13 PY. Le ta kuptojmë se ku kemi arritur, në ç'pikë kemi
14 mbërritur. Më korrigjo nëse e kam gabim. Kur je duke u kthyer
15 më datën 4 dhe vazhdojnë luftimet me datën 4, apo jo, me 4
16 korrik, data e rrëmbimit tuaj?

17 PË. Po, në pasdite ndodhi. Rifilluan luftimet pasi policia
18 kishte mësuar në mëngjes që ne na kishin rrëmbyer. Luftimet
19 ishin -- pezulluar një natë përpara dhe ato rifilluan pasditen
20 e datës 4 në kohën kur ne na kanë ndaluar.

21 PY. A është dëshmia juaj që luftimet filluan me datën 4
22 pasdite për shkak se ti, Stanko Stanković dhe xhaxhai yt ishin
23 rrëmbyer, kështu po thoni? A po thoni se për këtë arsye kanë
24 sulmuar serbët?

25 PË. Jo, nuk ka patur asnjë lloj sulmi. Komunikimet me radio

1 nuk kanë funksionuar, kështu që ata nuk e kishin mësuar nëse
2 kishim arritur në fshatin e Movljanit. Prandaj policia ka
3 ardhur për të pyetur dhe më pas ka mësuar që ne ishim zhdukur
4 gjatë rrugës për në fshat. Dhe për këtë arsye rifilluan
5 luftimet. Unë nuk di se kush ka sulmuar përpara; nuk di nëse
6 ishte policia serbe apo UÇK-ja; unë nuk e kam parë një gjë të
7 tillë për shkak se në atë kohë isha i ndaluar.

8 PY. Por sulmit të bërë pasdite dhe serbët kanë sulmuar në
9 drejtim të Budakovës, apo jo?

10 PË. Në drejtim të Budakovës nuk ka patur sulm. Ishte një --
11 ishte një sulm kundër policisë serbe e cila udhëtonte nga --
12 në rrugën Suharekë - Reçan në drejtim të Movljanit në mes të
13 Krushicës së Epërme dhe të Poshtme. Sulmet janë zhvilluar
14 pikërisht aty për shkak se ishte një ambient i përshtatshëm
15 për sulm.

16 PY. Pra, ju keni informacione lidhur me sulmet atëherë të
17 datës 4? Sapo thoni që keni patur informacione, pra, keni
18 dijeni për informacionet e datës 4 apo jo?

19 PË. Këtë e mësova tre deri në pese vjet më vonë. Tre deri në
20 pesë vjet pas këtyre ngjarjeve, pasi takova shokë të cilët
21 ndoshta kanë pësuar të njëjtin fat si unë. Kemi shkëmbyer
22 informacione dhe kam mësuar se kur ka ndodhur, kur janë
23 zhvilluar ngjarjet, ku. Atë ditë unë nuk e kam ditur se çka
24 ndodhur. Nuk kam patur dijeni fare për këtë incident, për këtë
25 luftë, atë rast. Ju vijani emrin si të doni, por unë nuk kam

1 patur informacion lidhur me të në atë kohë. As Krsta, asnjëri
2 prej ne të treve që ishim rrëmbyer atë ditë.

3 PY. Po ju lexoj atëherë diçka nga SPOE00226697 deri në
4 00226716, faqja 3. Po e lexoj për shkak se nuk ka përkthim në
5 serbisht. Dhe këtu bëhet fjalë për datën 4 korrik 1998:

6 "Në orën 14.00 forcat e armikut", forcat serbe, "nisën
7 sulmin e tyre në Krushicë në drejtim të Budakovës".

8 A ka ndodh një gjë e tillë?

9 PË. Unë vërtet nuk e mbaj mend këtë dhe nuk kam patur
10 informatë të tillë lidhur me kohën e saktë. Kur ka ndodhur ky
11 incident një nga ushtarët e UÇK-së erdhi në oborrin e Lumni
12 Palushit ku -- na mbanin neve dhe tha që nesër do t'ju lejojmë
13 të shkoni për të varrosur babain tuaj për shkak se sapo e
14 kemi vrrarë". Më vonë mësova që babai im nuk kishte qenë fare
15 aty në atë zonë në atë kohë.

16 PY. Pasi të kishin ndaluar me armë e pistoletë ti takova
17 Bajram Morinën i cili ishte shumë i shqetësuar për shkak se ai
18 të kishte liruar një ditë më para apo jo?

19 PË. Po. Ai erdhi edhe në Budakovë. Në deklaratën time thuhet
20 që ai po riparonte makinën Lada Niva, pra, makinën me të cilën
21 na dërguan nga shtëpia e Lumni Palushës në shtëpinë e
22 Kokollarit ku jemi mbajtur edhe në bodrum. Në ditën -- të
23 njëjtën ditë kur na kanë liruar këtë makinë, Lada, Ladën e
24 përdorën ushtarët e UÇK-së për të na dërguar në deri në vendin
25 ku na lejuan që të liroheshim. Pra, në drejtimin e Krushicës

1 së Poshtme.

2 PY. Bajram Morina dhe është rreshti 756.1, rreshtat 12 deri
3 në 16. Thotë:

4 "Bajram Morina dhe po e citoj, ai thotë 'të qifsha nënën,
5 nënën për shkak se dje ti kishe armën dhe kishe armën deri më
6 dje dhe më the mua që ti ishe duke mbrojtur këto gra dhe
7 fëmijë'. Ai po merrte hak ndaj meje për shkak se unë kisha
8 shpëtuar nga duart e tij një ditë më parë".

9 A nuk e the këtë gjë ZPS-së?

10 PË. Siç e shihni po i kthehemi së njëjtës çështje që
11 diskutuam pak më herët kur unë i thashë atij që isha në këtë
12 në pyll kur i thashë se po shpëtonim gratë dhe fëmijët. Bajram
13 Morina tha ekzaktësisht ato fjalë të cilat unë ju thashë juve
14 më parë dhe pikërisht kështu ka ndodhur. Ai mori hak.

15 PY. Të gjithë këta fqinjë që ti i the ZPS-së që kishin dijeni
16 që ti s'kishe armë, s'kishe asnjë marrëdhënie me ushtrinë e
17 kështu me radhë ishin të gjithë ato të cilët në fakt u shokuan
18 kur morën vesh që ti po udhëtoje në një zonë luftimesh duke
19 pasur me vete armë, apo jo?

20 PË. Jo, fare. Nuk janë shokuar fare. Fadil Gashi, vëllai i
21 Shukriut dhe tjetri, të dy mësuesit e shkollës fillore në
22 Movljanë nuk do të kishin ardhur për të kërkuar që ne të
23 liroheshin. Ata e dinin fare mirë që ne nuk kishim asgjë, nuk
24 kishim punë me policinë apo me ushtrinë se nuk kemi marrë
25 pjesë në asnjë sulm, as më parë as dhe as atëherë as më parë.

1 Ata kishin dijeni me të gjitha aktivitetet tona; ata e dinin
2 se çfarë jete kishim, njëlloj siç edhe ne e dinim çfarë jete
3 kishin ata. Ne ndihmonin njëri-tjetrin sa herë që kishte
4 nevojë.

5 PY. Po e përmbledh pak sjelljen tuaj me datën 3 dhe me datën
6 4. Ju jeni jashtë Movljanit, në afërsi të një konflikti të
7 dhunshëm mes forcave serbe dhe forcave të UÇK-së kur jeni
8 ndaluar nga UÇK-ja dhe të lejuan që të ikje ti, vrapove.
9 Pastaj shkove tek shtëpia e xhaxhait ku kalove -- natën bashkë
10 me Krsta Jeftiqin dhe pastaj të nesërmen ju të tre ishit të
11 gjithë të armatosur, duke shkruar në drejtim të një zone
12 luftarake. A nuk ndodhi kështu? Është kjo e saktë ky
13 përshkrim? A është ky përshkrim i saktë?

14 PË. Unë nuk jam dakord me atë që thoni ju. Ky është
15 përfundimi juaj si Avokat Mbrojtjeje. Unë nuk shkova atje me
16 synimin që të armatosesha dhe pastaj të kthehesha me synimin
17 për të sulmuar ndokënd me datën 4 korrik.

18 PY. Dëshmitar, ju thatë që nuk shkoni me këtë synim, por në
19 fakt një gjë të tillë e bëtë, apo jo? Ju morët armët dhe u
20 kthyet në një zonë konflikti, apo jo?

21 PË. Unë po përsëris të njëjtën gjë që unë nuk dija gjë për
22 këto armë. Unë s'kisha armë me vete personalisht.

23 PY. Të shohim, të flasim pak për -- në fakt në pyetje e
24 fundit në këtë -- për këtë temë. Kur i kishit këto armë dhe me
25 makinë po shkonit në drejtim të një zone ushtarake. UÇK-ja të

1 kishte për detyrë të ndalonte për të kuptuar se cilat ishin

2 synimet tuaja, apo jo?

3 PË. Para se të na ndalonin takuam një ish-fqinj, Desku

4 Kabashi, i cili atë mëngjes na përshëndeti si gjithmonë në

5 Krushicën e Poshtme, në rrugë aty. Dhe -- po të kishin shkuar

6 ne për të marrë armë ai do të na kishte -- do të kishte qenë i

7 pari që do të kishte -- do të kishte njoftuar për ne.

8 PY. -- A ke ndonjë provë që Desku Kabashi e dinte që ti ke

9 patur armë, që ke patur një pushkë dhe pistoleta me vete, a i

10 ke treguar këtë gjë atij?

11 PË. Askush nuk ka përmendur armë. Ne thjesht e përshëndetëm

12 njëri-tjetrin si fqinj që ishim, si komshinj që ishim.

13 PY. Pra, ky komshiu Desku Kabashi që takove në Krushicë të

14 Poshtme nuk kishte ide ai që dy xhaxhallarët e tuaj ishin të

15 armatosur apo jo; ai nuk kishte ide që kishit armë me vete,

16 apo jo?

17 PË. Po, po, por ti vazhdon të më akuzosh që unë kisha armë.

18 Por unë nuk kisha armë me vete vetë.

19 PY. Po unë po ta them ty sepse ti kishe armë se përndryshe do

20 ta kishe thënë këtë ZPS-së. Gjithë kohën ZPS-së i ke thënë që

21 këto ishin armët tona, a nuk është kështu?

22 PË. Nëse mendon që kjo është mënyra për ta interpretuar këtë

23 gjë ju keni të drejtë ta bënë. Të gjithë mund të bëjnë

24 interpretimin që duan. Unë nuk kam përgjigje për të dhënë në

25 këtë drejtim.

1 PY. Për sa i përket [REDAKTUAR] ju thatë që [REDAKTUAR] ishte në
2 burg kur juve ju çuan te shtëpia e Kokollarit?
3 PË. Nuk më kujtohet nëse ata ishin atje dhe na çuan neve apo
4 ata erdhën më vonë. Nuk më kujtohet, nuk më kujtohet
5 saktësisht tani kjo gjë, por ajo që jam në gjendje të pohoj
6 është që në kohën kur po na rrihnin ne [REDAKTUAR] dhe --
7 djali tjetër nga Reçani që është përmendur ishin në këtë
8 bodrum, por nuk e them dot se kush ka arritur përpara. Nëse
9 isha unë, domethënë, ne apo ata kishin arritur të parët.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nëse duam të vazhdojmë në këto
11 pyetje të kalojmë në seancë private.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, është e vërtetë. Duhet të kishim
13 kaluar, ju kërkoni ndjesë, duhet të kishim kaluar në seancë
14 private.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do të dërgojmë kërkesë për ta
16 bërë një gjë të tillë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ashtu të
18 bëhet.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 143

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 144

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 145

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 146

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 147

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 148

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 149

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 jemi në seancë publike tani.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani
23 pezullojmë seancën deri nesër në orën 09.00 të mëngjesit.

24 --- Seanca mbyllet në orën 16.02

25